VI. Per nje veprimtari qeverisese publike. Qeverisja vendore

Hyrje: A. C’eshte politika publike? Perse studiohet politika publike?

C’eshte politika publike? Kursi i veprimeve (apo mosveprimeve) qeveritare lidhet ngushte dhe me pergjigjen konkrete ndaj problemeve publike. Kjo lidhet me politiken e miratuar, me qellimet dhe mjetet, si dhe rregullat e praktikat e agjencive qe zbatojne programet perkatese.

Formedhenia e nje politike publike eshte nje proces kompleks dhe i shumeanshem, qe permban nje ndërveprim individësh te shumte dhe grupesh interesi qe jane ne gare apo ne bashkëpunim midis tyre, per te ndikuar mbi politike-berjen. Ata shfrytezojne taktika dhe mjete te ndryshme per te avancuar synimet e tyre, perfshire dhe “avokatimin” e pozicionimit te tyre ne menyre publike, me pretendimin per t’i bindur mbeshtetesit dhe “paralizuar” oponentet, me tej edhe duke mobilizuar aleatet per ceshtje te veçanta.

Perse duhet te studiohet dhe perpunohet politika publike?

-Per te zhvilluar kapacitetet e duhura dhe per te vendosur se cilat pozicione politike apo lloje politikash mund e duhet te mbeshteten.

-Per te vleresuar qeverisjen: a eshte demokratike apo jo?

-Per te rritur aftesite ne pjesemarrje dhe vendim-marrje.

-Per te ndihmuar ne marrjen e vendimit apo per ta formesuar ate.

Kontekste te politikes publike

-Konteksti politik
-Konteksti qeverises
-Konteksti social
-Konteksti ekonomik
-Konteksti kulturor
-Konteksti rajonal apo global

Perse duhet te nderhyje qeveria?

- Per arsye politike
- Per arsye morale dhe etike
- Per shkak te distorcioneve apo deshtimeve te tregut (p.sh., kur tregu deshton ne eficiencen e tij) . Midis tyre ne rastin e fundit duhen shqyrtuar me kujdes keto kategori:
- Ekzistenca e monopoleve ose oligopoleve,
- Eksternalitetet,
- Deformimet (deshtimet) ne informacion apo procesin e informimit ne pergjithesi
- Paaftesia e furnizimit te mirave publike apo kolektive.

Le te ndalojme , p.sh., tek eksternalitetet. Ky eshte rasti kur nje individ apo grup i trete preket nga nje transaksion midis dy njerezve apo grupeve dhe nuk kompensohet per humbjen (eksternaliteti negative) apo paguan kur fiton (eksternaliteti pozitiv). Shembuj te tille jane ndotja e mjedisit dhe edukimi.

Po ashtu dhe informacioni mund te behet nje problem serioz. Ndoshta, shume me pak per mallra qe blihen me shpesh, p.sh., ushqimet ku mund te behen lehte axhustimet, por jo per blerjen,p.sh., te nje veture apo per gjera qe nuk kuptohen mire ne raste te dhena (p.sh., kur nevojitet mjeku) apo te lidhura me shendetin (p.sh., ilacet qe kerkohen).

Analiza e politike-berjes

Analiza e politikes publike duhet te jete sistematike, e organizuar, duke perfshire alternativat dhe programet perkatese. Karakteristika kryesore te saj jane :

- **Efektiviteti**
- **Eficienca, fizibiliteti apo rendimenti ekonomik**
- **Paanesia, barazia apo equiteti (equity) dhe liria**
- **Fizibiliteti politik**

Nuk duhet harruar qe keto karakteristika nuk kane peshe te njejte ne situata te ndryshe. Po ashtu, krahas tyre vlen te permendet shtrirja e pjesemarrjes, fleksibiliteti, etj.

Nje matrice per strategjine e politike-berjes: Lidhja midis fakteve&vlerave

	Nivel i larte mirëkuptimi mbi vlerat	Nivel i ulet mirëkuptimi mbi vlerat
Nivel i larte mirëkuptimi mbi faktet	Zgjidhje teknike	Zgjidhje politike
Nivel i ulet mirëkuptimi mbi faktet	Zgjidhje juridike	Anarki, kaos

Edhe njehere: Pse duhet qeveria?

Por pse duhet qeveria? Cfare ben ajo? Qeveria shihet si nje entitet qe mbledh taksa nga individet dhe firmat, qe shpenzon ate qe merret nga taksimi, qe rregullon aspekte te ndryshme te aktivitetit ekonomik.

Po perse qeveria nderhyn ne aktivitetet ekonomike? Pse nuk u lihet gjithcka nderveprimeve private midis individeve (tregjeve)?

Kjo per ekonomistet lidhet me motive te lidhura me:

a) **Eficiencen, fizibilitetin apo rendimentin**

b) **Drejtesine, paanesine e barazine apo ekitetin (equity)**

-. **Eficienca lidhet me te mirat publike, eksternalitetet, deshtimet apo falimentet e tregut, deshtimet ne qeverisje**

-. **Equiteti (equity) lidhet p.sh. me rishperndarjen dhe sigurimet shoqerore**

-. **Me te dyja ato lidhet sot edhe politika konkrete ekonomike per kapitalin njerezor (kohezionin social).**

Eficienca dhe "Equity"

Ne ekonomi, rendimenti (eficienca, fizibiliteti) kane nje kuptim te sakte. Nje alokim burimesh konsiderohet eficient nese "nuk ekziston ndonje riorganizim burimesh (ndonje ndryshim ne prodhim e konsum) sesa ai ne momentin e dhene, qe as nuk jep nje rezultat me te mire as nje rezultat me te keq". (Stiglitz)

Ekiteti (Equity) eshte akoma me i vagte si term. Ai ndeshet kur flitet per nje sjellje te drejte, te barabarte apo te paanshme ekonomike, por dhe kur behet fjale per aksione te zakonshme (me interesa te ndryshueshme). Bile, nuk pretendohet per ndonje percaktim te prere te tij, aq sa cdo individ ka percaktimin e vet. Ne fakt, do te ishte mire qe nje qeverisje te kishte mundesine qe te shqyrtonte opsionet konkrete dhe te ndryshme te "ekitetit" ne popull per te arritur ne nje zgjidhje te pershtatshme per te gjithe. Gje qe eshte ne thelb e pamundur. Prandaj, nje ekonomist mund te diskutoje shume me lehte per ceshtje te eficiences sesa per ceshtje te ekitetit. Aq me teper, eficienca mund te analizohet e debatohet pa u kushtezuar nga referenca apo ndonje mbeshtetje ne parime morale e filozofike. Ndryshe fare nga rasti i ekitetit.

Eficienca dhe nderhyrja. "Provohet matematikisht", qe ne kushte te dhena, tregjet konkurente (kompetititve) prodhojne rezultate eficiente. Ne kushte te tille eshte veshtire te argumentohet nderhyrja qeveritare ne ekonomi, te pakten me argumentin e promovimit te metejshem te eficiences.

Dy "teorema"

Me eficiencen lidhen dy "teorema" fondamentale te mireqenies ekonomike:

Teorema e pare: Ne kushte te dhena, tregjet kompetitive prodhojne nje perdorim eficient te burimeve

Teorema e dyte: Ne kushte te dhena, cdo perdorim eficient burimesh mund te arrihet ne prani te tregjeve kompetitive

Aty ndeshen dy shprehje baze apo dy kushtezime:

i) ne kushte te dhena (te caktuara),

ii) tregje kompetitive (konkurente).

Nje falimentim apo deshtim i njeres prej tyre, apo te dyjave se bashku, mund te provokoje rezultate ineficiente, qe e bejne krejt te arsyeshme nderhyrjen qeveritare ne ekonomi.

Deformime apo deshtime te konkurences

- Deshtimi i kompetivitetit (konkurrences)
- Nje treg eshte konkurrent (kompetitiv) kur ai shfaq ne te gjtha aspektet nje sjellje te tille. Natyrisht, duke i marre cmimet si te dhena gjate marrjes se vendimeve! Ne pergjithesi, per te pasur nje konkurrence apo kompetitivitet te caktuar nevojitet nje numer i konsiderueshem faktoresh e agjentesh ne anen e tregut, me kushtin qe asnje prej tyre apo qe asnje pjese e tregut te mos te ndikoje vecmas dhe ne menyre substanciale mbi cmimet.
- Kur nuk ekziston kjo konkurrence atehere ose ne anen e ofertes te tregut (p.sh.: monopoli) ose ne anen e kerkeses (p.sh.: monopsonia), nje ose te dy anet kane nje fuqi tregu qe mund te shfrytezohet prej njeres ne kurriz te tjetres apo ne kurriz te eficienses.
- Verejtje: Ne ekonomi. monopsonia (nga greq. μόνος + ὀψωνία) eshte nje forme tregu, ne te cilen shume shitesa (furnizuesa) perballen vetem me nje bleres. Ai shpreh nje rast konkurrence imperfekte, te ngjashem me monopolin, ku vetem nje shites (furnizues) perballon apo furnizon shume bleresa (per mallra apo sherbime). "Monopsonisti" mund te diktoje termat tek furnizuesit e tij, po ashtu si nje monopolist kontrollon tregun per bleresit e tij.
- Nje rast tjeter i mungeses se kompetivitetit eshte mungesa e vete tregut. Nje shembull i tille eshte p.sh. vete komunizmi, por mund te ndeshen dhe raste te tjera. Nuk perjashtohet qe ne kushte te dhena, p.sh. ne vitet e para te pas luftes, komunizmi te gjeneroje rezultate efektive, edhe pse kjo mund te jete thjesht per nje periudhe te shkurter…

Cfare jane eksternalitetet?

Deshtime apo deformime ne raste apo kushte te tjera.

Te tilla jane ato qe lidhen me te mirat publike, eksternalitetet, asimetrine e informimit apo kufizimet ne kreditim. Por dhe per keto lloje te ndryshme falimentimesh apo deshtimesh ne tregje, vlejne megjithate te shtrohen keto pyetje:

- i) A mundet qe tregu ta korrektoje veten, e ka bere dhe e ben ai dicka te tille?
- ii) Vete qeveria, a mund te veproje me mire?

Eksternalitetet – mund te ndeshen ne cdo fushe te aktivitetit ekonomik, ku ato jane percaktuar si teprica (pozitive ose negative) ne grupe apo pjese te treta. Pra, ato shfaqen ne procesin e prodhimit dhe/ose konsumit te mirave dhe sherbimeve, kur nuk paguhet kompensimi i duhur. Eksternalitetet mund te shkaktojne nje deformim te tregut, deshtim te tij, nese mekanizmi i cmimeve nuk merr parasysh kostot e plota sociale dhe perfitimet sociale te prodhimit dhe konsumit. Madje, kjo po behet gjithnje e me e rendesishme, nga lidhjet e ndersjella midis ekonomise dhe mjedisit

Kostot private dhe sociale.

Nga keto teprica apo eksternalitete na krijohet nje divergjence midis kostove private dhe sociale te prodhimit. Kostoja sociale perfshin te gjitha kostot e prodhimit apo te output-it te nje malli apo sherbimi te vecante. Keshtu, p.sh., si pjese e trete, teprice apo eksternalitet mund te konsiderohet dhe ndotja e ajrit.

Kostoja Sociale = Kostoja Private + Eksternalitet

P.sh., - nje uzine kimike krijon mbeturina qe derdhen ne lum dhe atmosfere. Kjo krijon eksternalitete negative qe imponojne kosto me te larta sociale mbi firma te tjera apo mbi konsumatoret, p.sh., koston e pastrimit te ujit apo ato te lidhura me shendetin.

-2-

- **Externalitetet si jashtëqitje industriale: Të tilla janë p.sh. daljet (mbeturinat) industriale në formën e mbetjeve, plehrave, etj., gjatë një procesi prodhimi ose shërbimi. Janë jashtëqitje nga fabrika, linja e struktura prodhuese të zotëruara nga individë të veçantë dhe subjekte biznesi.**
- **Në përgjithësi, firmat dhe individët për të kanalizuar derdhjen në mjedis të mbeturinave apo jashtëqitjeve industriale, sipas standardeve ligjore, duhet të kryejnë shpenzime shtesë (jashtë atyre të lidhura me biznesin konkret). Në një plan më të gjerë ekonomik, mund të dallohen jashtëqitjet ("pozitive") me ndikim përfitues dhe ato ("negative") me ndikim shkatërrues. Jashtëqitje përfituese (pozitive) janë p.sh. mbeturinat e një kombinati mishi, mbeturinat e produkteve bujqësore, etj., të cilat mund të shfrytëzohen në mënyrë të dobishme, p.sh., si plehra organike, pasurim toke, përmirësim strukture, etj. Grupi tjetër i jashtëqitjeve (i atyre me ndikim negativ) e dëmton qartësisht mjedisin dhe shëndetin e njerëzve, që jetojnë në atë mjedis. Të tilla janë gazrat helmues, ndotja e ujit, helmimi i tokës, ndotja e mjedisit (tokës, ujit e ajrit) prej rrezatimeve radioaktive, pakësimi i oksigjenit apo shtimi i gazit karbonik, etj.**

Informacioni, distorcionet dhe incentivat

Ekzistojne dhe probleme te tjera qe kushtezojne apo pengojne veprimin e nderhyrjen qeveritare. Ato jane:

i) Informacioni – A ka qeveria informacionin e duhur per te korrigjuar deformimin apo deshtimin e tregut?

ii) Distorcionet – A mund te fuse qeveria distorcione te reja ne treg kur nderhyn per te korigjuar tregun apo distorcionet e meparshme?

iii) Incentivat – Cilat jane incentivat e burokrateve publike? A dezinjohen mire skemat incentive nga burokracite publike?

EQUITETI (EQUITY)

- Alokimi i burimeve qe vijne nga veprimet e tregut nuk jane patjeter te barabarta, te drejta apo te paanshme?! Por, perse equity eshte nje problem qeverisjeje? Per kete duhet te merren parasysh dhe dy aspekte te rendesishme. Keshtu:
- i) per te arritur nje shperndarje apo perdorim me te drejte te burimeve ne krahasim me ate te prodhuar nga tregu kjo nderhyrje mund te jete e deshirueshme ose mund te mos rezultoje e tille. Kjo varet dhe nga vlerat e cdo individi.
- ii) nese rezultati i perftuar nga tregu eshte eficient por jo i drejte, jo i barabarte apo eshte thjesht i anshem, atehere normalisht qeveria duhet te nderhyje. Kjo me shpesh sjell nje alokim te ri, me te drejte, te burimeve, por, ama, eshte pergjithesisht me pak eficient
- – Barazia, drejtesia e paanesia eshte e kushtueshme (*equity is costly*). Apo, akoma equity ka kosto ne lidhje me eficiencen
- Ne te shumten e rasteve nderhyrjet qeveritare ne treg sjellin njefare distorsioni ne incentiva. Kur, p.sh., incentivat e kane rritur eficiencen apo rendimentin ne treg, atehere duke provokuar nje distorsion te tyre thjesht na krijohen situata te reja jo eficiente. Pa dyshim, vlen te njihen dhe kualifikohen keto deformime, per te njohur programet e shpenzimet e ardhshme.
- P.sh., taksa progresive e “distorson” apo e godet incentiven e aktivizimit maksimal apo te punes ne maje te piramides se shperndarjes se te ardhurave (pra dhe te fitimeve), nderkohe qe programimi i mireqenies e “distorson” apo e godet kete incentive ne nivelin e te ardhurave te uleta. Dhe e kunderta per taksen e sheshte.

Falimenti apo deshtimi ne qeverisje

- Ky deshtim lidhet me ato situata ku rendimenti (eficienca apo fizibiliteti) eshte reduktuar ne saje te nderhyrjes qeveritare ne tregje me pretendimin per te korrigjuar falimentimin e vete tregut.
- Por kur nderhyn qeveria apo pse nderhyn qeveria?
  - Per te korrigjuar mungesat apo tepricat (surplus-et)
  - Per te furnizuar tregun kur ai nuk mund apo nuk arrin te realizoje kete furnizim.
  - Per te rregulluar apo korrigjuar ato raste ku perceptohet pabarazi dhe ineficience.
  - Per te mbrojtur individet dhe grupet ne shoqeri dhe per te garantuar nje siguri te mjaftueshme per ata qe jane te paafte t'i sherbejne apo te ndihmojne veten e tyre.
  - Per te reduktuar varferine
  - Per te ndikuar ne te drejtat e prones.
- Si nderhyn qeveria?

Nepermjet:

- Taksave apo taksimit ne pergjithesi per rishperndarje e realizim efektesh (incentive apo disinsektive)
- Ndihmave apo subvencioneve per te inkurajuar prodhimin/konsumin
- Rregullave e rregullimeve si udherrefyese, kodeve apo manualeve praktike, legjislacionit, rregullatoreve te pavarur
- Duke identifikuar me mire te drejtat e pronesise, zoterimin e prones jo vetem fizike, p.sh., te prones intelektuale, te dhenies dhe respektimit te patentave, etj.
- Furnizimit te drejtperdrejte te mallrave dhe sherbimeve (shendetit, edukimit, etj.)

Mbi funksionin e mireqenies sociale

Individe te ndryshem kane pikepamje te ndryshme mbi "Equity"

Por cila pikepamje duhet te adoptohet? Sa e drejta, e "paaneshmja" eshte realisht e drejte dhe e paaneshme? Deri ne c' nivel kemi shtim joefektiviteti per nje rritje te ekitetit?

Funksioni i mireqenies sociale- Individe te ndryshem kane preferenca te ndryshme. Ne kemi nevoje per nje mekanizem qe te mbledhe preferencat e individeve ne nje preference sociale.

Ka dy menyra te menduari: ajo tiranike (tirania) dhe ajo demokratike (demokracia). Megjithate, ndeshen dhe mjaft menyra te tjera te grumbullimit te ketyre preferencave, bile qe as u korrespondojne fare ndonje sistemi politik te vecante.

Ne ndertimin e nje funksioni te tille te mireqenies sociale, zakonisht pretendohet qe qeveria realizon apo ushtron vullnetin e shoqerise per te maksimalizuar funksionin e mireqenies sociale.

Por kjo nuk rezulton gjithmone e vertete. Sidoqofte, kur per mallra apo sherbime te caktuara qeveria beson se individet duhet te konumojne me shume (apo me pak) ne krahasim me sasine qe ata konsumojne (pavaresisht qofte dhe te vendimeve te gabuara te tyre), atehere mund te themi se qeveria po vepron apo po nderhyn ne menyre paternaliste.

Paternalizmi sipas Kantit shnderrohet gradualisht ne despotizem!

Shihni, per me hollesisht, R. Meidani, Panorama, 18 shkurt 2010.

Pamje të shtetit të mirëqenies sociale. **Janë të mundshme disa pamje të ndryshme të shtetit të mirëqenies sociale. Ecuria e tyre lidhet ngushtë me programe publike në zonën e shëndetit, transferimit të ardhurave, edukimit e trejnimit (përfshirë dhe ato të tregut të punës) apo shërbimeve të ndryshme sociale (përfshirë asistencën, strehimin, etj.) Mund të veçohen 3 modele: *ai liberal*, i mbështetur në taksa (sidomos tek ato që kanë si burim të ardhurat e ulëta); *ai korporatist*, në të cilin përfshihet kontributi i të punësuarit dhe i punësuesit, në mungesë të ndonjë mbulese universale (një skemë e tillë kontributesh individuale ndeshet, praktikisht, në Itali, ku dhe "familja tradicionale" është një element i rëndësishëm); dhe, së fundi, *ai social-demokrat*, që ka një mbulesë universale dhe mbështetet në një kontratë cilësore (p.sh., një skemë të tillë më të zhvilluar social-demokrate të shtetit të mirëqenies sociale e ka Suedia). Po aq i rëndësishëm është dhe dallimi midis vlerave bazë në këto skema.**

Kështu, mund të veçohet skema reziduale, ku shteti shërben si burimi fundor, kurse tregu e familja janë parësore. Një skemë e tillë lidhet dhe me arritjet industriale, madje zhvillimi drejtpërsëdrejti reflektohet në mirëqenie. Po ashtu, e rëndësishme është dhe shpërndarja e të ardhurave, bile mirëqenia shihet si mënyrë për të reduktuar ndarjet sociale, në kuadër të një kapitalizmi sa më human. Por, ndryshe nga Suedia, Shqipëria është tepër larg një skeme të tillë!

Sidoqoftë, shteti i mirëqenies, kudo në botë, pavarësisht tipit konkret, po përballet me një situatë krize, veçanërisht në kushtet e një krize fiskale. Në përgjigje të saj janë të mundshme dy rrugë: a) duke bërë axhustime (por duke ruajtur shtetin e mirëqenies sociale), apo b) duke hequr dorë nga shteti i mirëqenies sociale (sipas "variantit" të dytë, ai po i mbyll ditët e veta!). Shumë afër këtij varianti të dytë është Shqipëria. Por, nuk është vetëm ajo! "Shteti i mirëqenies" në shumë vende, po dështon në qendrueshmërinë e tij. Natyrisht, ai ka pasur meritat e tij, duke arritur qëllime të rëndësishme, por ama sot ai mbetet tepër i kushtueshëm për keto vende.

***Presionet fiskale*.**

Në një krize fiskale, ka disa shkaqe që e favorizojnë atë. Krahas korrupsionit, në krizën fiskale që asfikson mirëqenien sociale, ndikojnë p.sh.: rritja e moshës mesatare, niveli i lartë i papunësisë afatshkurtër e afatgjatë, etj. Madje, zvogëlimi në vite i forcave të afta për punë e bën, gjithnjë më problematike mbështetjen e skemave të pensionit.

Në fakt, nga që popullsia në moshë pune duhet të mbështesë pjesën e njerëzve në pension apo gjeneratën jo në moshë pune, ajo duhet të jetë ekonomikisht sa më aktive dhe relativisht e arsyeshme në kërkesat e saj për pagën apo rritjen e saj. Aq më e vështirë bëhet zgjidhja kur përqindja e të papunëve bëhet shqetësuese, siç është dhe rasti shqiptar. Prandaj, një synim i rëndësishëm për çdo qeveri është mbajtja e një niveli sa më të ulët papunësie. Përndryshe kostot rezultojnë dyfishe: të papunët thithin burime të konsiderueshme nga sistemi në asistimin e tyre dhe, nga ana tjetër, ata nuk janë të aftë të kontribuojnë më për mbështetjen e asaj moshe në pension, që jeton tashmë në një kohë shumë më të gjatë. Ky është dhe thelbi i krizës fiskale, apo "gjë e gjëza" e shtetit të mirëqenies sociale. Përfytyroni tani "ngërçin" shqiptar!...

Kriza fiskale kapërcehet.

Shteti i mirëqenies sociale është në renie nga vetë pesha e tij. Prandaj, duhen reduktuar kostot e këtij shteti pa prekur kapacitetet asistenciale të tij. Këtij qellimi i shërben diferencimi i kostove të përbërëseve të ndryshme të mirëqenies, sipas moshave. P.sh., bërthama e shpenzimeve të edukimit duhet të lidhet me moshën, shpenzimet e shëndetit për lindjet, më tepër kujdes në vitet e para të pas lindjes, për moshën e tretë, etj. Po ashtu, të ridimensionohet ajo pjesë e konsiderueshme e të ardhurave që u transferohet skemave të pensioneve (që në Shqipëri po bëhen tepër problematike në kushtet e një rritje galopante çmimesh). Pa një zhvillim të shpejtë të skemave private, skemat publike do të jenë të pamjaftueshme në kohë. Edhe në botë, nisur nga struktura e popullsisë së këtij shekulli, ritmet e rritjes së fondeve për kostot e ndryshme të asistencës apo mirëqenies sociale po bëhen të paperballueshme. P.sh., fondet sociale në Britani përfaqësonin 25% të GDP-së, në vitin 1981, ndërsa pas ndryshimeve reduktuese u arrit në 22%, në vitin 1989. Ndërkohë, mendohet se nevojitet një rritje prej 5% për të mbështetur këtë sistem mirëqenieje sociale për një kohë 40-50 vjeçare, që nënkupton një zhvendosje të kostos totale për nga vlera 30% të GDP-së.

Krahas këtij fakti, ekzistojnë dhe hapësira të tjera për t'u shqetësuar, bile edhe kur përbërëset e mirëqenies sociale (si sigurimi shëndetësor, pensioni, asistenca sociale) janë të arritshme nga ana fiskale. Të tilla janë dhe ato që lidhen me efekte afatgjata mbi kohezionin social, që e bëjnë të pamundur fuqizimin e tij. Madje, për Shqipërinë, ky problem është jashtë vëmendjes dhe po bëhet tepër shqetësues. Aq më tepër që ky kohezion apo kapitali social kanë marrë goditje të forta gjatë viteve të tranzicionit...

Sistemi social i mirëqenies nuk është zgjidhje, por problem.

Pavarësisht shqetësimeve globale apo shqiptare, nuk mund të mohohet se sistemi i mirëqenies sociale është në krizë edhe në një rrafsh konceptor. Ai po rezulton zhgënyes dhe vazhdon të ushqejë gabimisht njerëzit në pritshmëritë e tyre të tepruara (si të drejta të fituara apo detyrime të shtetit ndaj tyre). Edhe ne situata jo kritike elementë të tillë si sigurimi, pensionimi, asistenca etj., në kuadër të mirëqenies sociale, kanë nevojë për reforma të mëdha. Ato kanë pak shanse që të jenë të suksesshme, sepse çdo prekje e themelit në konceptimin e shtetit asistencial (mirëqenies sociale), në shumë vende është politikisht e papranueshme. Imagjinoni sherrin që do të "plaste" menjëherë në Francë! Megjithatë, ky lloj shteti duhet të reformohet, jo vetëm pse konceptimi i tij është relativisht konfuz, por dhe pse ai mishëron sot një "amalgam" problematik: Diku siguri për disa; për të tjerë një etapë socializimi; diku për të tretë as dhe nuk nevojitet. Bile, në rastin e fundit, pretendohet se standardi i jetës dhe cilësia e saj janë përmirësuar aq shumë dekadat e fundit, sa që nuk ekziston një varfëri "këmbëngulëse" për ta ruajtur një sistem të tillë! Kjo vlen të rikonsiderohet dhe në terma të solidaritetit, që nuk mund të derivohet nga asistenca. Pse jo dhe një rol rezidual për të siguruar mbijetesën në kushte kritike, p.sh. që asnjë individ të mos vdesë nga uria!...*

***Globalizimi dhe një shoqëri e ndryshme pas disa dekadash*.**

Kriza fiskale nuk është kryesore. Ka një problem fondamental, që lidhen me natyrën e "shtetit", pra dhe me shtetin e mirëqenies sociale. Edhe institucionet janë ndryshuar, partitë politike po bëhen më pak masive, duke u dhënë hapësirë grupeve civile jo partiake, të orientuara për nga konsumatori. Bile, krejt ndryshe nga "pompa" shqiptare! Po ashtu, një problem bashkëshoqërues i globalizimit është homogjenizimi, ndërkohë që vetë shoqëria njerëzore "parapëlqen" pluralizmin dhe jo homogjenitetin. As natyra e shtetit nuk ka qenë imune nga ndryshimi, përfshirë dhe kapacitetet e tij, eficiencën ose përgjegjësinë në llogari-dhënie. Edhe qellimi i garantimit të një shoqërie më njerëzore ka fuqizuar shoqërinë civile, ku shteti luan një rol me të reduktuar. Nga ana tjetër, procesi globalizues e ka reduktuar ndikimin e shtetit; ai nuk mund të qeverisë si më parë. Kjo dhe për faktin që politikat nacionale iu nënshtrohen në një mënyrë apo tjetrën qeverisjes globale, institucioneve të saj. Rrjedhjet e kapitaleve, mallrave, njerëzve dhe ideve, telekomunikimi, informimi e media, nuk janë më si më parë, madje, në shumicën e rasteve, jashtë kontrollit të shtetit apo kufizimit të qeverisjes kombëtare. Kjo ka ndryshuar ne menyre fondamentale vetë nocionin e sovranitetit.

Parë me këtë sy, janë të domosdoshme dhe riorganizime në vazhdimësi në shërbimin shëndetësor, arsimor e mjedisor, për menaxhimin e skemave të pensioneve, përfshirë ristrukturimin e qeverisjes, duke kufizuar apo "zeruar" kostot e disa lloje programesh asistencialë. Në vetvete ato shprehin krizën e shtetit të mirëqenies sociale. Veçse, kriza e këtij shteti është rezultat i një numri faktorësh. Një prej tyre është humbja e besimit ndaj institucioneve politike kombëtare, përfshirë dhe abuzimet ose shpenzimet e pajustifikueshme në shërbimet sociale.

Por çfarë nënkupton kjo për shtetin social? Në fakt, një numër në rritje njerëzish që nuk paguajnë dot taksat në vendet e origjinës, madje mund të priren që të shmangin detyrimet në vendin e rezidencës aktuale. Në njëfarë mënyrë diçka e tillë i bën njerëzit më pak të përgatitur për taksat në nivel shtetëror, ndërkohë që ata janë shumë më të interesuar në shërbimet brenda komunitetit (pra dhe për pagesën e taksave me natyrë vendore). Ndryshe kjo do të thotë se duhet të shpaloset, në teori e praktikë, më tepër devolucion e decentralizim. Dhe, nga ana tjetër, vetë lokalizimi e globalizimi po e "dobësojnë", po e asfiksojnë vetë shtetin, nëpërmjet "*të menduarit në mënyrë globale, dhe të vepruarit në mënyrë lokale*", nëpërmjet trysnisë në rritje mbi vetë shtetin kombëtar.

A na sherben dhe nje sektor i trete?

Natyrisht, nje qeverisje e pergjegjshme, sidomos per mireqenien e njerezve, pasqyron nje koalicion te gjere interesash ndaj “sipermarrjes se lire”. Ketu mund te perfshihet dhe “sektori i trete”, me funksionimin e te cilit lidhen dhe:

- Besimi ne “qeverine e vogel”, kufizimet buxhetore dhe deregullimin (decentralizimin).
- Bindja ne kapacitetin e tregjeve per te funksionuar ne nje spekter te gjere te nevojave te komunitetit.
- Riorientim te shperndarjese se perfitimeve sociale.
- Reduktim te permases se sherbimeve publike dhe te shpenzimeve sociale, duke rritur kontributin dhe nderhyrjet e tjera nga sisteme joqeveritare, shoqeruar me rritje fondesh, kontratash, etj.

Po ashtu, sektori jo qeveritar po perpiqet qe te ndertoje kapacitete apo dhe te veproje ne menyre kolektive.

Por, a ka nje sektor te trete?

- **Pranohet ekzistenca e 2 sektoreve. Keto jane:**
  - **Sektori publik apo "qeveritar"**
    - **Prona publike, qeveria si pronare e vetme apo qe zoteron shumicen e prones apo te aseteve**
    - **Pergjithesisht jo ne funksion te tregut (perfshire dhe adresimin apo nderhyrjen ndaj deshtimit te tregut)**
  - **Sektori privat apo i "tregut"**
    - **Pronesimi privat, prona private**
    - **Synime komerciale**

Cfare eshte sektori i trete?

Jo privat (d.m.th., jo ne zoterim te qeverise apo me pronar qeverine).
•Jo i shoqeruar me perfitime (d.m.th. jo i krijuar per qellime komerciale, teprica apo surplusi nuk ndahet tek zoteruesit). Vjen si rezultat i veprimeve vullnetare, te lidhura me nje shkalle te ndryshueshme mbi punen vullnetare. Perfshin njerez qe punojne ne menyre kolektive per te gjeneruar benefice per anetaret, per grupin apo vete publikun ne pergjithesi.

Nje sektor ne rritje

- Kjo rritje eshte dhe si pasoje e rritjes se shpenzimeve sociale nga ana e qeverise, e ngritjes se veprimtarise sociale, e aktivizmit social, e kerkeses per sherbime jo standarde apo dhe menyres se kryerjes se tyre.
- Sidoqofte, permasat, sjellja dhe reagimet konkrete te sektorit nuk jane dokumentuar apo kuptuar mire ne qarqet e politikes. Mungon nje reference e plote apo nje sistem regullator reference shoqeruar me nje organizim legal dhe koherent. Ne kete kuptim duhet te kerkohet nje legjitimitet i plote i rolit te sektorit te trete, nje riforcim i pozicionit te tij ne nje ekonomi te perzjere ne furnizimin e sherbimeve, nje fleksibilitet me i madh, struktura organizaive pjesemarrese, vlera apo filozofi te qarta, pergjigje me te plota, ne mbeshtetje apo dhe fuqizuese per konsumatoret.

Ne sherbim te “kapitalit social”

- **Ky sektor i sherben dhe ngritjes e fuqizimit te “kapitalit social”.**
- **Cdo qeveri demokratike eshte e interesuar ne fuqizimin e kapitalit social, sepse nje e gje tille:**
  - **Lehteson ndertimin e komunitetit, te nderlidhshmerise se tij, pra ajo e mbeshtet zhvillimin e kohezionit social**
  - **I rrit kapacitetet per te vetevepruar, per vete-ndihme, duke reduktuar kerkesen ndaj qeverise**
  - **E fuqizon mirekuptimin, sjelljen kolektive dhe ndryshimet pozitive sociale.**

Sidoqofte, duhet pasur parasysh qe kuazi-tregjet ne lidhje me mireqenien mund te shtrihen dhe tek sektori privat qe lidhet me perfitimin, por kjo nuk do te thote qe qeveria te mos e elaboroje dhe zhvilloje ne gjeresi kontributin e sektorit te trete ne furnizimin e mjaft sherbimeve qeveritare. Aq me teper qe mendohet se ky sektor ka shume shanse te pesoje ndryshime te thella pozitive kulturore, organizative dhe strukturore ne rrjedhje te viteve.

Shoqeria civile&Qeverisja e mire- C’ eshte Shoqeria Civile?

Shoqeria civile perbehet nga organizime te tilla si:

- **OJQ (NGO) per zhvillimin**
- **Grupet e Qytetareve**
- **Grupet e ndihmave vetjake**
- **Asosiacionet Profesionale**
- **Organizata te regjistruara te bamiresise.**
- **Asosiacionet e biznesit**
- **Sindikatat**
- **Asosiacionet e bazuara mbi besimin**
- **Grupe koalicionesh dhe avokatie, etj.**

“Shoqeria Civile apo institucionet civile mund te referohen ne teresi si institucione apo organizata vullnetare civike e sociale qe formojne bazen e nje shoqerie funksionuese ne kundervenie force ndaj strukturave te nje shteti, pavaresisht nga sistemi politik i ketij shteti”

Koncepti i qeverisjes se mire

Qeverisja e mire perfshin nje platforme qe i mundeson qeverise per te operuar ne menyre eficiente, efektive e transparente dhe te jete e pergjegjshme ndaj publikut. Nder parimet paresore te qeverisjes se mire, te ndeshura me siper vlen te permenden:

- **Pjesemarrja publike ne qeverisje**
- **Respektimi per zbatimin e ligjit**
- **Liria e shprehjes dhe e bashkimit**
- **Transparenca dhe pergjegjshmeria**
- **Legjitimiteti i qeverisjes**

Perfshirja e Shoqerise Civile ka te beje me nje vend e ndikim kritik ne procesin e qeverisjes dhe vete promovimin e qeverisjes se mire, duke lehtesuar veprimin kolektiv te njerezve per arritjen e rezultateve socio-ekonomike te qendrueshme per te miren e perbashket te shoqerise…

Shoqeria Civile e promovon qeverisjen e mire me ane te:

Zhvillimit te qytetarise (sepse keshtu qytetaret behen me teper aktive ne ceshtje publike dhe e rrisin pjesemarrjen ne promovimin e qeverisjes se mire).

Formulimit te politikave dhe avokatise (duke ndikuar vendimmarrjen e ligjvenesve, te perfaqesuesve te zgjedhur apo administratoreve publike).

Rolit te Watchdog-eve (qe luajne nje rol te rendesishem deri paresor ne vleresimin e politikave dhe te aksioneve te qeverise).

Livrimit te sherbimeve te mireqenies (duke realizuar bazat e nevojshme institucionale per livrimin e sherbimeve)-

Ndikimit te politikave elektorale (nepermjet perfshirjes dhe ndikimit te rezultateve te procesit zgjedhor)

Reformave dhe ndryshimit social (duke sherbyer si nje instrument reforme e ndryshimi social)

Aksionit kolektiv (qe u lehteson njerezve veprimin kolektiv ne arritjen e rezultateve te qendrueshme socio-ekonomike)

Shoqeria Civile&E drejta e informimit (informacionit)

E drejta e informimit eshte nje arme e fuqishme ne duart e Shoqerise Civile, gje qe:

- **Mundeson qeverisjen e mire**
- **Garanton pergjegjshmerine dhe transparencen**
- **Siguron pjesemarrjen e publikut ne qeverisje**
- **E lufton e eliminon korrupsionin &**
- **E rrit peshen dhe forcen e njerezve**

Vullnetaret e organizatave te shoqerise civile mund te shfrytezojne te drejten e informimit:

- Per terheqjen e informacionit nga cdo autoritet publik

- Per fotokopje te kontratave qeveritare, pagesave, vleresimeve, matjeve, projektimeve, regjistrave apo te dhenave te tjera.

- Mostra te materialeve te shfrytezuara ne cdo projekt qeveritar (qendror apo vendor) si rruge, ndertesa, etj.

E drejta e informimit (informacionit) & Auditi Social

E drejta e informimit mundeson arritjen e nje transparence dhe pergjegjesi publike me te madhe nepermjet organizatave te shoqerise civile. Ky eshte auditi social.

Auditimi Social eshte nje vleresim i pavarur i performances se nje agjencie publike, i nje programi apo skeme konkrete. Ai ben te mundur perfshirjen apo pjesemarrjen e shoqerise civile ne shqyrtimin dhe kontrollin e veprimtarise se autoritetit publik, te objektivave kryesore dhe vlerave konkrete ndaj te cilave ky autoritet duhet te jete perkushtuar.

Parimet e Auditit Social

Transparence e plote ne procesin e administrimit dhe te vendimmarrjes.

E drejta e pjesemmarjes, per te perfshire personat e prekur apo afektuar ne procesin e vendimmarrjes dhe te vleresimit.

Dhenie pergjigje, e menjehershme dhe publike, nga te gjithe perfaqesuesit&funksionaret te autoritetit publik ndaj njerezve te interesuar (afektuar) nga veprimi e mosveprimi i ketij autoriteti.

E drejta e informimit duke u ciftezuar me auditin social:

- **Ben te mundur nje depertim (akses) dhe disponueshmeri informacioni e auditimi ne sferen publike.**
- **Gjeneron formate te demistifikuara dhe te kuptueshme per nje njohje dhe kuptim publik me te mire.**
- **Mundeson per komunitetin verfikimin e informacionit te marre.**
- **Lehteson krijimin e nje situate transparence dhe pergjegjshmerie.**
- **Ndikon ne performancen e zyres publike, duke ndihmuar keshtu qeverine si nje partner strategjik i saj.**

Domosdoshmeria e informimit dhe e rritjes se tij

Roli i organizateve te shoqerise civile eshte dhe ai i ndertimit te ures se lidhjes se njerezve me informacionin e nevojshem, dhe ne kete kuader dhe furnizimi i prej tyre edhe i avokatise apo mbeshtetjes konkrete.

Per te realizuar veprimtarine e tyre keto organizata vlejne te krijojne rrjetin e tyre. Nje rrjet i tille mund te sherbeje p.sh., per zhvillimin e vigjilences ndaj ndryshimeve ligjore jotransparente, sidomos per struktura problematike apo, ne pergjithesi, per te identifikuar oportunitetet e nderhyrjes ne politike apo procesin e politikeberjes. Po aq e rendesishme eshte dhe avokatia, qe nenkupton angazhim serioz ne avokatimin e ceshtjeve celes te interesit publik. Dhe, natyrisht, kjo lidhet ngushte dhe me aksesin ndaj informacionit. Ne sherbim te ekspozimit te ketyre ceshtjeve kyce apo abuzimeve te institucioneve publike e funksionareve te tyre duhet te shfrytezohet media, qe ne raste te tilla mund te luaje nje rol te dores se pare. Nuk duhet lene menjane dhe ndertimi i kapaciteteve, sidomos te atyre qe lidhen me shfrytezimin e te drejtes se informimit, auditimit dhe vleresimit te programeve qeveritare. Me to lidhet dhe gjenerimi i kujdesit apo i ndjeshmerive se publikut ndaj informacionit te fituar, perfshire dhe rritjen e mobilizimit si reagim e kundervenie.

B. Qeveria si një punëdhënëse. Probleme te menaxhimit te personelit

- **Rregulla dhe politika konkrete për rekrutimin, menaxhimin, avancimin ne kariere dhe mbrojtjen e personelit**
- **Kapacitete dhe mekanizma të administrimit, që sigurojnë aplikim të barabartë për rregullat dhe politikat e personelit.**
- **Kapaciteti i menaxhimit të shërbimit qendror civil**
- **Komisioni i shërbimit civil**

Menaxhimi i Shërbimit Civil në disa shtete të Ballkanit Perëndimor

- **Kroacia**:
  - Zyra Qendrore e Shtetit për Administratën
  - Bordi i Shërbimit Civil
  - Kontrolli Administrativ
  - Tribunali i Shërbimit Civil & Tribunali i Lartë i Shërbimit Civil
  - Qendra e Trajnimit të Shërbimit Civil
- **Shqipëria**
  - Departamenti i Administratës Publike
  - Komisioni i Shërbimit Civil
  - Instituti i Trajnimeve për Administratën Publike
- **Mali i Zi**
  - Autoriteti i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
  - Komisioni i Ankesave
  - Kontrolli administrativ

- **Bosnja e Hercegovina**
  - Agjencia e Shërbyesve (Nënpunësve) Civilë
  - Kontrolli administrativ
- **Serbia**
  - Shërbimi i menaxhimit të Burimeve Njerëzore
  - Këshilli i Lartë i Shërbimit Civil
  - Komisioni i Ankesave
- **Maqedonia**
  - Agjencia e Shërbyesve (Nënpunësve) Civilë
  - Kontrolli i Punës
- **Kosova**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Shqiperia: DAP - Misioni

- **Departamenti i Administrates Publike ka per mision zhvillimin dhe implementimin e reformes ne sherbimin civil. Ne zbatim te misionit te tij Departamenti i Administrates Publike kryen keto funksione kryesore:**
  - menaxhon sherbimin civil ne te gjitha institucionet e administrates qendrore;
  - udheheq dhe implementon reformen funksionale dhe strukturore ne institucionet e administrates publike;
  - harton dhe implementon reformen ne fushen e pagave;
  - koordinon reformen per zbatimin e teknologjive te informacionit ne fushen e e-government.

LEGJISLACIONI I SHERBIMIT CIVIL

- **Ligji Nr. 8549, date 11.11.1999 "Statusi Nepunesit Civil"**
- **REPUBLIKA E SHQIPERISE,KUVENDI**
  LIGJ NR. 8549, date 11.11.1999, STATUSI NEPUNESIT CIVIL
  Vendim Nr.231, date 11.05.2000 "Per Pranimin ne Sherbimin Civil dhe Periudhen e Proves" i Keshillit te Ministrave (Origjinal)
- **Vendim Nr.231, date 11.05.2000 "Per Pranimin ne Sherbimin Civil dhe Periudhen e Proves" i Keshillit te Ministrave (i Ndryshuar)**
- KMV Nr 196, 6.4.2001: **PER DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.231,DATE 11.5.2000,TE KESHILLIT TE MINISTRAVE,"PER PRANIMIN NE SHERBIMIN CIVIL DHE PERIUDHEN E PROVES"**
  VENDIM Nr. 221, date 16.5.2002 PER DISA SHTESADHE NDRYSHIME NE VENDIMIN NR. 231, DATE 11.5.2000 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER PRANIMIN NE SHERBIMIN CIVIL DHE PERIUDHEN E PROVES", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.196, DATE 6.4.2001 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE .
- **VENDIM Nr.838, datë 13.12.2006 PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.231, DATË 11.5.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL DHE PERIUDHËN E PROVËS", TË NDRYSHUAR**
- **Vendim Nr. 306, date 13.06.2000 "Per Disiplinen ne Sherbimin Civil" i Keshillit te Ministrave**
- **Vendim Nr. 315, date 23.06.2000 "Per Krijimin dhe Funksionimin e Institutit te Trainimit te Administrates Publike dhe Trainimin e Nepunesit Civil)" i Keshillit te Ministrave (I ndryshuar)** (Ndryshuar me V.K.M. nr.242, datë 16.4.2004 dhe me V.K.M. nr.292, date 6.5.2005)

- **Vendim Nr. 316, date 23.06.2000 “Per Miratimin, ne parim, te Projektit “Krijimi i Institutit te Trainimit te Administrates Publike”, te financuar nga programi per Zhvillim i Kombeve te Bashkuara (PNUD)” i Keshillit te Ministrave**
- **Vendim Nr. 355, date 07.07.2000 “Per Organizimin e Dosjes per Rregjistrin e Personelit” i Keshillit te Ministrave**
- **Vendim Nr. 342, date 14.07.2000 “Per Levizjen Paralele dhe Ngritjen ne Detyre te Nepunesit Civil” i Keshillit te Ministrave**
- **Vendim Nr. 360, date 14.07.2000 “Per lirimin nga Sherbimi Civil” i Keshillit te Ministrave**
- **Vendim Nr. 325, date 21.2.2003 “ Per Pozicionin, Detyrat dhe Pergjegjesite e Sekretarit te Pergjithshem ne Ministri ” i Keshillit te Ministrave**
- **Udhezim Nr.1, date 13.06.2000 “Per Strukturen e Renditjes te Puneve ne Sherbimin Civil, Metodologjine Perkatese dhe Pershkrimit Pergjithsues te Rolit te Sekretarit te Pergjithshem ne kete Sherbim” i Keshillit te Ministrave.**
- **Udhezim Nr.2, date 07.07.2000 “Per Sistemin e Vleresimit te Arritjeve Vjetore Individuale te Nepunesve Civil” i Keshillit te Ministrave**
- **UDHËZIM Nr. 5, datë 19.12.2007 PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.2, DATË 7.7.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SISTEMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE VJETORE INDIVIDUALE TË NËPUNËSVE CIVILË"**
- PËR EMËRIMIN, LIRIMIN OSE SHKARKIMIN NGA DETYRA TË DREJTUESVE TË INTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE KRYEMINISTRIT OSE TË MINISTRIT
  UDHËZIM Nr.6, datë 19.12.2007 PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 13.6.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR STRUKTURËN E RENDITJES SË PUNËVE NË SHËRBIMIN CIVIL, METODOLOGJISË PËRKATËSE DHE PËRSHKRIMIT PËRGJITHËSUES TË ROLIT TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM NË KËTË SHËRBIM“
- **VKM Nr.173, date 07.03.2003 “Per Emerimin, Lirimin ose Shkarkimin nga Detyra te Drejtuesve te Institucioneve ne Varesi te Keshillit te Ministrave, Kryeministrit, ose te Ministrit” i Keshillit te Ministrave,** etj.

Pranimet ne Sherbimin Civil

- **a. Si mund të informoheni për vendet e lira të punës?**
- **- Departamenti i Administratës Publike publikon informacionin per vendet e lira ne gazetat me qarkullim me te madh ne vend.**
  - I njejti informacion publikohet ne kohe reale edhe ne faqen tone te internetit (www.pad.gov.al), ne rubriken vende te lira.
- **b. Si mund të aplikoni?**
  - Duke postuar dokumentacionin e nevojshem ne kutine postare nr.1751 deri ne date e treguar ne shpalljen e vendit te lire
- **c. Çfarë ndodh pasi keni aplikuar?**
  - Dokumentat tuaja shqyrtohen dhe Departamenti publikon listen e kandidateve te kualifikuar ne daten e percaktuar ne shpalljen e vendit te lire ne seline e institucionit te interesuar dhe ne faqen tone te internetitë
  - Nese konstatoni se nuk jeni kualifikuar dhe gjykoni se i plotesoni kriteret per te marre pjese ne konkurim, ju mund te beni nje ankese ne Departament brenda dy ditesh nga publikimi i listes
- **d. Rezultatet e testimit**
  - Pas zhvillimit te konkurimit ne afishojme rezultatet e testimit ne hyrjen kryesore te institucionit qe ka vendin e lire dhe ne faqen tone te internetit ne rubriken vende te lira.
  - Nese keni pakenaqesi lidhur me proceduren e konkurimit, ju mund te ankoheni ne Komisionin e Sherbimit Civil, brenda 30 diteve nga publikimi i fituesit te konkurimit
- **e. Emërtimi në vendin e punës**
  - Pas perfundimit te afatit te ankimit, fituesi emerohet ne vendin e punes nga Departamenti si nepunes civil ne periudhe prove.

Instituti i Trajnimit te Administrates Publike (ITAP)

- **Misioni: "Të trajnojë nëpunësit civil, të rrisë aftësitë profesionale dhe të përmiresojë njohuritë bazë në mënyrë që çdo nëpunës civil të kontribuojë optimalisht në arritjet dhe qëllimet e institucionit ku ai bën pjesë. ITAP-i mbështet reformimin dhe përmirësimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm dhe profesional nëpërmjet trajnimit e zhvillimit cilësor dhe gjithpërfshirës"**
- **ITAP eshte nje institucion shteteror, i krijuar ne Qershor 2000 ne kuader te reformave te ndermarra per permiresime dhe zhvillime ne administraten publike dhe sherbimin civil shqiptar, me qellim qe ato te jene sa me te qendrueshem, profesionale dhe eficiente. Veprimtaria trajnuese e tij synon qe te rrise aftesite profesionale dhe te permiresoje njohurite baze te nepunesve civile, ne menyre qe secili prej tyre, ne pozicionin perkates te permbushe sa me mire qellimet e tij dhe te institucionet . Strategjia, politikat dhe veprimtaria e Institutit bazohen ne Ligjin Nr.8549, Statusi i Nepunesit Civil, i miratuar nga Kuvendi i Shqiperise me 11.11.1999.**
- **ITAP i mbeshtetur nga Qeveria Shqiptare dhe disa organizata dhe donatore te huaj, eshte formesuar dhe ka rritur profilin, duke u kthyer ne nje faktor baze ne zhvillimet dhe progresin e administrates publike dhe sherbimit civil.**
- **ITAP ka pervojen e duhur , kapacitetet e nevojshem dhe mundesite reale per t'ju pergjigjur nevojave per trajnim te administrates publike dhe, ne teresi, vepron si nje organizate moderne, duke u bazuar ne strategji dhe plane perspektive zhvillimi, qe synojne ta kthejne Institutin ne nje qender kombetare per praktikat me te mira ne fushen e menaxhimit publik, ne promovues te vlerave qe jane ne thelb te sherbimit publik, ne burim per ceshtje te sherbimit publik.**

Baza Ligjore per ITAP

- **Baza Ligjore per krijimin dhe funksionimin e Intitutit te Trajnimit te Administrates Publike konsiston ne:**
- **• Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 315, date 23.06.2000 "Per Krijimin dhe Funksionimin e Institutit te Trajnimit te Administrates Publike dhe Trajnimin e Nepunesve Civile".**
- **• Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.242, date 16.04.2004 "Per disa shtesa ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 315, date 26.06.2000, "Per Krijimin dhe Funksionimin e Institutit te Trajnimit te Administrates Publike dhe Trajnimin e Nepunesve Civile".**
- **• Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.714, date 18.11.2005, ku percaktohet: Instituti i Trajnimit te Administrates Publike, eshte institucion ne varesi te Ministrit te Brendshem, pa prekur funksionin dhe pergjegjesite.**

Baza Kushtetuese dhe ligjore për funksionimin e Komisionit të Shërbimit Civil

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998, neni 107 ku parashikohet se nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit, nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publik rregullohet me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi Nëpunësit Civil" i cili rregullon dhe përcakton statusin e Komisionit të Shërbimit Civil i cili është një institucion i pavarur, organ administrativ, i ngarkuar me mbikqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil si dhe zgjidhjen e ankesave të nëpunësve civil në të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të ligjit të mësipërm. Ligji i mësipërm së bashku më të gjitha aktet nënligjore në funksion të tij krijojnë bazen ligjore dhe institucionale për garantimin e të drejtave të nëpunësve civil në veprimtarinë e administratës publike shqiptare, si dhe funksionimin ligjor dhe me efektivitet të saj.**
- **KShC është një institucion realtivisht i ri në strukturën shtetërore shqiptare, Ai është një institucion vendimtar në zbatim të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi Nëpunësit Civil", në fushën e shërbimit civil. KSHC është një institucion i pavarur, i ngarkuar me mbikqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil në të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të ligjit të mësipërm. Ai, është organi administrativ që zgjidh ankesat ndaj vendimeve në lidhje me pranimin, periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lëvizjen paralele, vlerësimin, masat disiplinore dhe të drejtat e nëpunësit civil. Krijimi i KSHC-së si institucion u parashikua nga ligji nr. 8095, datë 21.03.1996, "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë", specifikisht në neni 20 të këtij ligji. Ne kuader te reformimit te metejshem ai ligj u permiresua me tej nga ligji nr. nr.8549, datë 11.11.1999. Ky i fundit parashikoi dhe kreu një rregullim të plotë të problemeve në shërbimin civil si dhe të rolit të KSHC-së si një institucion i pavarur përgjegjës për mbikqyrjen dhe menaxhimin e shërbimit civil.**

Komisioni i Shërbimit Civil (KShC),

- **Krijimi i KShC, si një institucion i pavarur në strukturën e shtetit shqiptar, është një arritje e madhe në fushën e reformave institucionale dhe ligjore që ka ndërmarrë Shqipëria në kuadrin e integrimit në BE. Krijimi i tij si një institucion i pavarur në strukturën e shtetit shqiptar, është një arritje e madhe në fushën e reformave institucionale dhe ligjore. Ky institucion, i pavarur nga Qeveria, ka forcuar dhe do të të forcojë akoma më shumë rolin e tij për garantimin, stabilitetin dhe mbrojtjen e të drejtave të nëpunësve civil, rritjen e vazhdueshme të nivelit të menaxhimit të burimeve njerzore në fushën e shërbimit civil. Ai shërben si një element drejtësie, përgjegjshmërie dhe transparence në fushën e shërbimit civil shqiptar. Pra, ai ka shërbyer dhe do të shërbejë në konsolidimin, forcimin dhe përsosjen e mëtejshme të administratës publike, të shërbimit civil nga njëra anë dhe në rritjen e garancive ligjore nga ana tjetër. Strategjia e Komisionit të Shërbimit Civil për realizimin me sukses të reformave, në rradhë të parë është zbatimi me korrektësi dhe përpikmëri i Ligjit nr. 8549, dt. 11.11.1999, "Statusi Nëpunësit Civil", në fushën e mbikqyrjes së menaxhimit të shërbimit civil dhe të shqyrtimit , vlerësimit dhe zgjidhjes së drejtë ligjore të ankesave të nëpunësve civil.** dhe **SYNIMI i tij eshte qe të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e sistemit të shërbimit civil, i cili duhet të funksionoje mbi bazën e parimeve të profesionalizmit, të paanësisë politike, të pavarësisë dhe integritetit, të shërbimit ndaj publikut, të transparencës, të vazhdimësisë së karierës, duke u bërë një garant i zbatimit me korrektësi dhe përpikmëri i ligjit.**

-2-

- **Po ashtu, KShC, sipas ligjit, sherben si një garanci institucionale dhe ligjore për një bashkëpunim dhe bashkërendim optimal midis dy funksioneve politik dhe atij publik, duke ruajtur integritetin e secilit nga këto funksione, të cilat i shërbejne të njëjtit qëllim, për një shërbim bashkëkohor sa më të mirë dhe sa më me pak shpenzime . Gjithashtu mbikqyrja e manaxhimit të shërbimit civil ka rezultuar në verifikimin e një numri problematikash, sidomos në zbatimin e ligjit në institucionet e pushtetit vendor dhe në dhënien e rekomandimeve të nevojshme nga KSHC-ja për përmirësimin e gjendjes jo vetëm në njësitë e personelit por edhe në atë qëndror.**
- **Në bazë të ligjit "Statusi i Nëpunësit Civil", Komisioni i Shërbimit Civil përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen nga Kuvendi në bazë të propozimeve si vijon: dy nga Këshilli i Ministrave, një nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe 2 nga mbledhja e përfaqësuesve të pushtetit vendor, të zgjedhur sipas procedurës logjore të parashikuar në nenin 6, të ligjit të mësipërm. Institucionet e lartpërmendura propozojnë tre kandidatë për çdo anëtar të Komisionit.** Anëtarët e KSHC-së duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil të parashikuara në nenin 12, të ligjit 8549, datë 11.11.1999 "Statusi Nëpunësit Civil" dhe të jenë mbi 30 vjeç në çastin e emërimit. **Mandati i anëtarit të KSHC-së është për një periudhë kohore 7 vjet e gjysëm me përjashtim të Komisionit të parë të emëruar sipas këtij ligji, i cili iu nënshtrua rinovimit të pjesshëm nëpërmjet hedhjes së shortit.**
- Kur një anëtar i KSHC zëvendësohet, i njejti organ që propozoi këtë anëtar, do të propozojë pasardhësin e tij sipas pikës 2, të nenit 5, të ligjit të mësipërm. Anëtarët e KSHC-së janë punësuar me kohë të plotë dhe nuk duhet të kenë punësim tjtër gjatë ushtrimit të mandatit.

-3-

- **Anëtarët e KSHC-së nuk duhet të bëjnë pjesë në organet e larta drejtuese të partive politike. Anëtari i KSHC-së emërohet me votim të tjeshtë nga Kuvendi, por largimi nga detyra bëhet me votim të tre të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit për këto raste:**
- Ø **Kur dënohet me një vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;**
- Ø **Kur bëhet i paaftë fizikisht ose mendërisht për të kryer detyrat e tij;**
- Ø **Kur kryen veprimtari që krijojnë konflikt interesash;**
- Ø **Kur mungon në detyrë për më shumë se tre muaj.**
- Zëvendësimi i anëtarit të KSHC-së bëhet me mbarimin e mandatit, kur vdes, kur jep dorëheqjen dhe së fundi kur largohet nga detyra në rastet e pasqyruara më lartë e të pasqyruara në pikën 3, të nenit 7, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi Nëpunësit Civil". Anëtarët e KSHC-së gëzojnë imunitetin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. (**me ndryshimet e fundit**)
- **KSHC-ja është organ vendimmarrës dhe marrja e vendimeve bëhet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve dhe nuk lejohet abstenimi në procesin e votimit**. Vota kundër arsyetohet me shkrim dhe është pjesë e vendimit të dhënë nga shumica në votim. **Kryetari i KSHC-së zgjidhet me votim të fshehtë nga të gjithë anëtarët e KSHC-së dhe me shumicë votash**. Ai raporton në Kuvend, përgjigjet për veprimtarinë e KSHC-së dhe e përfaqëson ate në marrëdhëniet me të tretët**. Kryetari i KSHC-së zëvendësohet si dhe anëtari i tij.**

Reforma e sherbimit civil

- Ligji i pare per shërbimin civil në Shqipëri eshte ligji nr. 8095/1996. Megjithatë, ky ligj nuk u zbatua. Në 1998, reforma institucionale dhe e shërbimit civil rifitoi vëmendjen e qeverisë dhe u miratua një akt i ri i shërbimit civil (ligji nr. 8549/1999). Ligji ishte në përputhje me shumë nga standardet dhe parimet gjerësisht te pranuara Evropiane, por këto parime nuk u përqafuan plotësisht nga aktorët relevantë shqiptarë politike dhe administrative. Më pas, në periudhën 1999-2002 legjislacioni u plotësua me aktet e hollësishme nënligjore; DAP (njësia qendrore e politikave dhe menaxhimit) u forcua dhe një Komisioni Shërbimit Civil (qe i raporton Kuvendit), u ngrit për tu marre me funksionet e zgjidhjes së ankimeve dhe të mbikëqyrjes se zbatimit te legjislacionin ne shërbimit civil. Pas një periudhe të parë suksesi, në fillimin e zhvillimit të një shërbimi civil profesional dhe në përmirësimin e cilësisë së punës së administratës publike, përparimi i mëtejshëm në reformën e shërbimit civil dhe zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil rezultoi te ishte i vështire, i paqëndrueshëm dhe qe "mbeti problematik".
- Problemet kryesore, të identifikuara nga disa vlerësime mund të përmblidhen si vijon: a) rekrutimi jo i mbështetur mbi meritën (kryesisht për shkak të përdorimit të kontratave të përkohshme dhe mungesa e transparencës dhe llogaridhënies në emërimet2; b) politizimi dhe paqëndrueshmëria (pasqyruar në "qarkullimin politikisht të motivuar dhe c) menaxhimi dhe kontrolli i dobët mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil.
- Qeveria shqiptare ka pranuar shprehimisht problemet dhe nevojën për një shërbim civil profesional, të paanshëm dhe efikas, si dhe rëndësinë e një reforme të shërbimit civil. Qëllimet e kësaj te fundit duhet te jene rritja e kapacitetit e shtetit për të vazhduar reformat në zhvillim të vendit dhe modernizimin e ekonomisë dhe shoqërisë, si dhe për të përgatitur Shqipërinë për asociimin me BE dhe me tej për anëtarësimin e plote.
-

-2-

- **Shqipëria ka aplikuar për anëtarësim në BE në prill te 2009. Strategjia e zgjerimit 2009-2010, si dhe Raporti i Progresit 2009, pranojnë se Shqipëria ka bërë progres në reformat kyçe politike dhe mbi kriteret ekonomike, duke vënë në pah nevojën "për të bërë progres, në veçanti në lidhje me sundimin e ligjit dhe sidomos në luftën kundër korrupsionit, si dhe funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore, veçanërisht pavarësinë e gjyqësorit. Kapacitetet administrative dhe te zbatimit te ligjit kërkojnë forcim te mëtejshëm. Këto dokumente gjithashtu konsiderojnë forcimin e kapaciteteve administrative si "një sfidë te rëndësishme për vendet e zgjerimit qe ka nevoje te adresohet". Në këtë kontekst të veçantë, qeveria Shqiptare miratoi ne 2009, Strategjinë Ndër-sektoriale për reformat e Administratës Publike 2009-2013.**
- **Në kuader te reformës se shërbimit civil dhe të zbatimit të ligjit, eshte punuar per hartimin e nje ligj te ri per garantimin e *një shërbimi civil profesional, të qëndrueshëm, efektiv* dhe *të përgjegjshëm*, si një nga tre objektivat e saj strategjike.**
- **Per kete Departamenti i Administratës Publike (DAP), në varësinë e Ministrit të Brendshëm, ka punuar per hartimin e ketij ligji te ri mbi nëpunësit civilë qe synon përmirësimin dhe përafrimin e sistemit të shërbimit civil me standardet evropiane dhe praktikat më të mira në fushat e mëposhtme:**
- **a) forcimin e unitetit dhe homogjenitetit të regjimit të punësimit të shërbimit civil;**
- **b) forcimin e parimit te meritës ne rekrutimet;**
- **c) rritjen e mobilitetit dhe zhvillimit të karrierës brenda shërbimin civil, dhe**
- **d) përmirësimin e sistemit te trajnimit.**

Rasti i Kosoves: Historiku dhe mandati i Këshillit

- **Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (shkurtimisht Këshilli) është i paraparë në aktin më të lartë Juridik të Republikës së Kosovës, konkretisht me nenin 101 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas ligjit per te (Ligji Nr. 03/ L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës) ai është organ i pavarur që i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ai fillimisht është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe ka filluar të funksionojë në vitin 2004 në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores Nr. 2001/36 të datës 27 shkurt 2008, Këshilli është njësi e mëvetësishme, që i raporton në mënyrë të drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës dhe Kuvendi të gjitha raportet e Këshillit ia përcjell Kryeministrit.**
- **Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar edhe Ligjin nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me 30 gusht 2010. Gjithashtu edhe sipas këtij Ligji Këshilli është organ i pavarur i cili për punën e vet i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës. Funksionet e Këshillit janë të përqendruar në shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civil dhe aplikuesve për punësim në shërbimin civil të Kosovës, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil dhe vëzhgimin e zgjedhjes së nëpunësve civil te nivelit drejtues dhe niveleve të njëjta ne Institucionet e Kosovës. Baza ligjore për funksionimin e Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-028 për Proceduarën Administrative dhe aktet nënligjore që implementojnë këto ligje.**

-2-

- **Këshilli eshte angazhuar që të sigurohet një shërbim civil cilësor në frymën profesionale duke zbatuar legjislacionin për shërbimin civil që Kosova të ketë një administratë efikase me vlera dhe standarde evropiane.**
- **Fondet e Këshillit sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.**
- **ORGANIZIMI I BRENDSHËM I KËSHILLIT: KËSHILLI përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Anëtarët e Këshillit zgjidhen përmes konkursit të hapur dhe transparent dhe emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Kryetari i Këshillit zgjidhet nga vetë anëtarët e Këshillit. Mandati i të gjithë anëtarëve të Këshillit është 5 vjeçar. Në kuadër te këshillit funksion Sekretariati i tij, i cili ndihmon këshillin në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të këshillit. Sekretariati udhëhiqet nga drejtori ekzekutiv i Sekretariatit i cili i përgjigjet drejtpërdrejtë Kryetarit të Këshillit. Drejtori dhe nëpunësit e sekretariatit janë nëpunës civil.**
- **KUSH MUND TË ANKOHET NË KPMSHCK? Në Këshill mund të ankohen :**

- Nëpunësit Civilë të Kosovës dhe

- Aplikuesit për punësim në Shërbim Civil të Kosovës.

- **SI MUND TË ANKOHEMI NË KPMSHCK? Ankuesi duhet të shfrytëzojë procedurën e brendshme të organit punëdhënës(fillimisht të ankohet, në komisionin e ankesave të autoritetit punëdhënës) e pastaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përjashtimisht, në raste të përcaktuara më ligj, mund të drejtohen drejtpërdrejt në Këshill.**

Probleme që lidhen me menaxhimin e shërbimeve civile në disa vende te Ballkanit.

- Mungesa e vendimeve politike për zhvillimin e vlerave të bazuara profesionalisht dhe politikisht në shërbimin civil.
- Ndikimi politik - rekrutimi partiak
- Pranimi i menaxhimit të personelit të shërbimit qendror civil me "funksione horizontale"
- Kapacitetet e ulëta të personelit menaxhues të shërbimit qendror civil apo te nivelit të ministrive;
- Marrëdhëniet me Ministrinë e Financave në lidhje me shpenzimet buxhetore.

Probleme serioze:

- Mbrojtja e parimeve cilësore për rekrutim dhe gradim.
- Probleme koordinimi (të politikave të shërbimit civil, praktikave të menaxhimit të personelit)

Ceshtje te tjera:

- Zhvillimi i politikave konkrete.
- Hartimi i legjislacionit (parësor dhe/ose dytësor).
- Organizimi i pjesëmarrjes / ose monitorimit të rekrutimit dhe seleksionimit të procedurave.
- Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe e jo drejtpërdrejtë për vendosjen e kontrollit; sigurimi / koordinimi i trajnimit për shërbyesit civil.
- Regjistrat / bazat e të dhënave të nënpunësve civilë.

1. Disa parime baze te veprimtarise publike

Liria nuk do të thotë barazi, dhe barazia nuk është liri.

1.- **Njerëzit e lirë nuk janë të barabartë, dhe njerëzit e barabartë nuk janë të lirë**

Natyrisht këtu nuk bëhet fjalë për barazinë kushtetuese përpara ligjit, por ky pohim i referohet realitetit konkret të "barazisë" apo "mosbarazisë" lidhur me angazhimin, punën, kontributin, të ardhurat e mirëqënien materiale…

Njerëzit e barabartë nuk janë të lirë.

Të mos mundohemi që të marrim njerëz të pabarabartë dhe t’ i kthejmë ata në një masë homogjene të barabartë, sepse kjo mund të bëhet vetëm duke paguar çmimin tepër të shtrenjtë të humbjes së lirisë individuale e shoqërore.

“Komente” shqiptare

- Natyrisht këtu nuk behet fjale per cënim te barazise përpara ligjit, edhe pse në këtë drejtim ka mjaft shqetësime, përsa i përket respektimit të njëjtë të ligjit dhe detyrimeve ndaj tij, shpenzimeve shtetrore (qeveritare, parlamentare, presidenciale, etj), abuzimeve, manipulimit të opinionit publik, trysnisë mbi median, etj.; por bëhet fjalë për mosbarazi nga pikëpamja ekonomike, pra, në të ardhura e pasuri materiale. Dhe kjo sepse njerëzit e lirë nuk mund të jenë të barabartë financiarisht, madje kur njerëzit kanë “gradë të mjaftueshme lirie” në veprimtarinë e tyre dhe punojnë pa trysni artificiale për të rritur mirëqenien, të ardhurat e përftuara nuk ka sesi të jenë të barabarta. Pra, kur ligjërohet e zbatohet drejt ky parim politik, pa abuzime, nga njera anë, dhe pa ryshfete, diferencime trajtimi e “trysni” tatimore e politike, nga ana tjetër, njerëzit, nëpërmjet punës së tyre të pastër, mund të arrijnë nivele tepër të ndryshme të ardhurash, pra dhe pasurie. Por individët ndryshojnë, jo vetëm nga karakteri, por edhe përsa i përket dëshirës dhe aftësisë për punë e mënyrës së tyre të jetesës. Disa punojnë më shumë, më gjatë, dhe më me zgjuarsi, por mund të jenë dhe kursimtarë, ndërsa të tjerë pretendojnë të lodhen më pak, të “gëzojnë” më shumë jetën dhe kohën e tyre, të bëjnë më shumë qejf duke shpenzuar më shumë para. Dhe kjo nuk ka sesi të mos pasqyrohet në pabarazinë ekonomike, edhe sikur këto individë të kenë të njëjtat të ardhura apo të kishin të njëjtën pasuri më parë. Këtu përjashtim, natyrisht, bën rasti kur në mënyrë abuzive ky “qejfllëk” bëhet me para që dalin nga xhepi i të tjerëve, apo qoftë ky dhe i taksapaguesve! Ndërkohë, që përvoja e jonë e gjatë, gati 50 vjeçare, tregon se prirjet e propagandimit dhe të realizimit të barazisë, apo më saktë të njëtrajtëshmërisë midis pjesës dërmuese të njerëzve, mund të arrihen vetëm në kurriz të humbjes së lirisë së tyre.

-2-

- **Kur ndryshimet në të ardhura janë rrjedhojë e veprimtarisë së lirë e të ndershme të njerëzve diferencat në të ardhura janë mëse të natyrshme. Nëse ato vijnë si rezultat i "manovrimeve" apo pengesave politike e ligjore artificiale, atëherë të zhduken këto pengesa, nëse ato vijnë si rrjedhojë e abuzimit dhe inkriminimit të luftohen ashpër këto dukuri, por aspak vetëm me deklarata tepër të bollshme që po i ndeshim sot në çdo nivel, as me "bujë"e me tip "show" mediatik apo me mbledhje propagandistike , por me ligje të rrepta, me rregulla e struktura efektive e adekuate, me reformin në vazhdimësi e rritje profesionalizmi brenda institucioneve e vetë sistemit të drejtësisë.**
- **Nga ana tjetër, është detyrë e shtetit dhe e bashkësive të tjera të shoqërisë për të garantuar funksionimin e skemave të asistencës sociale dhe siguruar minimumin jetik për shtresa të varfëra apo të margjinalizuara. Por kjo nuk do të thotë aspak se në këtë mënyrë njerëzit e pabarabartë mund të shndërrohen në një masë homogjene e jo të lirë. Kjo jo vetëm nuk arrihet dot, por me të tilla përpjekje të "antilirisë" do të prodhohej vetëm bllokimi, madje deri rrënimi ekonomik e shoqëror.**

Prona e individit dhe ajo e përbashkët.

2- **Çfarë i përket individit, atë ai mundohet ta ruajë; ajo që s'i përket askujt apo të gjithëve atë e pret mospërfillja, madje ndonjëherë dhe shkatërrimi.**

Ky parim është një mishërim i fuqisë reale të pronës private dhe i dështimit të ekonomive rigorozisht të përqëndruara.

“Koment” shqiptar

- **Në këtë trajtë formulimi ky parim nënvizon fuqinë e “magjinë” e pronës private dhe shpjegon shumë qartë dështimin e ekonomive të “socializuara”, apo më saktë të shtetëzuara, në mbarë botën. Madje, në kundërshtim me thelbin e këtij parimi, në të gjitha vendet ish socialiste si bazamente epërsore ekonomike u shpallën: planifikimi i qendërzuar dhe prona shtetërore. Për më tepër propagandohej me “tam tam” se burimet e vendit mund të përdoreshin në të mirë të të gjithëve vetëm po të ishin nën administrimin e qeverisë. Dhe kështu ajo që më parë ishte ushqimi i fermerit, u bë “ushqimi i popullit”, dhe popullin e pllakosi varfëria. Apo ajo që ishte dikur fabrika e sipërmarrësit, u bë “fabrika e të gjithëve”, dhe prodhimet ishin aq jocilësore, saqë nuk gjenin treg shitjeje përtej kufijve, përveç konsumimit me “detyrim” brenda “familjes së përbashkët”. Vetëm kaq mjafton për të kuptuar se burimet realitivisht të kufizuara të shoqërisë mund të pakësohen, të dëmtohen apo të rrënohen nëse ato u merren atyreve që i kanë krijuar apo fituar në kohë e me djersë dhe iu jepen për administrim ndonjë autoriteti qendror, ose transferohen në një dorë tjetër ndërmjetëse. Nën këtë optikë mund të intensifikohen me tej si përshpejtimi pa më të voglin hezitim i procesit të privatizimit, veçanërisht atij strategjik, siç duhet të konsiderohet dhe sektori i energjisë, por dhe ai i fushës së shërbimeve qëndrore apo vendore; dhe së dyti, gjetja e një zgjidhjeje, në kushtet aktuale, sa më optimale, por dhe me përmbajtje kompromisi, pse jo dhe në trajtë refendare, për çështjen e pronës. Këto çështje janë tepër madhore, që nuk mund të përdoren për “kapital politik” apo fushate elektorale...**

Gjithëpërfshirje dhe afatgjatësi.

3. Një politikë e shëndoshë publike kërkon që të marrim parasysh efektet afatgjata dhe të përfshijmë të gjithë njerëzit, jo efektet afatshkurtra dhe vetëm disa njerëz.

Domosdoshmeri ndihma sociale për grupime të veçanta në nevojë, por kjo duhet të jetë e tillë që të mos nxisë pasivitetin, të krijojë vartësi ndërmjet brezave e gjinive, humbje shpresash apo patologji të dëmshme, zhdukja e të cilave do të kërkonte për rigjallërim breza të tjerë të tërë.

Jo politike per politike!

Një kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet dhe përpunimit sa më efektiv të skemës sociale, por jo më në kuptimin që një pjesë jo e vogël e njerëzve të përfitojnë në vazhdimësi vetëm nga "çeqet" e ndihmës sociale. Një gjë e tillë, me kalimin e kohës, si një trajtë përfitimi pa mundësi kontributi të drejtpërdrejtë nxit dembelizmin, krijon patollogji të dëmshme kulturore, sjell një vartësi ndërmjet brezave, madje dhe humbje shprese, por mund të shoqërohet dhe me një kosto tepër të madhe për shoqërinë, skemën sociale dhe atë pensioneve. Pra, shteti, qoftë dhe ai më sociali, nuk mund të shërbejë më vetëm si një makineri kryesore e shpërndarjes së të mirave materiale. Përkundrazi, më shumë sot duhet të synohet të reformohet koncepti i shtetit social drejt shtetit të investimeve sociale, me zhvendosje të vëmendjes nga të shpenzuarit e parave vetëm për asistencë sociale drejt investimeve në kapitalin njerëzor. Nga ana tjetër, politika publike e shpenzimeve deficitare dhe e fuqizimit të ndërhyrjes, trysnisë e të kontrollit autoritaro-arbitrar të qeverisë qëndrore, në kurriz të lirisë ekonomike, mund të pasurojë fillimisht vetëm disa njerëz, madje me të padrejtë, por më tej mund ta brej në thelb ekonominë, mjedisin dhe karakterin moral të shoqërisë për dhjetëvjeçarë me rradhë...

Sepse e sotmja është pikërisht dhe ajo e nesërme që hartuesit e zbatuesit e politikave të këqija dje, bënë çmos për të na "bindur", bile na trysnuan apo "detyruan" dhe t'i pranonim ato. Në këtë kuptim do të ishte e sukseshme vetëm ajo politikë publike krejtësisht transparente në ndjekje dhe zgjidhje të shqetësimeve të shoqërisë, si përgjigje e vetë kërkesave të përgjithësura të opinionit publik dhe aspak e gjenerimeve të pafrytshme të një politike vetëm për politikë!

Inkurajimi dhe dekurajimi

4. **Nëse diçka e inkurajoni, do të përfitoni më shumë prej saj; nëse diçka e dekurajoni, përfitimi prej saj do të jetë më i pakët…**

Inkurajimi e mbështetja sjell zhvillim.

- Ky parim vlen të konsiderohet me shumë seriozitet në çdo rast, perfshire dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë. E kundërta rezultoi, p.sh., për bluarësit shqiptarë të grurit, në marrëveshjen mbi miellin e importuar nga Serbia. Kjo vlen dhe për inkurajimin e biznesit shqiptar për të investuar në fushën e energjisë, të shërbimeve publike, etj. Në fund të fundit, individët e grupimet e tyre, si qënie njerëzore e shoqërore, ndikohen nga stimujt e incentivat, nga njera anë, apo dhe pengesat, hezitimet e frenimet, nga ana tjetër. Ata iu përgjigjen shpejt apo vonë atyre, madje ndonjëherë dhe tepër fuqishëm. Hartuesit e politikave, që e harrojnë këtë element me rëndësi, të psikologjisë individuale e shoqërore, mund të "prodhojnë" deri dhe gabime trashanike.
- Për një ilustrim , po marrim një shembull jo nga Shqipëria, por nga SHBA. Kështu, në verën e vitit 1990, Kongresi rriti në mënyrë dramatike taksat mbi mjetet lundruese, avionët dhe bizhuteritë. Arsyetimi për këtë ishte se, p.sh., meqë këto të fundit blihen nga të pasurit, le t'i blejnë ato, por me taksa më të larta. Ndryshe, nga parashikimi në vjeljen e të ardhurave nga këto taksa të reja për vitin e parë, u arrit të mblidheshin vetëm gjysma e parashikimit. Por, për më tepër, si rrjedhojë e shkurtimeve nga puna në këto industri për shkak të shitjeve më të pakta prej këtyre taksave më të larta, u shpenzuan edhe nje sasi tjeter gati 80% e parashikimit te fitimit, si asistencë për të papunët e rinj. Madje, siç shprehen në Washington, në rastet kur ligjbërësit e harrojnë rëndësinë e stimujve, mund të synohet 31, fitohet vetëm 16 dhe shpenzohet më shumë 24, dhe megjithatë gjykohet se në një farë mënyre është bërë diçka e mirë. Por raste të tilla nuk mungojnë as në inisiativat ligjore ne nivelin shqiptar.
- Pa e banalizuar aspak problemin, mund të thuhet se veprimi i këtij parimi publik ka një ndikim të fuqishëm në zhvillimin ekonomik, veçanërisht në perspektivën e tij. Aq sa, për ironi, lidhur me pyetjen: "A doni të pakësoni kursimet dhe investimet?, me njëherë mund të formulohet dhe përgjigja : "Dyfishoni taksat mbi këto fitime, dhe "vërini kapak" me një tatim fitimi të majmë për buxhetin", por ama shumë shpejt do të shfaqet stanjacioni, dhe pak më vonë edhe rënia ekonomike. Apo akoma për pyetjen: "Si mund të bjerë ritmi i punës?" menjëherë del dhe përgjigja: "Tatojeni atë aq shumë sa njerëzit të mendojnë se nuk ia vlen të lodhen kot"!…

Shpenzimet qeveritare.

5. Askush nuk i shpenzon paratë e tjetrit aq me kujdes sa shpenzon të tijat.

Sipas ketij parimi, ***së pari, kur shpenzohen paratë personale për vete, gabohet tek-tuk, por rrallë dhe jo vazhdimisht; së dyti, kur përdoren këto para për t'i blerë dikujt një dhuratë, bëhet çmos që objekti i blerë të justifikojë paratë e prishura, paçka se në fakt mund të jetë diçka që s'i hyn në punë apo s'i pëlqen marrësit, së treti, kur përdoren paratë e dikujt tjetër për të blerë diçka për vete, ai, që blen, përpiqet të marrë gjënë e duhur, por pa e vrarë mëndjen për të kursyer; dhe e fundit, kur shpenzohen paratë e dikujt për të blerë diçka për një tjetër, lidhja ndërmjet atij që i fiton paratë, atij që i shpenzon, dhe marrësit, është shumë e dobët dhe mundësia për abuzim është shumë më e madhe.***

Por kjo është pak a shumë dhe ajo që bën qeveria qëndrore e vendore! Prandaj shërbejnë dhe mekanizmat e kontrollit, të investigimit e penalizimit, krahas "fuqisë periodike" korrigjuese të vetë votës së lirë. Dhe për fuqizimin konkret e konsolidimin e tyre

shërben vetëm politika e hapur, konstruktive e qytetare.

6. Qeveria, shteti nuk ka asgjë ç’të japë, përveç asaj që e merr më parë diku tjetër; dhe një qeveri që e ka atë mundësi që të japë çdo gjë që kërkohet, ka po aq mundësi që të marrë çdo gjë që ke.

Duke komentuar këtë parim publik, George Washington ka nënvizuar:
“Qeveria nuk është elokuencë. Është forcë. Dhe ashtu si zjarri, mund të jetë një shërbyes i vyer ose një padron i frikshëm.”
Ndërsa Jefferson ka paralajmëruar se ekziston gjithmonë një prirje, që
“qeveria të fuqizohet dhe liria të kufizohet”.

Nevoja per rregullime te shpejta ne nivel kombetar

- **Rregullimi i skemave te sigurimeve sociale. Skema e pensioneve dhe binomi shtet-privat. Rregullime ne mjedisin publik dhe privat, perfshire dhe zhvillimin e metejshem te skemave private.**
- **Reformimi i institucioneve qe perfaqesojne keto objektiva ne perputhje me me standarde te pranueshme por dhe duke ndertuar besimin mbi vete keto institucione**
- **Transparence dhe mbrojtje, perfshire dhe asistencen sociale.**
- **Sigurimet shendetesore- Probleme serioze ne Shqiperi!**

Ndërhyrja qeverisëse.

***Ndërhyrje e dobët në kushte normale*.**

Lidhur me qeverisjen, në zbatimin e një politike të drejtë publike, sic e theksuam me siper: *"Qeveria nuk ka asgjë tjetër ç' të të japë, përveç asaj që u merr më parë të tjerëve, ndërsa një qeveri që ka mundësi të të japë çdo gjë që i kërkohet, ka po aq mundësi që të të marrë dhe çdo gjë që ke."* Madje George Washington-i, që në kohën e tij paralajmëronte se, edhe në rastet kur qeveria e bënte punën e vet aq mirë, sa mund të quhej me të vërtetë një "shërbëtore" e popullit, prapësepraprë do të ishte një shërbëtore e rrezikshme! Ndërsa Jefferson-i e ka stigmatizuar këtë si një "prirje" të fuqizimit të qeverisë në kurriz të kufizimit të lirisë njerëzore e ekonomike. Dhe me të vërtetë një popull realisht i lirë dhe i pavarur nuk mund t'i mbajë "verbërisht" shpresat vetëm tek qeveria në sigurimin e jetesës.

Përkundrazi, ai duhet ta shohë atë, në kushte normale, vetëm si një mekanizëm, buruar nga vota demokratike, për të garantuar funksione të lidhura ngushtë me: sigurinë e qetësinë njerëzore, me ruajtjen e paqes sociale, me programimin e zhvillimit dhe të investimeve në zona prioritare, me rritjen maksimale të përpjekjeve për shanse e mundësi të barabarta për të gjithë, etj. Në këtë kuptim nuk është e tepërt të thuhet se "filozofia" e kërkesave, e mbështetjes dhe e të gjitha zgjidhjeve, qoftë dhe për "lojë" opozitare, vetëm tek dhe nga qeveria përbën një prirje apo kompromis me pasoja mjaft të rënda për zhvillimin ekonomik e shoqëror të një populli.

Ndërhyrje e fortë në kushte ristrukturimi.

Por ndryshe qëndron puna në situata stanjacioni e krizash ekonomike apo dhe në ato raste, në të cilat ristrukturimi bëhet i detyrueshëm. Në të vërtetë, në këto raste, ristrukturimi është një nga sfidat më kryesore të qeverisjes e të politikbërësve të ekonomisë. Madje, në raste të tilla qeveria është e detyruar të marrë një rol udhëheqës, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë, sepse në këto kushte si domosdoshmëri del përcaktimi prioritar i pikësynimeve politike, korrektimi i shpejtë i dështimeve në politikën e tregut, reformimi konkret në sistemin ligjor dhe të taksave, krahas përballimit dhe të rezistencës së grupeve të fuqishme të interesit dhe vetë konfliktit të mundshëm të interesave në gjirin e qeverisjes.

Në këtë mënyrë, ne radhe te pare, veprimtaria e ristrukturimit:

- duhet të përmbajë formulimin e adaptimin e kornizave të ndërhyrjeve e të politikave makroekonomike, ligjore e strukturore, që janë dhe themeli i saj.

Më pas e ka fjalën:

- ristrukturimi financiar për të konkretizuar incentivat e duhura për sistemin bankar për t'u vënë në ballë të ristrukturimit, dhe, mbi këtë bazë, dhe të rikreditimit të ekonomisë.

Vetëm në këto kushte bëhet më e qartë se ç'veprimtari ekonomike duhet të mbijetojë dhe cila duhet të likuidohet. Pra, natyrshëm, në ekonominë e lirë të tregut, ndërhyrjet e qeverisë apo të mazhorancës qeverisëse, në kushte ristrukturimi, krahas aspektit legjislativ e menaxhueso-drejtues, kanë të bëjnë me ndërmjetësimin, skemat incentive, rikapitalizimin bankar, etj., duke shqyrtuar njëkohësisht si sektorin prodhues e të shërbimeve, ashtu dhe atë financiar e të mbrojtjes sociale.

Nderhyrja me ane te politikave ekonomike konkrete

- Në këtë spektër të gjerë të ndërhyrjes me anë të politikave ekonomike kanë rëndësi:
- -së pari, stabiliteti ekonomiko-politik, për të krijuar besueshmëri në ristrukturimin e borxheve, madje për këtë një vlerë të veçantë merr qëndrueshmëria e çmimeve, e përqindjeve të interesit dhe shkëmbimit, si garanci e nevojshme ndaj debitorëve, kreditorëve dhe investitorëve potencialë për biznes;
- -së dyti, ndërhyrja, për përcaktimin e mbijetesës apo likuidimin e bizneseve të rrezikuara duhet të jetë e menjëhershme;
- -së treti, përfshirja e të gjitha grupeve politike e ekonomiko-financiare për formulimin e një strategjie të përbashkët e rrit kredibilitetin e ndërhyrjes, por dhe transparencën e paraqitjes së objektivave kryesore, detyrave dhe metodave të zbatimit;
- -së katërti, mbështetja e ristrukturimit nga një mjedis rregullator e ligjor sa më efektiv;
- -së pesti, realizimi i standardeve të kohës në procesin e ristrukturimit, bile duke "importuar" praktikat më të mira të njohura nga ana ndërkombëtare;
- -së gjashti, fatura sociale shoqëruese për mbylljen e veprimtarive joefektive, në ndihmë të varfërve dhe në sigurimin e një qetësie të domosdoshme në vetë procesin e ristrukturimit.
- Një problem ne vete (me pasoja të pakthyeshme ekonomike) është dhe shitja e aseteve mjaft nën kufij të pranueshëm.

Skema incentivash të financuara nga qeveria.

- **Ristrukturimi i kompanive mund të fillojë në mënyrë serioze vetëm kur bankat dhe lojtarët e tregut të jenë të gatshëm dhe të aftë për të marrë pjesë në këtë proces. Por dhe këtu pa procedura ligjore, efektive, kohëshkurtëra e transparente falimentimi, vetë procesi mund të zhvillohet mjaft ngadalë, duke krijuar vonesa, probleme e dëme serioze. Për të shmangur këtë, në mënyrë të natyrshme, duhet të zbatohen dhe politika incentive. Madje incentivat financiare me mbështetjen e qeverisë duhet të shmangin dhe "stresimet" apo frenimet e ristrukturimit, që mund të shfaqen në mënyrë sistematike, nga vetë tregu apo kuadri rregullator. Ndërkohë dhe qeveria duhet të jetë e sigurtë që disponon burimet e nevojshme financiare të brendshme apo të jashtme.**

Liria

7. Liria në kuptimin më të përgjithësuar të saj është gjëja më e rëndësishme në botë.

Politika publike dhe pjesëmarrja, e cila e përjashton lirinë, ose nuk e ruan apo e fuqizon atë, por e përqëndron atë **në një apo disa duar**, duhet menjëherë të vihet në dyshim nga mendjet e njerëzve **vigjilentë**, madje sipas Beniamin Franklinit: ***"ajo apo ai që heq dorë nga liritë thelbësore qoftë dhe për një siguri të vogël të përkohshme, nuk meriton as liri e as siguri"***.

Vlera e lirisë.

- Pra, në thelbin e tyre parimet e mësipërme lidhen ngushtësisht me konceptin e lirisë, jo si një luks apo ide e bukur, por si një domosdoshmëri zhvillimi. Politika publike e cila e përjashton lirinë, ose nuk e ruan apo e fuqizon atë, duhet menjëherë të vihet në dyshim nga opinion i gjerë publik. Në këtë kontekst kushdo ka të drejtë të pyesë: Përse sot shumë nga institucionet qëndrore konsumojnë më shumë nga pjesa e përgjithshme që prodhohet apo shpërndahet në vend? Megjithatë, pak njerëz apo grupime oponente duken të interesuar t'i drejtojnë "avoketërve" të këtij shpenzimi të padrejtë, veçanërisht në kushtet e varfërisë aktuale, pyetje të tilla si: "Përse kjo rritje? Edhe sa shpenzime të tjera do të kërkoni, sidomos për shtimin e njerëzve jo të domosdoshëm? Përse kjo dorëlëshuarje vetëm tek puna apo shpenzimet e shtetit? Përse kjo mbyllje sysh ndaj emërimeve me konflikt interesash?, ose akoma më "filozofikisht": "A respektohen kriteret në emërime dhe sa është masa e shpenzimit të domodoshëm shtetëror për të kryer "me zemër" e efektivitet detyrat në shërbim të qytetarëve? Mos vallë kemi të bëjmë këtu me një keqintepretim të lirisë, veçanërisht të lirisë ekonomike, si shtyllë themelore e zhvillimit? etj. Pa tentuar për të dhënë përgjigje ndaj këtyre pyetjeve sepse këtë e ka të mundshme ta bëjë kushdo mund të pohohet se politika publike shqiptare është akoma larg të qënurit neutrale dhe e shëndetshme, madje larg fazës së maturimit profesional, duke shfaqur kohë pas kohe edhe hapa mbrapa
- Megjithatë, në rrjedhje të viteve është fuqizuar zëri publik e neutral, që e ka kuptuar dhe mbron instalimin e parimeve të mësipërme në praktikën e përditshme, si domosdoshmëri për ruajtjen e atij elementi kyç të jetës sonë e të zhvillimit demokratik që e quajmë thjesht liri.

VI. 2. Toleranca dhe Dialogu. Pjesemarrja qytetare

-**Toleranca e dialogu brenda familjes**, si celulë e shoqërisë.

-**Toleranca e dialogu kulturor e ndërkulturor**.

-**Toleranca e dialogu ndërfetar**.

-**Toleranca dhe dialogu ndëretnik**.

-**Toleranca e dialogu social** (midis punëmarrësve e punëdhënësve, lëvizjes sindikaliste dhe strukturave shtetërore, etj.)

-**Toleranca dhe dialogu institucional** (shembuj).

-**Toleranca e dialogu politik** (aleancor, ndërpartiak, pozitë-opozitë!)

Pjesëmarrja Qytetare.

1. Pjesëmarrja qyetare si një e drejtë themelore e njeriut.
2. Pjesëmarrja qytetare - si qëllim e instrument i zhvillimit njerëzor, pjesë e procesit te qeverisjes.
3. Aspekte të pjesëmarrjes dhe rëndësia e saj.
4. Kushtet për pjesëmarrje qytetare. (Ndikimi social-ekonomik e gjeografik në pjesëmarrjen qyetare).
5. Dimensioni politik i pjesëmarrjes qytetare (Barazia gjinore)..
6. Pjesëmarrja qytetare dhe kontrolli publik është një sfidë jo vetëm për qytetarët por dhe politikanët në pozitë e opozitë.
7. Ceshtje të tjera.

1. Pjesëmarrja qytetare-një e drejtë themelore e njeriut.

Pjesëmarrja është një koncept neutral i lidhur ngushtë me qeverisjen, por dhe thelbin e demokracisë. Ky koncept për vendimmarrjen e grupit është zhvilluar paralelisht me thellimin e demokratizimit të Qytetërimit Perëndimor. Në historinë e tij ai e ka origjinën në të drejtën e vjetër greke që me Republikën e Platonit (koncepti platonian mbi lirinë e fjalës, të mbledhjes, të votimit dhe të përfaqësimit të barabart, etj). Ky koncept është transferuar në epokën romake si një e drejtë e veçantë republikane dhe më tej gjallëruar nga mendimtarët e Revolucionit Francez. Ai morri një kuptim më të plotë politik në shekullin e XX-të, për t'u shndërruar në një tipar thelbësor të demokracisë bashkëkohore.

Forma moderne e qytetarisë pjesemarrese është zhvilluar në mënyrë dinamike nga një pjesëmarrje ndërmjetëse publike në një përfshirje të drejtëpërdrejtë në qeverisje. Ajo ka shfaqur tri faza: atë të "konsumatorit", pjesëmarrjen nëpërmjet ndërmjetësimit me anë të strukturave të institucionalizuara, dhe së fundi modeli i pjesëmarrjes qytetare të drejtëpërdrejtë. Sipas nivelit te pjesëmarrjes bëhet dhe dallimi midis qytetarit aktiv e pasiv.

2. Pjesëmarrja qytetare - si qëllim e instrument i zhvillimit njerëzor, pjesë e procesit te qeverisjes.

Pjesëmarrja qytetare mund të bëhet në mënyra të ndryshme, nëpërmjet zbatimit të ligjit, pagimit të taksave, ruajtjes së mjedisit, etj. Por një rol të rëndësishëm duhet të marrë përfshirja në vendimmarrje. Ajo e ndihmon publikun të ndikojë për cilësinë dhe vëllimin e shërbimeve publike nëpërmjet formave të ndryshme të artikulimit të preferencave apo kërkesave. Nëpërmjet kësaj pjesëmarrje zhvillohet njëkohësisht dhe procesi i tranzitimit nga individë në qytetarë (Fillimi në familje me marrjen e përgjegjësive, ne kuader te barazi gjinore e tolerancë).


Angazhim politik
....
Vendimmarrje publike
Zgjidhja e konflikteve
Mbrojtja e natyres dhe mjedisit.
Respektimi i ligjit, pagesa e taksave, etj.
Toleranca
Dialogu
Nderveprimi

3. Aspekte të pjesëmarrjes dhe rëndësia e saj.

Aspekti interaktivo-komunikues (si të shprehim e të realizojmë kërkesat e nevojat e grupit).
Aspekti informues-njohës (informimi për rrezikshmërinë, njohja më e mire e dukurisë për rritje pjesëmarrjeje- p.sh., rasti i plehrave).
Aspekti humanitar (si të njohim e të çmojmë nevojat individuale dhe të grupit dhe të kontribuojmë për zgjidhjen e tyre).
*Aspekti volontarist (*efektivitet, reduktim shpenzimesh, mbarëvajtje, përkujdesje e mëvonshme, etj.).
Aspekti ndërmjetësues (si të zgjidhim konfliktet e interesave për mirëkuptimin e mbarëvajtjen e grupit, nëpërmjet dialogut e tolerances- rasti i paqësimit te familjeve në gjakmarrje).
Aspekti korrektues (kundër favoreve të "partitizmit" politik, korrupsionit administrativ, nepotizmit, etj.).
Aspekti reagueso-organizues ndaj kërcënimeve të llojeve të ndryshme (rritet pjesëmarrja, p.sh. në periudha krizash serioze).
Aspekti detyrues ose vetëdetyrues (në raste krizash, si ajo e Kosovës apo kur p.sh. ndodh ndonjë fatkeqësi në nivel individual, lokal apo kombëtar)

4. Kushtet për pjesëmarrje qytetare.

(Ndikimi socialo-ekonomik e gjeografik në pjesëmarrjen qyetare).

- Një organizim të përshtatshëm për pjesëmarrje vullnetare.
- Kredibiliteti i drejtimit është një kërkesë e rëndësishme.
- Prekja e rezultatit apo përfitimi për bashkësinë, jo patjetër me natyrë ekonomike.

Për këtë kërkohet, përveç pjesëmarrjes, edhe më shumë trajnim e profesionalizëm, dhe në ndonjë rast, edhe kontribut financiar individual të anëtarit të bashkësisë, por ai duhet t'i përgjigjet detyrimisht nivelit ekonomik të pjesëmarrjes qytetare (projektet e Fondit të Zhvillimit me kontribut të komunitetit 5-10%).

- Komoditeti për pjesëmarrje aktive brenda grupit përkatës (të barabartë, joinferiorë e pa komplekse).

Vihen re pabarazi e dallime: pjesëmarrje shumë e ulët për shtresa të marxhinalizuara: si më të varfërit, më pak të shkolluarit, të pastrehët, të papunët, invalidët, ruralët, grupet minoritare, etj. që normalisht janë dhe më të interesuarit).

Arsyea kryesore–baza e dobët ekonomike dhe sociale, që nënkupton që variabli socialo-demografik e gjeografik është ende mjaft i ndjeshëm për pjesëmarrjen qytetare në kushtet e Shqipërisë. Nevoja për më shumë tolerancë etno-kulturore dhe solidaritet, p.sh. me romët.

5. Probleme të tjera.

-Decentralizimi i pushtetit rrit pjesëmarrjen në nivel lokal.
-Bazë ligjore më e mire për pjesëmarrje. Referendumi në kushtetutë është një gjë e tillë. (p.sh. në përmirësimin e legjislacionit, apo lidhur me vendime që prekin qytetarin, kundërshembull hedhja poshtë nga Gjykata Kushtetuese e kërkesës për referendum për të kundërshtuar rritjen e moshës së pensionit,etj.)
-Domosdoshmëria e konfidencës.
-Pjesëmarrje qytetare mjaft e vlefshme në dialogun autoritete vendore-autoritete qendrore (sidomos në kushte kohabitacioni).
-Media mund të kthehet në një faktor të rëndësishëm: për shprehjen e opinionit qytetar, si mediatore, dhe si ndërtuese e pozicionit të pavarur qytetar
-Demaskimi qytetar i korrupsionit (pjesa dermuese e shqiptarëve e konsiderojnë mjaft të përhapur korrupsionin e vogël apo administrativ (në trajtën e rryshfetit), po praktikisht po aq e konsiderojnë një shqetësim serioz për shoqërinë shqiptare korrupsionin e madh apo atë në nivelin e vendimmarrjes politike dhe të biznesit)

Pamje globale (Politika dhe Biznesi)



Imoraliteti politik, sipas rajoneve



6. Dimensioni politik i pjesëmarrjes qytetare.

6.1.Shtrirja dhe format e pjesëmarrjes qytetare midis dy proceseve zgjedhore përcakton dhe trajtën specifike të sjelljes qytetare gjatë zgjedhjeve. Zgjedhjet nuk ezaurojnë përmbajtjen dhe shumëllojshmrinë e jetës politike.

-Asambletë e qyteteve p.sh. në traditën amerikane, kanë qenë një nga shembujt e vjetër të pjesëmarrjes qytetare në marrjen e vendimeve. Por më vonë përfaqësimi i deleguar zuri në shumicën e rasteve vendin e tyre. Në rastin e Shqipërisë një rol të tillë, p.sh. e kanë luajtur historikisht pleqësitë e fshatrave). Pretendimi:-Shndërrimi i qytetarit nga një votues pasiv në një pjesëmarrës aktiv në jetën politike.

6.2. Forma të ndryshme **të pjesëmarrjes qytetare në jetën politike (anëtarësia e pjesëmarrja në strukturat organizative politike, ndërveprimi midis qytetarëve dhe autoriteve vendore, marrëdhëniet midis qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre në Kuvend apo dhe manifestimet e ndryshme të "aktivizimit politik").**

- Pjesëmarrje relativisht e kufizuar politike :

-Pasaktësitë në procesin zgjedhor dhe kundërshtitë e lindura pas përfundimit të tij flasin qartë për pasivitetin qytetar më shumë midis zgjedhjeve sesa gjatë zgjedhjeve.

-Zvogëlimi gradual e pjesëmarrjes në votime flet gjithashtu për indiference, shkëputje e nje lloj reagimi te qytetarëve ndaj qeverisjes.

- Ridimensionimi i metejshem i konceptit të barazisë gjinore në përfaqësimin politik. (perfshire përfaqësimin e gruas në këshillat e komunave, të bashkive dhe të qarqeve).

Qytetaria civile (edhe njehere)

Qytetaria civile ka të bëjë me të drejtat e liritë individuale, me lirinë e zgjedhjes së individit, me lirinë e shprehjes, mendimit, fesë e të organizimit. Po ashtu ajo përfshin dhe të drejtën e pronës (fizike ose intelektuale), të drejtën për të marrë pjesë në kontrata të rregullta apo për të kërkuar drejtësi nëpërmjet ligjit.

Edhe kjo kolonë paraqet shqetësime serioze në një pjesë të përbërësve të saj, sidomos me uljen e efektivitetit qeverisës, rritjen e ndikimit monopolist e korruptimit administrativ, të trajtimit të paqartë, deri abuziv, të pronës, etj.

Qytetaria sociale (vazhdim)

Qytetaria sociale mbulon një gamë të gjerë çështjesh, nga e drejta për siguri njerëzore dhe garantimin e një minimumi jetik apo mirëqenieje, deri tek e drejta për ndarje të barabartë të trashëgimisë sociale, sidomos për çështje thelbësore si edukimi, kujdesi shëndetësor e ruajtja e mjedisit, në përputhje me standardin mesatar të shoqërisë.

-Mund të veçohen dy aspekte të qytetarisë sociale:

A) ai i "nevojave" bazë, ku edukimi dhe shëndeti mbeten parësorë B)"integrimi social", që lidhet me punësimin, luftën ndaj varfërisë dhe pabarazisë së theksuar midis individëve apo rajoneve të ndryshme. (Megjithëse treguesi i zhvillimit njerëzor apo HDI (Human Development Index) ka pësuar ngritje (p.sh., nga vlera 0.740 në vitin 2000 në vlerën 0.781 në vitin 2002, duke i dhënë Shqipërisë vendin e 65-të midis 177 vendesh, *Human Development Report 2004*) nuk mund të mohohet se problemet e rënda ekonomiko-sociale, krijojnë barriera serioze për zhvillimin e qytetarisë demokratike, duke furnizuar kështu deri kontingjente "fanatikësh" në një fushatë zgjedhore apo dhe shtresime "materialisht të manovrueshme" gjatë tyre. Por zhvillimet ne Evrope e Azine Qendrore kane bere qe HDI ne keto rajone ne mesatare te rritet nga vlera 0.644 ne 1980 ne vleren e sotme 0.751, duke e zhvendosur Shqiperine nen kete mesatare rajonale.

HDI sherben si alternative e mases se zhvillimit kombetar,(krahas nivelit te ardhurave dhe perqindjes se rritjes ekonomike. Ai lidhet me mire me mireqenien dhe eshte nje mase kompozite e kolonave baze te zhvillimit njerezor: shendet, edukim dhe te ardhura. HDI 2011- per Shqiperine eshte 0.739, dhe pozicioni i saj eshte i 70-te midis 187 vendeve .



HDI: Shendeti, Edukimi dhe te Ardhurat



VI.3 Qeverisja vendore

Mbi pushtetin vendor- shembuj

- Pushteti vendor apo qeverisja lokale, përfshin qeverinë vendore (pjesën ekzekutive) të ndërthurur me pjesën legjislative-vendimmarëse e kontrolluese. Kjo qeverisje nënkupton zyrën administrative më të vogël se ajo e shtetit, në kontrast me zyrat në qeverisjen qendrore (kombëtare) apo qeverisjen federale në nivelin e federatës. Pavarësisht prirjes moderne për rritjen e rolit të pushtetit vendor, qeveria qendrore, në shumicën e vendeve, vazhdon të përqendrojë pushtetin dhe detyrat në duart e veta. Megjithatë, sipas legjislacionit, qeveritë vendore arrijnë të mbledhin disa taksa të caktuara, që përgjithësisht kufizohen nga legjislacioni qendror dhe mund të variojnë vetëm brenda një intervali të ngushtë. Në disa vende, pushteti vendor merr subvencione të pjeshme apo të plota nga qeveria qendrore, nga të ardhurat apo taksat e mbledhura prej saj. Por, kjo e cenon deri diku Institucionet e qeverisjes vendore ndryshojnë nga vendi në vend.
- Entitetet qeverisëse fillojnë me shtetin (land-in) në rastin federativ, dhe vazhdojnë më tej me organizime diku jo të njëjta, diku të përafërta, por që në vende të ndryshme marrin emra të tillë si: provincë, rajon, departament, qark, prefekturë, distrikt, cite (qytet i madh), rajon administrativ, bashki, konte, municipalitet, komunë apo famulli dhe fshat.

Raste te ndryshme:

- *Argjentina*. Argjentina është një federatë e 23 provincave me kryeqytet Buenos Aires. Qeveria federale ka kontrollin mbi veprimtari të tilla si tregtia, doganat, monedha, emërimet e jashtme, etj. Guvernatorët provincialë zgjidhen për çdo katër vjet, por mbi ta ushtrohet dhe fuqia presidenciale e ndërhyrjes kombëtare për të garantuar formën republikane të qeverisjes në provinca. Që nga adoptimi i kushtetutës të vitit 1853, qeveria federale ka ndërhyrë mbi 200 herë, më së shumti me dekret presidencial. Nën këtë autoritet, zyrat provinciale apo municipale mund të deklarohen vakante, anullohen emërimet e mëparshme dhe mbikëqyren zgjedhjet. Kështu, p.sh., midis viteve 1966 dhe 1973, u shpërndanë të gjitha parlamentet (legjislaturat lokale) dhe guvernatorët e provincave u emëruan nga presidenti i ri. Në vitin 1973, restorimit të qeverisjeve provinciale dhe municipiale, u kthye në qeverisjen normale kushtetuese. Pas grushtit të shtetit të marsit 1976, qeveria federale ndërhyri përsëri për të lëvizur të gjithë guvernatorët dhe aplikuar rregulla të drejtpërdrejta ushtarake në të gjitha municipalitetet. Rithimi në qeverisjen lokale përfaqësuese u bë më 1983. Ndërsa, para vitit 1996 presienti emëronte kryetarin e bashkisë të Buenos Aires, dhe sipas ligjit, presidenti dhe kongresi kontrollonin çdo legjislacion të lidhur me këtë qytet. Me reformën kushtetuese të atij viti ky pozicion fitohej tashmë me zgjedhje, krahas dhe një pushteti legjislativ (Poder Legislativo) me 60 anëtarësh. Këta të fundit zgjidheshin me përfaqësimi proporcional për një periudhë 4-vjeçare.

-2-

- ***Australia.*** **Ajo kompozohet si shtet federal nga 6 shtete dhe 2 territore. Në këtë rast qeverisja tipike vendore (lokale) është forma e tretë e qeverisjes pas asaj federale dhe asaj të shteteve.**
- ***Kanadaja.*** **Edhe Kanadaja ka një sistem federal me tre rende qeverisjeje. E para i takon qeverisjes federale me 10 provinca dhe 2 territore, të ndjekur nga ajo provinciale dhe territoriale. Në nivelin bazë është qeverisja municipale (lokale). Këto pushtete municipale kontrollohen nga pushteti i rendit provincial (territorial).**
- ***Egjipti*****. (Para "Pranveres" Arabe) Ky pushtet qendror varen 26 governatorë (*muhafazat*). Zonat e qeverisjes së tyre ndahen në distrikte, qytete dhe fshatra. Në çdo nivel, ka një strukturë qeverisëse që kombinon këshillat përfaqësuese dhe organet e emëruara ekzekutive të qeverisjes, të udhëhequr nga guvernatorët, zyrtarët e distriktit dhe kryetarët e bashkive. Guvernatorët emërohen nga presidenti, dhe ata nga ana e tyre emërojnë vartësit e tyre. "Kocka" koercitive e aparatit shtetëror zbret nga Ministria e Brendshme nëpërmjet organeve ekzekutive në stacionet e policisë së distrikteve dhe kryeplakun e fshatit. Shtrirja e pushtetit zyrtar në zonat rurale, nën presidentin Naser, e ndihmoi regjimin e tij të sillte mundësi zhvillimi dhe shërbime të ndryshme aty. Ky depërtim administrativ i shtetit u vazhdua më tej dhe në kohën e Sadatit apo Mubarakut, por paralelisht u fuqizua fuqia e familjeve të vjetra dhe kryepleqve në kurriz të fshatarëve, por jo të shtetit. Megjithatë, fuqia e tyre balancohej nga ajo e rajoneve të policisë, ndërsa sistemi i qeverisjes vendore (kryetarët e bashkisë dhe këshillat) u integruan brenda regjimit. Vetë Sadati, mori disa masa për decentralizimin e fuqisë së provincave dhe të qyteteve, kurse në vitin 1979 u rrit me ligj autoriteti i guvernatorëve, krahas kontrollit administrativ dhe buxhetor të qeverisë qendrore mbi provincat. Po ashtu, këshillat e zgjedhura, të paktën formalisht, morën të drejtën për të miratuar ose jo buxhetin vendor. Madje, për të pakësuar kërkesat e vendorëve qeveria qendrore i dha të drejtën qeverisë lokale në mbledhjen e taksave vendore. Për të pakësuar deficitet në këtë nivel qeverisje, ajo u inkurajua të futej në aktivitete të përbashkëta (joint ventures) me investitorët privatë. Edhe me Mubarakun u thellua dicka më tej ky decentralizim dhe autonomi lokale.**

-3-

- ***Franca*. Sipas kushtetutës, në Francë ka 3 nivele qeverisjeje: 22 rajone me 96 departamente dhe 4 rajone apo departamente (*Régions* apo *départements d'outre-mer* : Réunion, Martinique, Guadeloupe dhe Guiana Franceze), dhe në total 36,679 municipalitete apo komuna (*communes*). Lidhjet midis komunave me njëra tjetrën përbëjnë tashmë një nivel qeverisje ndërmjet komunave dhe departamenteve. Shtojmë se Parisi (njëkohësisht municipalitet dhe departament) dhe Korsika janë qeverisje vendore *sui generis*.**
- ***Gjermania*. Gjermania si vend federal ndahet në një numër prej 16 shtetesh (*Länder*) të gjitha në territorin e Gjermanisë. Këto shtete, nëpërmjet përfaqësimit në *Bundesrat* , kanë fuqi të ushtrojnë veto ndaj ligjeve federale. Qeverisjet e tyre janë pjesë e qeverisjes së Gjermanisë.**
- **Qyteti i Berlinit dhe ai i Hamburgut janë vetë shtete, kurse shteti i Bremen-it përbëhet nga qytete Bremen dhe Bremerhaven. Të tre ato quhen qytete-shtete (*Stadtstaaten*). 13 shtetet e tjera formojnë shtetet me një zonë të konsiderueshme (*Flächenländer*).**
- **Sipas kushtetutës federale struktura e qeverisjes së çdo shteti në federatë duhet të respektojë "*parimet qeverisjes republikane, demokratike dhe sociale, e mbështetur në zbatimin e ligjit*". Të gjithë këto shtete janë *republika parlamentare* dhe marrëdhëniet midis degëve legjislative dhe ekzekutive pasqyrojnë atë të sistemit federal (legjislaturat zgjidhen nga populli për 4 ose 5 vjet, në varësi të shtetit) dhe kryeministri zgjidhet nga vota e shumcës së antarëve të parlamentit të Land-it (*Landtag*). Kurse kryminsitri emëron kabinetin për drejtimin e agjencive shtetërore të këtij shteti dhe kryerjen e detyrave ezketuvive të qeverisjes në nivel Land-i. Në 3 shtetet e quajtura shtete të lira (Bavaria, Saksonia dhe Turingia), qeveria quhet *Staatsregierung*, kurse në 10 të tjerat *Landesregierung*. Shtojmë se, para 1 janarit 2000, Bavaria kishte një legjislaturë me dy dhoma (nga parlamenti apo *Landtag* i zgjedhur në mënyrë popullore dhe senati i formuar nga përfaqësuesit e grupeve kryesore sociale dhe ekonomike). Në fakt, ky senat e mbylli funksionin e tij në referendumin e vitit 1998. Qeveritë apo degët ekzekutive për 3 qytetet-shtete: Berlin, Bremen dhe Hamburg, quhen *senate* me senatorë që mbajnë portofole ministeriore. Pra, në këto shtete, dega ekzekutive përbëhet nga senati afërsisht me 8 senatorë të zgjedhur nga parlamenti i shtetit, dhe që kryejnë detyra ekuivalente me ato të ministrave në shtetet e mëdha. Ekuivalenti i detyrës së kryeministrit është presidenti i senatit (*Senatspräsident*) në Bremen, kryebashkiaku (*Erster Bürgermeister*) në Hamburg dhe qeveritari apo kryetari bashkiak (*Regierender Bürgermeister*) në Berlin. Në rastin e Berlinit parlamenti quhet Dhomë e Përfaqësuesve (*Abgeordnetenhaus*), kurse në Bremen dhe Hamburg quhet *Bürgerschaft*. Qytetet-shtete të Berlinit dhe Hamburgut kompozohen në lagje apo ndarje administrative, kurse Bremen përbëhet nga dy distrikte urbane Bremen dhe Bremerhaven**. mbledhura brenda municipalitetetit.

3/1

Në shtetet e tjera ndeshen këto ndarje:

- **- Bashkime sipërfaqesh (*Landschaftsverbände*), që kanë një fuqi krejt të reduktuar në ditët tona;**
- **- Distriktet qeverisëse (*Regierungsbezirke*) që nënkuptojnë rajonet administrative;**
- **- Distriktet administrative (*Kreise*) të tipit rural apo atij urban. Çdo shtet përbëhet nga *distriktet rurale* dhe ato *urbane* (apo të qyteteve), kurse Berlini dhe Hamburgu janë secili njëkohësisht shtet dhe distrikt urban, kurse Bremer përbëhet nga distrikte urbane. Gjithësej janë 313 distrikte rurale dhe 116 urbane, pra gjithsej 429 distrikte. Secili prej tyre përbëhet nga një këshill i zgjedhur dhe një strukturë ekzekutive, që sipas shtetit konkret, ose është e zgjedhur nga këshilli, ose nga populli. Ajo mbikëqyr e kontrollon administratën e qeverisjes vendore, sepse p.sh., distriktet rurale kanë dhe funksione administrative në fusha specifike, p.sh, në lidhje me autostradat, spitalet, shërbime të veçanta publike.**
- **- Zyrat apo byrotë (*Ämter*). Në disa shtete ekzistojnë njësi administrative midis distrikteve dhe municipaliteteve. Këto janë zyrat.**
- **- Municipalitetet (*Gemeinden*). Çdo distrikt rural apo çdo zyrë ndahen në municipalitete, ndërkohë që çdo distrikt urban është vetë një municipalitet. Sipas të dhënave të marsit 2009, ekzistojnë gjithsej 12,141 municipalitete, që janë dhe njësitë administrative më të voglat në Gjermani. Edhe vetë qytetet e mëdha apo qytetet e tjera janë po ashtu municipalitete, që nuk kanë më ato privilegje të dikurshme për të pasur taksat e tyre apo për të zhvilluar industritë e ndryshme brenda kufijve të qytetit, etj. Qeverisja e municipalitetit realizohet nga këshilli i zgjedhur dhe ekzekutivi (kryetari i bashkisë), që ose zgjidhet nga këshilli ose nga njerëzit. Ajo ka dy përgjegjësi kryesore të politikë-bërjes: së pari, ajo administron programet e autorizuara nga qeveria federale apo ajo e Land-it, të lidhura me rinisë, shkollën, shëndetin publik dhe asistencën sociale; së dyti, ajo siguron "*të drejtën për të rregulluar me përgjegjësinë e vet të gjitha çështjet e bashkësisë lokale brenda kufijve të përcaktuar nga ligji*". Në këtë këndvështrim të gjerë, qeverisjet vendore mund të justifikojnë një gamë të madhe aktivitetesh, përfshirë dhe shtrirjen e infrastrukturës ekonomike të komuniteteve të tyre nëpërmjet zhvillimit të parqeve industriale. Ato furnizojnë shërbime publike si gazi e elektriciteti, uji i pijshëm apo transporti publik. Po ashtu, autoritetet lokale mbështesin veprimtaritë kulturore duke nxitur artistët vendore, duke ndërtuar qendra arti, qendra sportive, panaire e ekspozita, etj. Pjesa dërrmuese e fondeve për municipalitetet garantohen më shumë nga nivelet më të larta të qeverisjes, sesa nga taksat vendore të**

- ***India***. **Ajo përbëhet nga 25 shtete dhe 7 territore unioni. Ndërsa, qeverisja vendore aty është niveli i tretë i qeverisjes në lidhje me qeverisjet e shteteve apo atë qendrore. Kjo qeverisje është dy llojesh: të ashtuquajturit *panchayat[1]* në zonën rurale dhe municipalitetit në zonën urbane. *Panchayat*[[1] si strukturë në zonën rurale (e nisur nga njësitë e vogla (fshatrat) me afro 5,000 banorë, në ato ndërmjetëset me afro 100,000 banorë, dhe distriktet e këtij llojo me afro 1,000,000 banorë) e ka origjinën në vitin 1959 në huazimin e modelit (vetë-administrimit) jugosllav, ndryshe nga municipalitetet urbane, e krijuara gjatë regjimit kolonial, në mesin e shekullit të 19-të, që në vetvete i mbijetuan "eksperimentit socialist".**
- **Në vitin 1991, u realizuan dy amendamente kushtetuese, secili për çdo njësi të tillë, për të përfshirë një numër të konsiderueshëm ndryshimesh për të fuqizuar qeverisjet vendore në Indi. Të tilla janë zgjedhja e tyre për një periudhë 5 vjeçare apo kufizimi i shpërndarjes së tyre në 6 muaj, 3 nivele të qeverisjes lokale, rezervimi i vendeve për kryetarët gra, krijimi i komisioneve zgjedhore të pavarura në nivel shteti, i komisioneve financiare në nivel shteti të lidhur me komisionin qendror financiar apo komitetet e planifikimit në nivel distrikti apo zona metropolitane. Mbi të gjitha, këto amendamente kanë përcaktuar dhe linjat kryesore për shtetet në lidhje me fuqizimin e qeverisjeve vendore nëpërmjet devolucionit apo shpërhapjes së funksioneve dhe taksave (gjë që ka rezultuar problematike, jo e suksesshme, në shtete të ndryshme).**
- **[1]*Panchayat* është shprehje e një "sistemi politik" në Azinë Jugore (India, Pakistani dhe Nepali). Ai nënkupton si term asamblenë (yat) e pesë (panch) njerëzve të moshuar të ditur dhe të respektuar, të zgjedhur dhe të pranuar nga komuniteti i fshatit. Tradicionalisht, këto asamble kanë zgjidhur konfliktet midis individëve apo fshatrave. Në ditët e sotme, qeveria indiane i ka decentralizuar disa nga funksionet administrative në nivelin e fshatit, duke i dhënë disa fuqi këtyre njerëzve të zgjedhur "*gram panchayats*", që shpesh identifikohen gabimisht me "*khap panchayats*" e pazgjedhur. Po ashtu dhe termi "*Panchayat Raj*" me origjinë në administratën britanike, nënkupton qeverisje apo qeveri ("*raj*"). Mahatma Gandhi ishte një nga avokatët e *Panchayati Raj*-it, si një fondament i sistemit politik indian, dhe me një formë decentralizimi të qeverisjes, ku çdo fshat është përgjegjës për çështjet e veta. Për këtë vizion të tij është përdorur termi "*Gram Swaraj*" apo vetë-qeverisje e fshatit. Si koncept ai u adoptua në vitet 50-60-të, kur në shumë nga këto shtete u miratuan ligjet përkatëse për *panchayats*. Akomodimi i plotë i kësaj ideje u arrit në Kushtetutën indiane me amendamentin e 73-të në vitin 1992. Ky amendament ka të bëjë me shpërhapjen e fuqisë dhe përgjegjësitë që u kalohen *panchayats*-eve për përgatitjen e planeve të zhvillimit ekonomik dhe të drejtësisë sociale apo implementimin e 29 subjekteve të përfshira në kushtetutë. Për këtë qëllim, këto njësi të qeverisjes vendore marrin fonde nga 3 burime: granteve vendore, sipas rekomandimit të Komisionit Qendror të Financave; fondeve nga skemat sponsorizuese qendrore, dhe fondeve të dhëna nga qeveria e shtetit përkatës me rekomandim të Komisioneve Shtetërore të Financave.**

- ***Irlanda***. Qeverisja vendore në Irlandë përbëhet nga 29 këshilla konteshë dhe 5 këshilla qytetesh të mëdha. Burimi kryesor i financimit është qeveria qendrore. Burime të tjera lidhen me derdhjet për pronat tregtare apo industriale, dhënien me qira të shtëpive apo mjediseve, pagesën për shërbimet e ndryshme, etj. Një shqetësim i këshillave është pafuqia për të rritur taksat apo erozioni i ngadalshëm i fuqisë së tyre në kohë. Israel
- ***Izraeli***. Aty, njihen 4 tipe të qeverisjes lokale: *qytetet, këshillat lokalë, këshillat* rajonalë dhe këshillat industrialë.
- ***Italia***. Sipas kushtetutës italiane ka 3 nivele të qeverisjes vendore. Këto janë *rajonet*. Prej tyre 5 kanë një status special dhe gëzojnë më shumë autonomi se të tjerat (Val d'Aosta, Friuli-Venecia Xhulia (Giulia), Trentino-Alto Adige, Sardenia dhe Sicilia). Reforma kushtetuese e vitit 2001 u ka dhënë rajoneve më shumë fuqi. Nivel tjetër janë *provincat* që përkujdesen për rrugët, pyjet dhe edukimin. Në të kaluarën ato kanë pasur shumë më tepër pushtet se sot. Niveli i tretë janë *komunat*, ku kryetari i komunës dhe stafi i tij merren me zgjidhjen e problemeve dhe halleve të një qyteti apo një fshati të vetëm (dhe të qyteteve apo fshatrave më të vegjël). Qytetet e mëdha kanë një shtrirje ekstra të qeverisjes vendore të quajtur: *Circoscrizione di Decentramento Comunale* apo e quajtur *Municipio* për disa qytete shumë të mëdha (p.sh., Roma).
- ***Malajzia***. Qeverisja vendore është niveli më i ulët në sistemin e qeverisjes, pas asaj federale dhe asaj të shteteve. Ajo e ka kompetencën e mbledhjes së taksave, të krijojë ligje dhe rregulla, të japë licenca dhe leje për çdo lloj tregtie apo aktivitet të ngjashëm në hapësirën nën juridiksionin e saj, të merret me mbledhjen dhe trajtimin e plehrave, apo planëzimin dhe zhvillimin e zonës nën qeverisje.
- ***Mali***. (para marrjes se pallatit presidencial nga ushtaraket ne mars 2012) Mali ka tentuar te ndërmarrë një program ambicioz decentralizimi, që përfshin distriktit e kryeqytetit (Bamako), 7 rajone, të ndarë në 46 rrethe dhe 682 distrikte të bashkësive rurale (komuna). Në çështjet e ndryshme administrative e fiskale të këtyre njësive, shteti në qendër mban një rol këshillues; dhe për më tepër ai iu ofron këtyre niveleve qeverisje mbështetje teknike, koordinim apo asistencë legale. Një rrugë e tillë ka rritur ndjeshëm pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë politike dhe përgjegjësinë e organeve vendore. Në 1998, u mbajtën zgjedhjet për anëtarët e këshillave urbanë, që më tej zgjodhën kryebashkiakët, kurse gati një vit më vonë u organizuan për herë të parë zgjedhjet për anëtarët e këshillave komunalë.

- **(vazhdim) Më tej u riinstitucionalizuan rrethet mbi baza legale e financiare; këshilla e tyre u kompozuan nga anëtarët e këshillave komunalë. Edhe rajonet, të përbërë nga disa rrethe me afërsi gjeografike, si niveli më i lartë i decentralizimit të pushtetit karakterizohen nga një autonomi e ngjashme legale dhe financiare.**
- ***Meksika.*** **Ajo është një republikë federale me 31 shtete dhe një distrikt federal. Çdo shtet ndahet në *municipios,* kurse distrikti përbëhet nga 16 *delegaciones*. Çdo shtet ka kushtetutën e vet, një guvernator të zgjedhur për 6 vjet dhe një parlament (një legjislaturë njëdhomëshe) me përfaqësues të zgjedhur sipas votës proporcionale në distrikt. Sesioni i zakonshëm i kësaj legjislature mbahet çdo vit, ndërkohë që seksioni i jashtëzakonshëm thirret nga guvernatori apo një komiteti i përhershëm. Iniciativën legjislative mund ta ushtrojnë deputetët, guvernatori, gjykata e lartë e shtetit apo dhe municipalitetet. Në fakt, njësia kryesore e qeverisjes në rang shteti është municipaliteti (të tillë numërohen 2,378) që drejtohen nga kryetari (presidenti) municipal dhe këshilli municipal. Guvernatorët, në përgjithësi, i përzgjedhin kandidatët për zgjedhjet municipale. Edhe buxhetet municipale miratohen nga guvernatorët përkatës. Deri në vitin 1997, presidenti emëronte kryetarin e bashkisë të qytetit Meksiko, ndërkohë që reformat politike e mundësuan zgjedhjet e drejtpërdrejta të tij. 29 shtetet e Meksikës janë krijuar si ndarje administrative që me kushtetutën e vitit 1917, kurse dy territoret e tjera të mbetura e fituan të drejtën e shtetësisë në vitin 1974, duke e çuar në 31 numrin e shteteve në federatë.**
- ***Holanda.*** **Aty, ndeshen tre nivele qeverisjeje, midis tyre, dy nivele: provincat dhe municipalitetet, i përkasin qeverisjes vendore, Bile, dhe bordet e ujit janë pjesë e qeverisjes lokale. Holanda ndajet në 12 provinca. Ato përfaqësojnë administrimin midis qeverisjes qendrore dhe municipaliteteve. Çdo provincë drejtohet nga një këshill provincial (*Provinciale Staten*), me anëtarë të zgjedhur për 4 vjet. Me administrimin e përditshëm të provincës merret dega ekzekutive (*Gedeputeerde Staten*), e zgjedhur nga këshilli midis anëtarëve të tij me të njëjtën kohë shërbimi, veçse pas kalimit në degën ekzekutive këta "qeveritarë" (sipas provincave nga 4, në 6-7 gjithësej) japin menjëherë dorëheqjen nga anëtarësia në këshill).**

- **Mbledhjet e degës ekzekutive drejtohen nga Komisionieri i Mbretëreshës (*Commissaris van de Koningin*), që nuk zgjidhet nga banorët e provincës, por emërohet nga Kurora (mbretëresha në bashkëpunim apo nëpërmjet qeverisë qendrore) për një periudhë 6 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje njëherë. Ai shkarkohet nga detyra po nga Kurora. Shtojmë gjithashtu se ky komisioner luan një rol të rëndësishëm në emërimin e kryetarëve të municipaliteteve. Në fakt, kur një vend i tillë rezulton i lirë, komisionieri përkatës merr fillimisht mendimin e këshillit për pasuesin dhe pastaj ia rekomandon kandidatin Ministrit të Brendshëm.**
- **Nisur nga qeverisja qendrore dhe ajo e provincave, municipalitetet (të ngjashme me komunat) janë forma më e ulët e qeverisjes në Holandë. Në vitin 2006 numëroheshin 458 njësi të tilla. Këshilli municipal (*Gemeenteraad*) është autoriteti më i lartë i municipalitetit. Anëtarët e tij zgjidhen çdo 4 vjet. Roli i këshillit është i ngjashëm me atë të bordit të një organizate apo institucioni, pra përcaktimi apo dhënia e pëlqimit të një politike konkrete dhe i mbikëqyrjes së zbatimit të saj. Kurse, puna e përditshme administrative në municipalitet kryehet nga struktura ekzekutive, e përbërë nga kryebashkiaku apo kryekomunari (*Burgemeester*) dhe kryepleqtë (*Wethouders*), të zgjedhur nga këshilli (kur kryeplak bëhet një anëtar këshilli, ai zëvendësohet në këshill po nga e njëjta parti politike). Ndryshe nga këshilltarët dhe kryepleqtë, kryebashkiaku apo kryekomunari nuk zgjidhet, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, por emërohet nga Kurora, dhe drejton si këshillin, ashtu dhe ekzekutivin. Ky i fundit merret me zbatimin e legjislacionit kombëtar në çështje të tilla si asistenca sociale, përfitimi e trajtimi në kushte papunësie apo administrimi mjedisor, përfshirë këtu përgjegjësinë kryesore për financat apo politikat e personelit. Po ashtu, vetë kryebashkiaku apo kryekomunari, si i emëruar i Kurorës, ka dhe disa fuqi statutore e përgjegjësi të vetat, që lidhen me ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, marrëdhëniet publike të municipalitetit, kontrollin dhe mbikëqyrjen e gjithanshme, bashkëpunimin me strukturat e mësipërme të qeverisjes, etj. Ai emërohet për një periudhë 6 vjeçare dhe zakonisht riemërohet për një herë të dytë kur bie dakord këshilli municipal (komunar). Kurse, në lidhje me shkarkimin, ky këshill nuk ka asnjë rol, gjithçka varet nga Kurora.**
- **Së fundi, *bordet e ujit* janë autoritetet më të vjetra qeverisëse në Holandë, në administrimin lokal të ujit dhe nivelit të tij. Struktura e bordeve të tilla nuk është e njëjtë, por, në përgjithësi, ata kanë një trupë administrative (që përbëhet nga përfaqësues apo të deleguar të interesave apo kategorive të ndryshme mbi ujin), një bord ekzekutiv dhe një kryetar (shef). Është bordi administrativ ai që zgjedh bordin ekzekutiv midis anëtarëve të tij, kurse qeveria emëron një kryetar apo shef (*Dijkgraaf*) për një periudhë 6 vjeçare. Shtojmë se bordi administrativ zgjidhet për një periudhë 4-vjeçare. Anëtarët e tij deri vonë zgjidheshin në mënyrë individuale, kurse që nga viti 2009 konsiderohen si përfaqësues partiakë. I vetmi ndryshim nga zgjedhjet municipale është se votuesit nuk shkojnë të votojnë në qendrat e votimit, por me anë të internetit.**

- ***Paraguaj***. Paraguaj ndahet në 17 departamente, që nga ana e tyre janë nëndarë në distrikte. Këto të fundit përbëhen nga municipalitetet apo komunat (me një minimum popullsie prej 3,000 vetash) dhe distriktet rurale (*partidos*). Çdo departament drejtohet nga një guvernator, i zgjedhur me votë popullore. Qeverisja municipale ushtrohet nga një bord municipal, të zgjedhur me votim të drejtpërdrejtë dhe nga një strukturë ekzekutive. Në qytetet kryesore dhe kryeqytetet kjo strukturë ekzekutive drejtohet nga kryebashkiaku, që emërohet nga Ministri i Brendshëm, kurse në lokalitetet e tjera kryebashkiaku (kryekomunari) emërohet nga presidentër e bordeve municipale. Vetë shefat e policisë emërohen nga qeveria qendrore.
- ***Spanja***. Spanja ka 17 komunitete autonome që përbëhen nga 50 provinca. Ka dhe dy qytetete autonome. Në çdo provincë përmban një numër municipalitetesh. Çdo njësi administrative ka fuqinë, strukturën dhe kufijtë vet. Po ashtu, çdo qytet me një numër të konsiderueshëm banorësh ka një trupë qeverisëse të quajtur Plenare (*el Pleno*), me një numër anëtarësh që varion nga popullsia e qytetit. Anëtari i kësaj trupe quhen këshilltar (*Concejal*) dhe zgjidhet nga banorët e qytetit në mënyrë të drejtpërdrejtë për një mandat 4 vjeçar. Pas zgjedhjes, këto këshilltarë në një seancë speciale zgjedhin midis tyre kryebashkiakun e qytetit. Më tej, ai zgjedh midis disa prej këshilltarëve për të formuar trupën ekzekutive qeverisëse (*Junta de Gobierno*). Pra, për 4 vjet resht, kryebashkiaku dhe *Junta de Gobierno* qeverisin qytetin në përputhje me kompetencat përkatëse (në fushën e urbanizmit, taksave të veçanta, policisë lokale, dhënies së licencave për aktivitete specifike, shërbimit të pastrimit, et.). Kurse, këshilltarët që nuk janë pjesë e qeverisjes ekzekutive mbikëqyrin veprimtarinë e kryebashkiakut dhe të stafit të tij.
- ***Zelanda e Re***. Ajo ka një sistem qeverisjeje lokale të përbërë nga dy lloj autoritetesh plotësuese vendore: ***këshillat rajonalë*** dhe ***autoritetet territoriale***. Gjithësej janë 86 autoritete vendore të përbëra nga 12 këshilla rajonalë që mbulojnë shumicën e sipërfaqes së Zelandës së Re, dhe 74 autoritete territoriale (që përmbajnë 59 këshilla distriktesh dhe 15 këshilla qytetesh të mëdha). Pesë autoritete territoriale janë *unitare*, d.m.th. ata gëzojnë dhe fuqitë e këshillave rajonalë. Ndërsa, zakonisht, brenda zonës së një këshilli rajonal ka disa këshilla qytetesh dhe këshilla distriktesh.

Terma kryesore

Decentralizimi – Transferimi me ligj i autoritetit dhe burimeve nga pushteti qendror në atë lokal, e cili ndryshon mënyrën në të cilën ofrohen shërbimet dhe sesi ata u përgjigjen qytetarëve.

Autonomia lokale – Është e drejta e plotë për të ndërmarrë nisma me interes publik vendor për çdo çështje që nuk ndalohet me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror.

Subsidiariteti – parimi që, kurdoherë që është e mundur, shërbimet dhe funksionet duhet të kryhen në atë nivel të qeverisjes që është sa më pranë shtetasve, qytetareve(Neni 2, Ligji Nr. 8652/2000) .

Kompetenca – zotësia për të vepruar dhe nxjerrë akte

Pushteti vendor-Rasti shqiptar

- Qarqet – prefekturat (Prefekturat, Rajonet apo Qarqet) përfaqësojnë njësi administrative e territoriale të përbëra nga disa komuna e bashki, që kanë lidhje gjeografike, tradite, ekonomike e sociale, si dhe interesa të përbashkët. Rrethet janë nënndarje të rajoneve).
- Prefekti- Perfaqesuesi i qeverise qendrore. Administrata e prefektures
- Keshilli i qarkut, me perfaqesim te deleguar. Administrata e tij
- Keshilli bashkiak, Keshilli i komunes (sistem proporcional)
- Kryetari i bashkise, Kryetari i komunes (sistem maxhoritar)
- Administratat e tyre

Qeveria qendrore dhe vendore - nje organigrame e thjeshte



Kushtetuta - PJESA E GJASHTË: QEVERISJA VENDORE

- **Neni 108:**
- **1. Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.**
- **2. Ndarjet administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to.**
- **3. Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisese, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësive të tjera të qeverisjes vendore.**
- **4. Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit vendor parashikohen me ligj në përputhje edhe me nenin 151 paragrafi 2.**

Neni 109:

- 1. Organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilët zgjidhen çdo kater (ishte tre) vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.
- 2. Organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.
- 3. Të drejtën e zgjedhjes në këshillat vendorë dhe si kryetar bashkie ose komune e kanë vetëm shtetasit që janë me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse.
- 4. Organet e njësive të qeverisjes vendore kanë të drejtë të formojnë bashkime dhe institucione të përbashkëta me njëri-tjetrin për përfaqësimin e interesave të tyre të bashkëpunojnë me njësitë vendore të vendeve të tjera, si dhe të përfaqësohen në organizatat ndërkombëtare të pushteteve vendore.

Neni 110, Neni 114:

- **Neni 110**
- **1. Qarku përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes vendore me lidhje tradicionale, ekonomike e sociale dhe të interesave të përbashkët.**
- **2. Qarku është njësia ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore.**
- **3. Organi përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut. Bashkitë dhe komunat delegojnë anëtarë në këshillin e qarkut në përpjesëtim me popullsinë e tyre, por për çdo rast të paktën një anëtar. Kryetarët e komunave dhe të bashkive janë kurdoherë anëtarë të këshillit të qarkut. Anëtarët e tjerë të tij zgjidhen me lista përpjesëtimore ndër këshilltarët bashkiakë ose komunalë nga këshillat përkatës.**
- **4. Këshilli i qarkut ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime me fuqi detyruese të përgjithshme për qarkun**

- **Neni 114:**
- **Këshilli i Ministrave cakton prefektin si përfaqësues të tij në çdo qark. Kompetencat e prefektit caktohen me ligj.**

L I G J Nr.8652, dt. 31.7.2000 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE

Neni 2

Përkufizime

Në kuptimin e këtij ligji:

1. **”Funksion" është fusha e veprimtarisë për të cilën është përgjegjës një organ i caktuar.**
2. **“Funksione të deleguara" janë funksione të pushtetit qendror ose të institucioneve të tjera qendrore që me ligj ose me marrëveshje caktohen të realizohen nga njësitë e qeverisjes vendore në mënyrën dhe masën e përcaktuar nga pushteti qendror dhe institucione të tjera qendrore.**
3. **“Funksione të përbashkëta" janë funksione për të cilat njësia e qeverisjes vendore ka pjesën e saj të përgjegjësisë së dallueshme nga pjesa e përgjegjësisë së dhënë pushtetit qendror, si dhe që bashkëshoqërohen përpjesëtimisht me kompetenca, të cilat i ushtron në mënyrë autonome.**
4. **“Funksione të veta" janë funksionet e dhëna me ligj njësisë së qeverisjes vendore, për të cilat ajo është përgjegjëse për realizimin, si dhe ka lirinë dhe autoritetin të marrë vendime e të përdorë mjete për realizimin e tyre, brenda hapësirës së normave, kritereve dhe standardeve të pranuara përgjithësisht me ligj, duke zotëruar autoritet të plotë administrativ, shërbimi, investimi dhe rregullator.**

...

Neni 3

Misioni i pushtetit vendor

Pushteti vendor në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve…

Neni 4

Parime themelore të funksionimit të organeve të njësive të qeverisjes vendore

1. Organet e njësive të qeverisjes vendore veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore.

2. Marrëdhëniet ndërmjet organeve të njësive të qeverisjes vendore dhe marrëdhëniet e tyre me organet e pushtetit qendror bazohen në parimin e subsidiaritetit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

3. Në veprimtarinë e tyre organet e njësive të qeverisjes vendore respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet e nxjerra në bazë dhe për zbatimin e tyre.

4. Organet e njësive të qeverisjes vendore janë persona juridikë.

5. Çdo komunë, bashki dhe qark është organ qeverisës me vazhdimësi.

KREU II- NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

.

Neni 5- Përcaktimi: komunë, bashki, qark dhe nëndarjet

1.Njësi bazë të qeverisjes vendore janë komuna dhe bashkia.

2.Komuna përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh, si rregull në zona rurale dhe në raste të veçanta edhe në zona urbane. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e komunës përcaktohen me ligj. Nëndarjet e komunës quhen fshatra dhe në raste të veçanta qytete. Përcaktimi i territorit të nëndarjeve bëhet nga këshilli komunal.

3. Bashkia përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh kryesisht në zona urbane e në raste të veçanta përfshin edhe zona rurale. Shtrirja territoriale dhe emri i bashkisë përcaktohen me ligj. Nëndarjet e bashkisë në zona urbane quhen lagje. Lagjet krijohen në territore me mbi 15 000 banorë me vendim të këshillit bashkiak. Kur bashkia përfshin zona rurale, nëndarja quhet fshat. Fshati krijohet në një territor me mbi 200 banorë. Qytet, shpallet një qendër banimi e cila ka një plan perspektiv zhvillimi urban të miratuar. Shpallja e qytetit bëhet me ligj.

4. Qarku është njësi e nivelit të dytë të qeverisjes vendore.

5. Qarku përfaqëson një unitet administrativo-territorial, të përbërë nga disa komuna dhe bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkët. Kufijtë e qarkut përputhen me kufijtë e komunave dhe të bashkive që e përbëjnë atë. Qendra e qarkut vendoset në një nga bashkitë që përfshihen në të. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e qarkut përcaktohen me ligj.

6. Nëndarja e qarkut është rrethi. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e rrethit përcaktohen me ligj.

....

Neni 6 - Organet e njësive të qeverisjes vendore:

1. Në çdo komunë, bashki dhe qark, krijohen organet përfaqësuese dhe organet ekzekutive të qeverisjes vendore.

2. Organi përfaqësues i komunës ose bashkisë është këshilli komunal ose bashkiak. Organi ekzekutiv i komunës dhe bashkisë është kryetari i komunës dhe i bashkisë.

3. Organ përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut. Funksionet ekzekutive në qark kryhen nga kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut.

4. Organet përfaqësuese dhe ekzekutive në komuna e bashki zgjidhen me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë, sipas mënyrës së parashikuar në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

5. Organi përfaqësues i qarkut, krijohet me përfaqësues nga organet e zgjedhura të komunave dhe bashkive që e përbëjnë atë, sipas mënyrës së përcaktuar në Kushtetutë dhe në kreun IX të këtij ligji.

6. Kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut zgjidhen nga këshilli i qarkut, sipas mënyrës së përcaktuar në kreun IX të këtij ligji.

Etj.

L I G J Nr.8652, datë 31.7.2000 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QEVERISJES VENDORE -4-

Detyrat dhe kompetencat e këshillit komunal ose bashkiak (*Neni 32, Ligji Nr. 8652/2000*) përmbajnë:

- **1. Miraton statutin e komunës ose të bashkisë, si dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të vet.**
- **2. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin/zv. kryetarin e këshillit bashkiak, emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit.**
- **3. Miraton strukturën organizative dhe rregulloret për administratën e bashkisë, etj. në përputhje me legjislacionin në fuqi.**
- **4. Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.**
- **5. Vendos për taksat e tarifat vendore, si dhe nivelin e tyre.**
- **6. Vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve.**
- **7. Vendos për dhënien ose heqjen e mandatit të këshilltarit.**
- **8. Miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.**
- **9. Vendos për simbolet e komunës ose të bashkisë**
- **10. Vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim te komuna ose bashkia**

Decentralizimi

Decentralizimi politik në Shqipëri ka filluar më 1992, me miratimin e "Aktit të Qeverisë vendore" dhe mbajtjen e zgjedhjeve vendore. Ne fakt, zbatimi i vetëqeverisjes vendore, mori pamje në vitin 1998, kur Shqipëria iu bashkëngjit "Kartës së vetëqeverisjes vendore" të Këshillit të Europës dhe përfshiu parimet e vetëqeverisjes në Kushtetutë. (Ajo përcakton që qeveria vendore bazohet në "parimin e decentralizimit" dhe ushtrohet përmes "parimit të autonomisë vendore"). Procesi i decentralizimit është udhëhequr nga miratimi i një sërë politikash dhe ligjesh, si dhe ngritja e strukturave institucionale si në nivel qendror ashtu dhe vendor. Më 1999 qeveria krijoi Komitetin kombëtar ndërministror për decentralizimin (KKD), i cili miratoi "Strategjinë kombëtare për decentralizim dhe autonomi vendore". Kjo u pasua nga zhvillimi i një pakete ligjesh për të orientuar administrimin e vetëqeverisjes. Këtu përfshihen ligji nr.8652/00 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverive vendore" dhe ligji nr.8653/00 "Për ndarjen administrative territoriale". Me rëndësi është që u zhvilluan edhe ligje dhe struktura për të rregulluar aspektet fiskale të vetëqeverisjes, përfshirë ligjin për pronat e paluajtshme të shtetit, ligjin për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisë vendore, dhe krijimin e Agjencisë për inventarizimin dhe transferimin e pronave publike. Kuadri ligjor krijoi formula për transferimin e fondeve buxhetore qendrore te njësitë e qeverisë vendore (NjQV) dhe i fuqizoi NjQV-të për të përpiluar buxhetet e veta të pavarura. Reformat fiskale në vitin 2002 panë futjen e taksave të reja vendore, si taksa vendore e biznesit të vogël, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, taksat e pronës dhe një sistem tarifash dhe taksash vendore. Procesi i decentralizimit ka thjeshtuar gjithashtu fushat e përgjegjësisë së njësive të qeverisë vendore sa i përket dhënies së shërbimeve lokale, duke i përfshirë autoritetet vendore në çështje të rëndësishme, si zhvillimi lokal, planifikimi urban, infrastruktura, menaxhimi i tokës, uji dhe higjiena publike. .

Pushteti Vendor dhe Ndarja Administrative

Sipas ligjit të vitit 2000 për përmirësimin e pushtetit vendor, organet lokale e ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me parimin e autonomisë, duke mbajtur lidhje me pushtetin qendror. Organet e pushtetit vendor janë persona juridikë që sigurojnë vazhdimësinë e qeverisjes nëpërmjet Komunave, Bashkive dhe Rajoneve.

Bashkitë ngrihen kryesisht në territoret e qyteteve.

Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë, ndahet në 11 njësi bashkiake (mini-bashki).

Komunat ngrihen përgjithësisht në territoret e fshatrave, dhe fshatrat zakonisht përbëjnë nënndarje të komunës.

Prefekturat (ose Rajonet, Qarqet) përfaqësojnë njësi administrative e territoriale të përbëra nga disa komuna e bashki, që kanë lidhje gjeografike, tradite, ekonomike e sociale, si dhe interesa të përbashkët. Rrethet janë nënndarje të rajoneve.

Organizmi dhe funksionimi i pushtetit vendor është i përbërë prej dy nivelesh.

Niveli i parë i pushtetit vendor përbëhet nga Komunat dhe Bashkitë. Kryetarët dhe këshillat e komunave dhe bashkive dalin nga zgjedhjet për pushtetin lokal cdo 4 vjet. Niveli i dytë i pushtetit vendor janë Qarqet dhe Prefekturat. Këshilli i Qarkut, i cili përbëhet nga kryetarët e Bashkive dhe Komunave dhe nga këshilltarë të dalë proporcionalisht nga zgjedhjet vendore, zgjedh kryetarin e këshillit të qarkut, ndërsa Prefekti emërohet nga Qeveria (Keshilli i Ministrave).

Ndarja Administrative Territoriale

Shqipëria. **Ajo ndahet në 12 qarqe dhe 36 distrikte (rrethe), përfshirë dhe qytetin e Tiranës, 65 qytete të mëdha dhe të vogla, 309 komuna (p.sh., sipas të dhënave të vitit 2002). Të gjitha copëzimet qeverisen nga këshillat. Ata udhëheqin aktivitetet ekonomike, sociale, kulturore dhe administrative nën juridiksionin e tyre dhe emërojnë drejtuesit ekzekutiv që administrojnë aktivitetet e përditshme. Ndërsa, në nivel fshati, në "qeverisjen" e tij zgjidhet një nga banorët, që quhet dhe *kryeplak*.**

Ne menyre te permbledhur kemi:

12 Qarqe (Rajone, Prefektura) ; 36 Rrethe ; 65 Bashki ; 309 Komuna ; 3020 Fshatra

Projekt-ligji (Reforma Administrative) për pushtetin lokal parashikon zvogëlimin kryesisht të numrit të komunave, por edhe të bashkive, duke krijuar komuna të reja nga bashkimi i komunave egzistuese ose bashkimin e ndonjë komune me ndonjë bashki, me qëllim që të rritet efikasiteti i shërbimeve të komunave ndaj komunitetit dhe të ulet kostoja e lartë funksionimit që kanë komunat e vogla me një numër të kufizuar banorësh.

PREFEKTI

Prefekti është një nga institucionet kryesore të cilës legjislacioni në fuqi i ngarkon përgjegjësi konkrete për bashkërendimin dhe koordinimin e bashkëpunimit të pushtetit vendor dhe institucionet qendrore në nivel vendor. Duke qenë përfaqësues i drejtpërdrejtë i Këshillit të Ministrave në qark, si edhe i vetmi institucion administrativ i pushtetit qendror që verifikon ligjshmërinë e akteve të organeve të qeverisjes vendore (nivel bashkie / komune dhe qarku), institucioni i Prefektit duket se është vendosur në një pozitë të favorshme për të koordinuar punën dhe bashkëpunimin e organeve shtetërore të të dy niveleve. Pavarësisht kësaj, roli bashkërendues i prefektit dhe mungesa e rezultateve më të prekshme në këtë drejtim është atakuar shpesh si nga përfaqësuesit vendorë ashtu edhe nga vetë pushteti qendror, debat i cili përfshin të gjitha variantet e mundshme për një ri-konfigurim të këtij roli.

Ligji (Ligji për Prefektin Nr. 8927, datë 25.7.2002) i njeh të drejtën Prefektit jo vetëm të shqyrtojë veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor si edhe të informojë institucionet qendrore për veprimtarinë dhe për shkallën e plotësimit të shërbimit në sektorët përkatës (Neni 12), por edhe hapësirën për të kontrolluar dhe kërkuar marrjen e masave për ushtrimin e funksioneve dhe plotësimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore (Neni 8).

Veprimtaria e prefektit

- Institucionet në nivel vendor me të cilat lidhet ngushtë veprimtaria e Prefektit, në Ligjin për Prefektin kategorizohen në tre grupe kryesore:
- - Institucione qendrore në nivel vendor – Prefekti ka të drejtën e kontrollit, mbikëqyrjes dhe bashkërendimin e veprimtarisë së tyre;
- - Institucione të pushtetit vendor (nivel qarku, bashkie e komune) – Të pavarura nga Prefekti;
- - Strukturat e policisë dhe të mbrojtjes – Të cilat ligji i ndan nga institucionet qendrore në nivel vendor.
- Një kategorizim i tillë i strukturave me të cilat Prefekti ka marrëdhënie institucionale nënkupton gjithashtu kushte të ndryshme nën të cilat zhvillohen këto marrëdhënie, në varësi edhe të statusit të secilit institucion – i pavarur si pushteti vendor apo i centralizuar si strukturat e policisë etj.
- 1. Organet e Qeverisjes Vendore. Raporti i institucionit të Prefektit me këto organe është përcaktuar qartë nga legjislacioni aktual – "Ndërmjet prefektit dhe organeve të qeverisjes vendore nuk ka marrëdhënie varësie." (Ligji për Prefektin, Neni 13). Sidoqoftë, ky përkufizim nuk mund të përjashtojë çdo lloj marrëdhie "kontrolli" dhe aq më pak, bashkëpunimi mes tyre. Prefekti është i autorizuar sipas ligjit të verifikojë ligjshmërinë - e akteve të miratuara nga organet e qeverisjes vendore, në komuna, bashki dhe qark (Neni 14). Gjithashtu Prefekti shqyrton ankesat e shtetasve për ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore (Neni 17). Po ashtu, ai kontrollon realizimin e funksioneve dhe përgjegjësive të deleguara nga pushteti qendror si edhe përdorimin e fondeve të parashikuara për to (Neni 16).
- Për këtë është e nevojshme që praktikat e kontrolleve të ushtruara nga administrata e pushtetit qendror tek ajo e pushtetit vendor të udhëhiqen vetëm nga dispozitat ligjore, në përputhje me parimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore (i sanksionuar edhe në Ligjin nr. 8652) sipas së cilit "kontroll administrativ në pushtetin vendor të ushtrohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj"

-2-

- **Bashkëpunimi dhe marrëdhënia e Prefektit me organet e nivelit të dytë të pushtetit vendor (qarku) shfaqet disi më pak intensive sesa në rastin e ndërveprimit me bashkinë apo komunën. Ndonëse përgjegjësitë dhe kompetencat e këtyre dy strukturave përfshijnë të njëjtin territor administrativ, duket se në praktikë ndërveprimi i tyre mbetet kryesisht i fokusuar në aspekte që kanë të bëjnë me kompetencën e Prefektit për të verifikuar ligjshmërinë e akteve dhe shumë pak në përgjegjësi të tjera (të cilat shpesh ndërthuren dhe kërkojnë bashkëpunim mes të dy institucioneve) si inicimi apo koordinimi i iniciativave rajonale që synojnë zhvillimin e përgjithshëm të qarkut etj.**
- **Parë nga ky këndvështrim, është e nevojshme që të zgjidhet dilema ligjore e pozicionit të qarkut dhe rolit të tij në kuadër të sektorëve të mundshëm të bashkëpunimit me Prefektin.**
- **2. Institucionet qendrore në niveli vendor. Ligji për Prefektin, me institucione qendrore në nivel vendor nënkupton të gjitha institucionet dhe strukturat e administratës publike të nivelit qendror të Këshillit të Ministrave, të ministrive dhe të institucioneve qendrore që ato kanë në kompetencë, si dhe personat juridikë që sipas ligjit drejtohen dhe administrohen prej tyre dhe që ushtrojnë veprimtarinë në njësitë administrative territoriale të qarkut. Nga analiza e kuadrit ligjor (më sipër), roli i Prefektit në bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor mbetet i kufizuar në kompetencat dhe ndikimin e vet, pavarësisht përgjegjësive ligjore të cilat i ngarkohen**

-3-

3. Strukturat e Policisë së Shtetit

Siç u përmend edhe më sipër, Ligji për Prefektin u referohet veçmas strukturave të policisë nga institucionet qendrore në nivel vendor dhe kjo jo vetëm për shkak të marrëdhënies që prefekti vendos më këtë institucion, por edhe për shkak të natyrës së punës dhe organizimit të centralizuar të Policisë së Shtetit. Kjo qasje e veçantë e ligjvënësit vërehet jo vetëm nga detyrat që i caktohen Prefektit në lidhje me veprimtarinë e Policisë, por edhe nga vetë formulimi i përdorur për të karakterizuar këtë marrëdhënie: "Prefekti *bashkëpunon* me organet e Policisë së Shtetit për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe sigurinë publike në territorin e qarkut" (Neni 10 i Ligjit për Prefektin).

Të dy këto institucione ndajnë karakteristika të përbashkëta nga pikëpamja e strukturës dhe organizimit të veprimtarisë të cilat konvergjojnë në një pikë të njëjtë – lidhja që kanë me pushtetin qendror. Duke qenë një institucion i centralizuar, drejtuesit e strukturave të policisë në nivel vendor shfaqen më "të lidhur" me qendrën (pushteti qendror) dhe përfaqësuesin e saj në qark (Prefektin). Sidoqoftë, ky konstatim vlen kryesisht për aspektet e bashkërendimit të veprimtarisë dhe raportimit për problematikën e sigurisë dhe rendit publik, sesa për vetë performancën e strukturave të policisë në këtë kontekst dhe bashkëpunimit të tyre me pushtetin vendor

Detyra te perbashketa dhe te nderthurura midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore.

Disa shembuj:

Gjendja Civile

- **Ligji për Gjendjen Civile (Ligji Nr. 8950, datë 10.10.2002) e përkufizon këtë shërbim si një institucion shtetëror dhe unik i cili ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Ky shërbim është i organizuar në katër nivele, si më poshtë:**
- **- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme (organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile) – niveli qendror (kombetar)**
- **- Dega e gjendjes civile në qark** (qark – pjesë e administratës së prefekturës) – **niveli rajonal**
- **- Zyrat e gjendjes civile në komuna e bashki- niveli lokal**
- **- Shërbimi i gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare.**

ARSIMI

- **Arsimi parauniversitar është në një fazë të vazhdueshme reformimi dhe i angazhuar në procesin e decentralizimit që synon rritjen e cilësisë së këtij shërbimi shumë të rëndësishëm për zhvillimin kulturor dhe progresin ekonomik të vendit. Aktualisht ky shërbim është një funksion i përbashkët ndërmjet qeverisjes vendore dhe asaj qendrore dhe si i tillë ka probleme që lidhen me ndarjen e funksioneve dhe përgjegjësive ndërmjet *Drejtorive dhe Zyrave Arsimore Rajonale dhe Organeve të qeverisjes vendore*. Aspekte problematike të këtij bashkëpunimi lidhen me mënyrën e përmirësimit në funksion të rritjes se cilësisë së ofrimit të këtij shërbimi tek qytetarët (perfshire dhe ndikimin e komunitetit te prindërve e mësuesve).**

Mjedisi -binomi qeverisje qendrore/vendore

I nisur me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të vitit 1998, neni 13, e të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore dhe pasuar nga Strategjia e Decentralizmit dhe Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverise Vendore, procesi i decentralizimit ka përfshirë pothuajse të gjitha fushat e shërbimeve publike, perfshire ato mjedisore.

Decentralizimi në kontekstin e administrimit mjedisor po çon në një rol shumë më të madh për autoritetet vendore në financimin dhe menaxhimin e shërbimeve mjedisore vendore përfshire menaxhimin e ujit të pijshëm, ujërave të përdorura dhe të mbetjeve të ngurta.

Strategjia e decentralizimit dhe ligji bazë i organizimit të qeverisë vendore e përcaktojnë shërbimin e mbrojtjes së mjedisit si funksion të përbashkët ndërmjet qeverisë qendore dhe asaj vendore, duke nënkuptuar që kompetencat specifike të miratoheshin me ligje dhe akte nënligjore. Ndonëse janë miratuar një seri ligjesh dhe strategji sektoriale në fushën e mjedisit, ende nuk ka një përcaktim të saktë të kompetencave specifike për secilin nivel të qeverisjes. Në bazë të ligjit nr. 8934, datë 5. 9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", organet e qeverisjes vendore përfaqësojnë strukturën më të rëndësishme shtetërore për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit, që kanë në juridiksion, duke zbatuar përgjegjësitë, të drejtat e detyrat që u jep ligji nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

- Nje problem ne vete mbi mjedisin jane marrëdheniet bashki-qark qe janë të zbehta; po ashtu edhe ato ndërmjet Qarkut dhe ARM. (Kjo e fundit thjesht raporton një herë në dy vjet në Këshillin e Qarkut për gjendjen e mjedisit dhe cakton detyra që njësitë e qeverisë vendore duhet të zbatojnë).
- *Qeveria vendore duhet të ketë rolin e vet vendimmarrës në shërbimin e mbrojtjes së mjedisit.* Me synim realizimin e procesit të decentralizimit dhe për t'i sjellë shërbimet sa më pranë përfituesit, duhet të vlerësohet nëse *një pjesë e lejeve mjedisore*, sidomos ato të biznesit të vogël, *të kalojnë në kompetencë të organeve të qeverisjes vendore*. Për këtë, është e nevojshme një rishikim i listës së veprimtarive ekonomike për të cilat, deri tani, pëlqimin/ autorizimin mjedisor e jep ARM, për të specifikuar fushat që mund të jepen leje nga organi vendor.

Kalimi gradual i detyrave nga qeverisja qendrore ne ate vendore, p.sh., per investimet ne infrastrukture, shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe i kanalizimeve, etj.

- *Investimet ne infrastrukture (rruge, shkolla, lulishte, kopshte, etj.)*
- *Furnizimi me uje te pijshem dhe i kanalizimeve.*
  Procesi i Transferimit të Pronësisë
- **Ndonëse i përcaktuar si një nga prioritetet e qeverisë qendrore dhe i caktuar në ligj për t' u ofruar nga qeveria vendore, si funksion i vet i saj, sektori i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve ka pasur vazhdimisht probleme cilësore dhe sasiore.**
- **Realiteti përbën nje shqetësim për qeverinë vendore pasi nga njëra anë furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet përfaqëson një nga funksionet dhe përgjegjësitë më të rëndësishme të tyre, por nga ana tjetër ai kërkon investime të mëdha, aktualisht të papërballueshme nga ato.**

Menyra e krijimit te qeverisjes vendore.

Menyra e ndertimit te qeverisjes vendore




AUTORITETI ZGJEDHËS DHE EMËRUES NË BASHKI
VOTUESIT
Anëtarët e Këshillit Bashkiak
Kryetarin e Bashkisë
Sekretarin
Kryetarin
Zv. Kryetarin
Këshilltarët për në Këshillin e Qarkut
Zv. Kryetarin
Drejtuesit e Ndërmarrjeve / Institucioneve Bashkiake
Stafin e Administratës së Bashkisë

AUTORITETI VENDIMMARRËS

VOTUESIT

Referendum Vendor

Organet e Zgjedhura

KESHILLI I BASHKISË

KRYETARI I BASHKISË

Organi Legjislativ

Organi Ekzekutiv

Përfshirja e Bashkësisë

Keshilltaret

- **Numri i Këshilltarëve të Këshillit (ligji 8652 neni 24 pika 1):**
- **Bashkitë deri në 5,000 banorë 13 Këshilltarë**
- **" " 5,000 - 10,000 banorë 15 Këshilltarë**
- **" ” 10,000 - 20,000 banorë 17 Këshilltarë**
- **" ” 20,000 - 50,000 banorë 25 Këshilltarë**
- **" “ 50,000 - 100,000 banorë 35 Këshilltarë**
- **“ “ 100,000 - 200,000 banorë 45 Këshilltarë**
- **Bashkia e Tiranës 55 Këshilltarë**

Variant


Organigrama
KËSHILLI I BASHKISË
Grupet Politike
ORGANI LEGJISLATIV
KRYESIA
Kryetari
Z/kryetari
SEKRETARI
(KOMISIONET ME QYTETARE)
KËSHILLIMORË
INSTITUCIONAL
STATUTORË
AD-HOC
KOMISIONET E PËRKOSHME
(psh. Hetimi)
KOMISIONET E PËRHERSHME
ZHVILLIMI URBAN, INFRASTRUKTURA
SHENDETI PUBLIK dhe AMBJENTI
MANDATET e KËSHILLTARËVE PROTOKOLLI
FINANCAT dhe BUXHETI, TAKSAT
SHËRBIMET SOCIALE, ARSIMI
REVIZIONIMI BASHKISË
ORGANIZIMI BASHKIAK, PERSONELI
PRONAT dhe SHËRBIMET PUBLIKE
RENDI e QETËSIA PUBLIKE, EMERGJENCAT
POLITIKAT
ZHVILLIMI EKONOMIK, BIZNESI
JURIDIKE, KONTRATAT, RREGULLORET
KULTURA, TITUJT,SPORT ARGËTIMI


Organograma e Qeverisë Bashkiake
Variant
VOTUESIT E BASHKISË
Këshilli Bashkiak
Kryetari i Bashkisë
Stafi
Kabineti Kryetarit
Keshilltarët
N/Kryetarët
Shefi i Financës
Shefi i Urbanistikës
Shefi i Sek. Juridik
Shefi i Shërbimeve Publike
Drejtuesit e Njësive Administrative
Sekretari
Organi Vendim-marës
Komisionet e Përhershme
Revizioni i Bashkisë
Njesitë Administartive
Marrëdhënjet me Jashtë
Mbrojtja Civile/Siguria Publike
Sek. Juridik, Kontratat
Zyra e Ankesave
Financat & Zhvillimi Urban
Z/kryetari i parë
Z/kryetari i dytë
Shërbimet dhe Pronat Publike
Zhvillimi Urban Përdorimi i Tokës
Tatimet, taksat licensat
Financat & Buxheti
Zhvillimi Ekonomik
Pronat Publike, Transporti
Shërbimet Publike
Shërbime e Brëndëshme
Politikat Urbane
Menaxhimi urban
Sekretaria Teknike
Arkitekti
Zyra e Kadastrës
Projektimi
Lejet e Ndërtimit
Inspektim ndërtimi
Politikat e Strehimit
Regjistrimi
Inspektimi/ Sekuestrimi
Licensimi
Tezgat/Tregu i mbyllur
Financat
Buxheti
Llogarija
Revizioni (financat, tatim,taksat)
Arka (daljet) (hyrjet)
Planifikimi
Statistika
Shërbimet për biznesin e vogël/panairet/ promovimet
Menaxhimi i programeve
Menaxhimi & mbrojtja e burimeve natyrore /ambjentit
Ndriçimi publik
Rrugët
Uji/K.U.Z
Transporti publik
Ambjente çlodhëse
Planifik/Mirëmbajtja e Pronave publike
Parqet/ Hapsirat e gjelbëra publike
Varrezat Publike
Shërbimet sociale
Gjendja Civile
Informacioni & Komunikimi Publik
Shëndeti publik, Veterinaria
Pastrimi
Dekori Publik
Sportet
Administrata e kulturës
Personeli
Administrata
Transporti
Teknologjia
Mirëmbajtja
Arkiva
Sigurimi

Çfarë është Pushteti Vendor?

Njësia e qeverisjes vendore është qeverisja e një zone të caktuar vendore brenda vendit. Qëllimi i qeverisjes vendore është të sigurojë përdorim efektiv dhe eficient të burimeve publike dhe të kryerjes së shërbimeve në nivelin më të afërt për qytetarët. Shqipëria ka një sistem të organizuar në dy nivele të pushtetit vendor që janë të pavarur nga njeri-tjetri.

Bashkitë dhe komunat përbejnë njësitë bazë të qeverisjes vendore të pushtetit vendor, si dhe nivelin e parë.

Qarku përbën nivelin e dytë të qeverisjes vendore dhe ka në përbërjen e tij disa bashki e komuna të cilat zakonisht kanë lidhje tradicionale, ekonomike dhe shoqërore.

- **Te dhena: 3020 fshatra te organizuara ne 309 komuna dhe 65 bashki në Shqipëri, të cilat janë të vendosura në 36 rrethe ne 12 qarqe.**
- **Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore. (*Neni 13 i Kushtetutës së Republikë së Shqipërisë).* Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. (*Neni 108 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë).***

Çfarë bën Pushteti Vendor?

- **Funksione te veta,**
- **Funksione te perbashketa**
- **Funksione te deleguara**

Në Shqipëri, njësitë e qeverisjes vendore rregullojnë dhe kryejnë shume shërbime publike, vendosin dhe mbledhin taksa dhe tarifa vendore dhe, në emër të pushtetit qendror, menaxhojnë edhe funksione të caktuara qeverisëse. Fondet për kryerjen e këtyre funksioneve vijnë nga taksat dhe tarifat vendore dhe nga transfertat e pushtetit qendror.

A. Funksionet e veta – autoriteti dhe përgjegjësia për t'i përmbushur këto funksione është vetëm e pushtetit vendor

- 1) *Infrastruktura dhe shërbimet publike*

- furnizimi me ujë të pijshëm
- kanalizimet e ujërave të bardha dhe të zeza
- ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore
- shërbimi i ndriçimit
- shërbimi i pastrimit, etj

- 2) *Shërbimet me karakter social, kulturor e sportiv*

- ruajtja dhe zhvillimi i vlerave kulturore dhe historike vendore
- organizimi i veprimtarive sportive dhe mirëmbajtja e institucioneve përkatëse
- administrimi i çerdheve, azileve, shtëpitë e fëmijëve, etj

- 3) *Zhvillimi ekonomik vendor*

- përgatitja e programeve të zhvillimit ekonomik vendor,
- ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike
- ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve, etj.

- 4) *Rendi dhe mbrojtja civile*

- ruajtja e rendit publik për parandalimin e shkeljeve administrative
- mbrojtja civile

Funksionet e përbashkëta– autoriteti dhe përgjegjësia për përmbushjen e këtyre funksioneve bashkëndahen me ligj ndërmjet pushtetit qendror dhe pushtetit vendor. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse përpara komunitetit që i zgjedh për performancën në lidhje me funksionin e tyre "te përbashkët".

- **1). *Arsimi parauniversitar*: Pushteti qendror është përgjegjës për zhvillimin e kurrikulave, standardeve të mësimdhënies, si edhe për rekrutimin dhe largimin e stafit kryesor (mësuesit dhe drejtoret e shkollave). Pushteti vendor është përgjegjës për mirëmbajtjen e objekteve arsimore, për pajisjet dhe materialet, dhe për investimet në objektet arsimore. Kjo e fundit duhet, sidoqoftë, të financohet nga qeveria qendrore.**
- **2). *Shërbimi shëndetësor parësor dhe mbrojtja e shëndetit publik*: Pushteti qendror është përgjegjës për caktimin e standardeve për shërbimet e shëndetit, për rekrutimin dhe trajnimin e stafit mjekësor. Pushteti vendor është përgjegjës për mirëmbajtjen e objekteve të kujdesit shëndetësor, rekrutimin e stafit ndihmës dhe furnizimin me pajisje mjekësore.**
- **3). *Përkrahja sociale*: Pushteti Qendror është përgjegjës për përcaktimin e standardeve të shërbimeve sociale, për kriteret e ligjshmërisë se përfitimit të shërbimeve sociale, si dhe financimin e përkrahjes sociale dhe të formave të tjera të ndihmës sociale. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për identifikimin e kategorive në nevoje si dhe destinimin e sakte të shërbimeve në territorin e tyre. Ata janë, gjithashtu, përgjegjës për menaxhimin e objekteve të kujdesit social siç janë jetimoret, objektet për personat me aftësi të kufizuara, etj.**

Funksione të Deleguara – pushteti qendror ka të gjitha kompetencat, por shërbimet kryhen nga pushteti vendor

- *Gjendja civile*: Ky është një funksion uniform shtetëror, i cili ushtrohet edhe nga pushteti vendor. Standardet, financimi dhe administrimi i zyrave të gjendjes civile janë në kompetence të plote të pushtetit qendror. Këto zyra janë pjesë e strukturës së pushtetit vendor në mënyrë që ato të jenë më pranë qytetarëve.
- Një vrojtim i kryer në vitin 2005 dhe përsëri në 2007 tregon se shumica e qytetarëve Shqiptare dallojnë në mënyrë korrekte shumë prej funksioneve që janë përgjegjësi e pushtetit vendor kundrejt atyre që janë përgjegjësi e pushtetit qendror.

Çfarë bën Kryetari i Bashkisë (Komunes)?

- **Ashtu si në shumicën e vendeve të tjera, Kryetarët e njësive të qeverisjes në Shqipëri janë zyrtarët kryesorë ekzekutivë të njësive të qeverisjes vendore.**
- **Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore zgjidhet direkt nga populli i bashkise apo komunes dhe janë përgjegjës për të siguruar që shërbimet publike t'u jepen si duhet qytetarëve që jetojnë në atë juridiksion.**
- **Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore kanë përgjegjësitë e politik-bërjes, të zbatimit, të mbikëqyrjes së personelit dhe përgjegjësi të buxhetit. Ata duhet të punojnë ngushtë me Këshillin Vendor, kompetencat e të cilit plotësojnë ato të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore. Për shembull, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore harton projekt buxhetin vjetor vendor që do të shqyrtohet nga Këshilli Vendor në përgjigje të politikave të Këshillit dhe, pastaj, është përgjegjës për zbatimin e buxhetit sapo ai të jetë miratuar nga Këshilli.**

Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore si Udhëheqës dhe Menaxher

- ***Një Udhëheqës (bën gjerat e duhura) është një kryetar i cili është në gjendje të bashkojë segmente të kundërt të bashkisë dhe të jete një forcë për ndryshim pozitiv në arritjen e këtij vizioni.***
- ***Një Menaxher (ben gjerat siç duhet) është një kryetar i cili është i aftë të sjellë përmirësime në cilësi dhe sasi për shërbimet ashtu siç përcaktohet nga qytetarët.***

-2-

Kapacitete konkrete:

- Zhvillimi i një vizioni për të ardhmen
- **Aftësi planifikimi dhe buxhetimi**
- Komunikimi
- Administrimi dhe organizimi i aftësive të stafit.
- Motivimi dhe frymëzimi
- Aftësi monitorimi dhe për zgjidhjen e problemeve

Udhëheqja dhe menaxhimi janë dy sisteme të ndryshme dhe plotësuese të njëra – tjetrës. që një kryetar të jete i suksesshëm duhet t'i misheroje të dyja këto aspekte.

Çfarë bën një Këshill Bashkiak?

- **Këshilli Vendor në Shqipëri është organ vendimmarrës dhe politikbërës dhe përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur vendore. Numri i popullsisë është përcaktues për numrin e këshilltarëve si dhe për numrin e përfaqësuesve në këshillin e qarkut. Këshilli Vendor operon si një organ i tërë por mund edhe të ndahet në komitete apo komisione për të formuluar politikat në fusha të ndryshme, të tilla si financat, shërbimet publike, kultura/arti/sporti dhe arsimi/shëndeti dhe qe mund të bëjnë rekomandime tek këshilli i plotë në funksion të zërave specifikë të agjendës se komisionit apo komitetit. Në Shqipëri Komisioni i Financës autorizohet me ligj, por njësitë vendore janë të lira të ngrenë komisione shtese që shihen të lidhura me rrethana të veçanta të komunitetit, të tilla si trashëgimia dhe turizmi apo mbrojta e ambientit. Si organ politikbërës, këshilli mund të vendosë nivelin e taksave dhe tarifave, të hartojë politika fiskale katër vjeçare, të përcaktojë standardin e shërbimeve, të ngrejë struktura për pjesëmarrjen e publikut në vendim marrje dhe të hartojë strategji zhvillimi, e të tjera.**
- **Këshilltarët kanë përgjegjësi politikë-bërëse, mbikëqyrëse dhe për buxhetin dhe punojnë ngushte me kryetarin e njësisë se qeverisjes vendore, funksionet e të cilit plotësojnë ato të këshillit. Për shembull, këshilli vendor shqyrton, ndryshon dhe miraton buxhetin vjetor vendor dhe, më pas, monitoron zbatimin e buxhetit nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore.**

Terma te tjera te rendesishme

- **Taksat janë detyrime financiare të vendosura ndaj individëve apo personave juridikë për të mbështetur qeverinë; taksat vendore janë detyrime indirekte që nuk lidhen me një shërbim specifik dhe i sjellin pushtetit vendor të ardhura me qëllim të përgjithshëm.**
- **Baza e taksës është shuma totale ndaj të cilës zbatohet niveli i taksës (p.sh., shuma e të gjitha pagave të paguara në një vend mund të ishte baza a taksës për taksën kombëtare mbi të ardhurat).**
- **Niveli i Taksës është përqindja e zbatuar ndaj një baze takse për të llogaritur taksën që duhet paguar.**
- **Tarifat janë detyrime të vendosura ndaj përfituesve të drejtpërdrejtë të shërbimeve publike.**

Pjesë nga Legjislacioni Shqiptar

- **Pushteti vendor ka të drejtën "te vendosë taksa dhe tarifa…". *Pika b, Paragrafi 3, Neni 8 i Ligjit Nr. 8652.***
- **Të paktën një pjesë e burimeve financiare të bashkësive vendore duhet të sigurohen nga detyrimet dhe taksat vendore, përqindjen e të cilave ato kanë fuqi ta caktojnë në kufijtë që u lejon ligji.**
- ***Karta Evropiane e Autonomisë Vendore.***

  Pika 3, Neni 9

SEKTORI I FINANCAVE DHE BUXHETIT
Tatimet dhe Taksat Vendore
Pagat
Hyrje
Dalje
Qerate
ARKA
Ndihma Ekonomike
Gjobat Interesat
Te tjera

SEKTORI I TATIM TAKSAVE

Skema e Mbledhjes së Taksa/Tatimeve – tatimi mbi ndërtesën.
(ndarja e funksioneve dhe sistemi i kontrollit të brëndshëm)



Taksat Kryesore Vendore

- Taksa e Biznesit të Vogël
- Taksa e Pasurisë
- Taksa e Ndikimit në Infrastrukture
- Taksë Hoteli
- Taksë për Zënie Hapësirash Publike
- Taksa të Përkohshme
- *Taksa të Përbashkëta*
- Taksa e Regjistrimit të Automjeteve
- Taksa e Transaksioneve të Pasurisë

Tarifat Kryesore Vendore

- Tarifa e Pastrimit Rrugor
- Tarifa e Ndriçimit Rrugor
- Tarifa e Mbeturinave Urbane
- Tarifa e Parkimit
- Tarifa e Regjistrimit
- Tarifa e Tregut
- Tarife Shërbimesh Veterinare
- Tarife Gjuetie

Kuadri ligjor dhe politik për barazinë gjinore në nivel vendor

Legjislacioni që ka të bëjë me gjininë në Shqipëri krijon detyrime ligjore për qeveritë vendore. Ligji **"Për barazinë gjinore në shoqëri",** i vitit 2008, për shembull, kërkon nga njësitë e qeverisë vendore që: ⎫ Të bashkëpunojnë me institucionet e qeverisë qendrore për të zbatuar legjislacionin gjinor dhe politikat kombëtare për barazinë gjinore; ⎫ Të bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse që punojnë brenda territorit të tyre për të arritur barazi gjinore në fusha të ndryshme; ⎫ Të mbledhin dhe të analizojnë të dhëna të ndara sipas seksit; ⎫ Të caktojnë një ose disa nëpunës të barazisë gjinore vendorë për të trajtuar çështjet e barazisë gjinore; ⎫ Të marrin masa të posaçme të përkohshme për të rritur përfaqësimin e grave në pozicionet vendimmarrëse (kuota 30%).
Ligji nr.9669 **"Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare"** i detyron autoritetet vendore që: ⎫ Të angazhohen në ngritjen e strukturave të shërbimeve sociale për rastet e dhunës në familje; ⎫ Të instalojnë linja telefonike rajonale 24-orëshe pa pagesë, për të vendosur lidhje me njësitë vendore, policinë, ekipet e urgjencës mjekësore dhe OJQ-të, për të bashkërenduar kështu veprimet e tyre; ⎫ Të ngrenë qendra sociale dhe rehabilitimi për viktimat dhe dhunuesit dhe të bashkërendojnë përpjekjet me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse.
Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe çrrënjosjen e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje , e ripunuar më 2011, kërkon që njësitë e qeverisë vendore: ⎫ Të kontribuojnë në zbatimin e strategjisë në nivel vendor dhe të bashkërendojnë punën përmes nëpunësve të barazisë gjinore (NBGj); ⎫ Të kontribuojnë në përmirësimin e Makinerisë kombëtare të gjinisë përmes caktimit të NBGjve në nivel vendor; ⎫ Të japin shërbime të përshtatshme që rehabilitojnë dhe riintegrojnë viktimat/të mbijetuarit e DhBGj-së; ⎫ Të përqendrohen në ngritjen e kapaciteteve të administratës vendore për t'iu përgjigjur dhunës me bazë gjinore.

VI.4 Mbi konfliktin e interesit.

Identifikimi i konfliktit te interesit ne sherbimin publik

Konflikti i interesit: Nje sfide madhore

Cfare eshte konflikti i interesit?

- **Origjina (shmangie personale -- "asnjeri nuk mund te gjykoje rastin e tij")**
- **Burimet (interesat private; relacionet e ndryshme familjare, miqesore; aktivitetet apo pozicioni konkret; interesi i biznesit)**
- **Perse konflikti i interesit paraqitet si problem?**
- **Si mund te menaxhohet konflikti i interesit?**

Cfare jane interesat private?

Ketu perfshihen:

- **Asete personale dhe interesa familjare**
- **Borxhe dhe detyrime te tjera**
- **Lidhje fetare, komunitare apo asosiacione etnike**
- **Rreshtime profesionale, politike apo partiake, etj.**
- **Afiliacione apo marredhenie te caktuara, etj.**

- **Cdo interes specifik privat (d.m.th. jo publik) mund te konsiderohet i rendesishem nese ai mund te ndikoje ne menyre te papaster performancen e zyres apo te kryerjes se detyres ne rrethana ate caktuara.**

Burime te konfliktit te interesit



Ku mund te shfaqen interesa te biznesit?



Por cfare eshte konflikti i interesit?

- **Nuk mund te mohohet ndikimi i interesit privat ne marredhenien zyre publike-interes privat, deri ne nivele te tilla qe mund te ndikoje ne menyre te pandershme sjelljen e zyrtarit apo vendimmarrjen e tij. Ketu vlejne te specifikohen qarte termat - "interesat *private* ", "nenpunesi apo zyrtari publik" e "detyra zyrtare", per te shmangur abuzimin apo dyzimin ne perdorimin e tyre.**
- **Konflikti i interesit nuk eshte patjeter korrupsion, por ai mund ta provokoje ate. Prandaj ai behet i rrezikshem dhe duhet te shmanget. Me fjale te tjera, nje konflik interesi i paidentifikuar, i pashmangur apo i pazgjidhur ne menyre te pershtatshme mund te coje lehte ne korrupsion.**

Perse konflikti i interesit krijon shqetesim?

Konflikti i interesit identifikohet si nje sfide madhore:

Ai mund te preke apo te deformoje misionin e vertete te sherbimit publik konkret. Mbi te gjitha, ai lidhet dhe me mjedisin socio/ekonomik, qe ndryshon me shpejtesi, konkretisht:

- **me nderfaqen (interface) publike/private – si nje forme e re e bashkeveprimit, perfshire zona emergjente apo te hirta.**
  - **me vete shoqerine ne ndryshim ne rrafshin edukativ e ate multikulturor.**
  - **me kerkesen per informim dhe rolin kritik te medias**
  - **me probleme te renies se besimit ne institucionet publike.**
- **Nje kerkese ne rritje eshte zbatimi i nje sistemi rregullator ne praktike mbi konfliktin e interesit:**
  - **Te kuptuarit e tij**
  - **Njohja e zgjidhja, procedura e akte ligjore, percaktime konkrete, etj.**

Disa kategori qe mund te perfshihen brenda kuadrit politiko-ligjor te konfliktit te interesit?



Konflikti i interesit si realitet. Nevoja per identifikim, parandalim, zgjidhje dhe menaxhim te drejte

- **Konflikti i interesit-** Te pergjithshme:
  - **Situate ne te cilen orientimi tek nje detyre (apo interes)**
    te con ne mos respektimin apo shmangien e tjetres (tjetrit)
  - **Krahas ligjit perkates mbi sjelljen e zyrtarit vlejne dhe kodet perkatese te sjelljen profesionale (mjekut, avokatit, mesuesit, etj.)**
- **Ligji i konfliktit te interesit percakton kundershtite apo konfliktet midis detyrave publike dhe interesave private.**
- Pretendon standarde te larta si ne sektorin privat.
- Vendos nje standard minimal sjellje
- Percakton nje agjenci (te pavarur) per te interpretuar apo imponuar kerkesat e ligjit te konfliktit te interesit (p.sh., bordi i konfliktit te interesit, p.sh., ne gjirin e parlamentit per ministrat apo zyrtare te larte)

Nepermjet ketij ligji percaktohen barriera ne sjelljen e punonjesve apo nenpunesve publike, me nje pikesynim qe **sherbimi publik te jete dhe te mbetet nje besim publik,** pra:

1. **me synim mbrojtjen e besimit ndaj punonjesit publik;**
2. **promovimin e konfidencen publike ndaj shtetit dhe qeverisjes;**
3. **promovimin e integritetit te vendimmarrjes dhe rritjen e eficiences se qeverisjes**

Edhe njehere: Konflikti i interesit

Konflikti individual i interesit

Nje “konflikt interesi” eshte nje interes personal apo nje marredhenie qe sic percaktohet ne ligj apo ne nje sistem rregullator konfliktuon me kryerjen e drejte dhe korrekte te detyres zyrtare. Nje nenpunes nuk mund te marre pjese personalisht dhe substancialisht (p.sh., te realizoje nje vendimmarrje, te japе keshille, te beje nje rekomandim) per cdo ceshje zyrtare qe mund te preke interesat financiare te: Te tijat, te gruas, te femijeve te vegjel, te partnerit, te organizates ku ai sherben si oficer, drejtues, partner, etj., te organizates me te cilen negociohet, etj.

Konflikti organizacional i interesit

Nje konflikt organizacional interesi mund te rezultoje kur faktore te ndryshem krijojne nje konflikt aktual apo potencial interesi ne nje kontrate momentale, apo kur natyra e punes te bere mbi kete kontrate krijon nje konflikt aktual apo potencial interesi ne nje perfitim te ardhshem. Ne rastin e fundit, duhet te kihen parasysh disa kufizime mbi veprimtarine e ardhshme te kontraktorit.

Interesa te tij jane dhe ato qe lidhen me

- Gruan e tij apo femijet (ne moshe te vogel)

- Partnerin e tij kryesor

Pra, me interesat e tij jane te lidhura: 1) Gruaja 2) Femijte e vegjel 3) Partneret kryesore (sepse natyra legale e kesaj lidhjeje, interesat e ketyre partnereve kryesore duhet te trajtohen sikur te ishin dhe interesat e tij).

Po ashtu, futet organizata ku ai sherben (me ose pa kompensim) si oficer, drejtor, partner, punonjes. Apo akoma, cdo individ dhe organizate me te cilin (te cilen) ai po negocion apo ka nje arranxim per nje punesim te ardhshem…



Rregulla paanesie



- **Ju nuk mund te aktivizoheni ne nje ceshtje te vecante nese aty keni:**
- **anetare te familjes, kusherinj apo miq;**
- **njerez me te cilet beni apo po kerkoni te beni biznes;**

nese behet fjale:

- **per organizata ne te cilat ju merrni pjese ne menyre aktive**
- **per organizata qe punesojne anetare te familjes tuaj**
- **apo per organizata, per te cilat punuat nje vit me pare, qe jane tashme pjese e ceshtjes qe po kontraktohet, qe kane interesa financiare te lidhura me problemin konkret per te cilin po merret vendimi perkates or**

Cdo individ mjaftueshmerisht i arsyeshem, me njohjen e ketyre fakteve do te vinte ne dyshim pretendimin potencial per paanesi!

- Te shmangen konfliktet individuale te interesit. Zyrtaret apo nenpunesit civile nuk mund te marrin vendime, te japin keshilla, te sugjerojne rekomandime per ceshtje zyrtare qe afektojne interesat e veta financiare

-Te raportohen po ashtu konfliktet organizacionale te interesit, qe deshmojne per ekzistencen e rolit konfliktual qe mund te devijojne gjykimin e kontraktorit apo qe mund te krijojne avantazhe te padrejta kompeticioni.

Pse duhet te shqetesohemi per ligjin e konfliktit te interesit?

- Per te shmangur cdo shkelje te ligjit apo te Kodit Civil dhe Kodit te Procedures Civile, pse jo dhe per te mos qene objekt jo vetem i ndonje masa displinore, por dhe i Kodit Penal dhe Kodit te Procedures Penale.
- Ne raste te vecanta duhet bere dhe dallimi midis asaj qe ndalohet qartesisht nga ligji, nga ajo qe nuk ndeshet me frymen e tij.
- Raste kur kerkohet vemendje e plote:

A. Dhuratat& Honoraret
B. Shfrytezimit i zyres (mjedisit) se shtetit
C. Aktivitetet e jashtme
D. Kufizimet e pas detyres
E. Aktivtetet politike

A. Dhurata& Honorare

Konflikti i interesit shfaqet kur punonjesi, nenpunesi civil apo zyrtari merr dhurata apo shperblime private nga individe apo entitete qe kane pune me shtetin

Me akte nenligjore apo udhezime konkrete mund te identifikohen dhuratat dhe honoraret qe mund te pranohen (ne sasi, vlere, etj.). Nuk mund te pranohen honorar per cdo llloj angazhimi nga individe e grupe qe perftojne mbeshtetje, projekte apo fitime sherbimesh apo kane trajtime nga zyra te shtetit. Ne raste te tjera te veprimtarise private pagesa duhet te jete e kushtezuar nga sherbimet e kryera, nga sasi e cilesia e tyre.

Asnje punonjes publik nuk mund dhe nuk duhet te pranoje cdo lloj "dhurate me vlere" nga personi/firma te angazhuar ne biznese te lidhura me zyrat perkatese te shtetit …me perjashtim kur behet fjale per festa familjare e shoqerore (apo raste p.sh datelindeje, brenda nje vlere te kufizuar). Po ashtu, duhen te konsiderohen qerasjet, bileta fluturimesh, akomodime ne hotele,etj. Po ashtu, punonjesit apo nenpunesit publike nuk mund te angazhohen ne asnje lloj biznesi, transaksioni apo punesimi privat, ose te kene ndonje lidhje finaciare apo me interes tjeter privat ne konflikt me me "shkarkimin" perkates te detyres zyrtare…Apo ndryshe: punonjesi civil apo zyrtari nuk mund te shfrytezoje apo te perpiqet te shfrytezoje pozicionin e tij shteteror per te pasur perfitime financiare, privilegje, etj., nga individi/firma qe ka te bejne me ate

Kujdes: Rastet e ngjarjeve familjare/sociale te perfshira ne kuader te lidhjeve familjare apo miqesore (por jo te marredhenieve te biznesit), pllaka mirenjohjeje, cmime, (qe nuk "shiten") etj. Pra, keto raste nuk duhet te shihen si konflikte! Pranohen mbeshtetjet apo financimet private per synime publike, per rritjen e kohezionit social, etj.

B. Shfrytezimi i zyres

- **Nenpunesi publik nuk mund te perdore zyren/pozicionin per te krijuar avantazhe per veten, familjen apo rrethin familjar, bashkepunetoret e tij.**
- **Detyrimi i nje luajaliteti te pandare ndaj kesaj zyre dhe pozicioni publik.**
- **Te mos shfrytezohet koha e punes, kancelarite perkatese, personeli, letrat me koke dhe firmosje zyrtare, pajisjet apo mjetet e tjera jashte detyrave dhe objektivave te zyres.**
- **Te mos u imponohet apo t'u induktohet nenpunesve te tjere publike dhunimi i etikes/ligjit te konfliktit te interesit.**

Punonjesi apo nenpunesi publik nuk mund te shfrytezoje apo te perpiqet ta shfrytezoje pozicionin zyrtar per perfitime financiare, per kontrata, licensa, privilegje apo avantazhe te tjera, direkte apo te terthorta, per vete apo cdo person e firm me te cilin ai "lidhet". Ketu perfshihet dhe bashkeshortja, partneri, prindi, vllai apo motra, me te cilet ky zyrtar ai (ajo) ndan interesat perkatese, deri dhe zoterime te terthorta; por dhe pozicionime konsulence, drejtimi, bordi, avokatie, etj.

Te mos harrohet dhe angazhimi p.sh., ne fushata politike apo ndjekje te ndonje biznesi, duke shfrytezuar kohen e punes ne zyren e shtetit, burimet apo pajisjet e saj. P.sh., ne fushaten aktuale!

C. Aktivitete te jashtme

- Te tilla jane ata qe lidhen si me vullnetarizmin, me nje pune te dyte apo me interesa prone. Pa harruar qe parimet baze te konfliktit te interesit lidhen si me veprimtari te paguara, ashtu dhe ato te papaguara. Edhe ne kete rast, vlejne ato rekomandime te pergjithshme: te mos besh asgje qe konflikton me detyrat tuaja zyrtare; te mos shfrytezosh pozicionin konkret (kohen, personelin, burimet e mjetet per qellime personale, private). Te tilla mund te jene ato kur nenpunesi civil perfshihet ne veprimtari jashte atyre zyrtare, qe ne pamje te pare mund te krijojne pershtypjen se ky zyrtar por kerkon avantazhe private per ate entitet me te cilin "asociohet".
- Nenpunesi civil ndalohet te "perfaqesoje" interesa private perpara cdo agjensie shteterore duke perfshire zyren dhe detyren e tij (shtetit).

Kur nuk ka lidhje biznesi me zyren:

1. Mund te kryhet pune e dyte per nje individ apo biznes pa lidhje me zyren apo institucionin ku punon, sipas percaktimeve ligjore.
2. Mund te kesh interesa pronesie ne kompani te tilla pa kete lidhje biznesi, sipas rregullimeve ligjore
3. Mund te zhvillosh veprimtari vullnetare apo angazhime te tilla pa perfitim, pa lidhje biznesi me institucionin dhe ne perputhje me ligjin.

Kur ka lidhje biznesi

Problemet behen me strikte, sidomos per te shmangur ato te politike-berjes apo shfrytezimit te autoritetit administrativ.

Verejtje: 1. Asnje nenpunes civil apo zyrtar nuk duhet te futet ne lidhje biznesi apo marredhenie financiare me nje nenpunes publik apo zyrtar tjeter qe eshte ose epror ose vartes i tij. P.sh., ne veprimari te perbashket biznesi (joint venture), huazim paraje, kohabitacion, etj.

2. Ndalohet te sherbeje si ekspert i paguar kunder interesave te institucionit ku punon.

3. Lejohet te marre pjese ne mbledhje fondesh pa shfrytezuar kohen dhe emrin e institucionit.

D. Kufizime pas largimit.

1. Jo angazhim apo pune per ceshtje te lidhura me veprimtarine e meparshme (zyrtare, shtetrore).
2. Pengese ligjore ose “morale” per nje periudhe te caktuar (zakonisht nje vit).
3. Pengese permanente (per te gjithe kohen e jetes), p.sh., ne veprimtari qe lidhen me sigurine.
4. Nuk lejohet shfrytezimi i informacionit konfidencial te marre ne kryerje te detyres zyrtare.

Por, kjo nuk do te thote te mos kontribuohet ne luften kunder korrupsionit, aktivitetit kriminal, konfliktit te interesave, etj., te demaskohet parazitizmi, joefektiviteteti, arroganca e nenpunesit (zyrtarit) ndaj vartesit apo servilizmi ndaj eprorit, etj.

E. Veprimtarite politike

Per nenpunesin civil nuk mund dhe nuk duhet te manifestohen afilacionet partizane ne kryerjen e detyres. Te shmangen trysnite politike mbi vartesit apo bashkepunime te tjera.

Ne detyra konkrete restriksionet jane akoma me te forta.

- **Nenpunesi civil mund te angazhohet ne veprimtari politike brenda detyrimeve qytetare apo ne perputhje me rubiken e veprimtarive te jashtme. Por jo interferim me detyren zyrtare, p.sh., telefonime nga zyra, shfrytezimi i mjeteve te transportit, etj., per vete apo te tjeret.**
- **Nuk lejohet te shfrytezoje apo te emetoje informacion konfidencial.**
- **Ne disa nivele apo detyra nuk lejohet asnje lloj aktiviteti politik, p.sh., per mbledhje fondesh.**
- **Mund te futet ne nje gare politike, per aq kohe qe lejohet nga ligji; por jo ama duke shfrytezuar kohen dhe burimet e zyres apo te institucionit!...**
- **Nuk mund te ushtroje trysni apo te aplikoje nje force koercive mbi nenpunesit e tjere per t'u angazhuar ne veprimtari politike apo fushate zgjedhore. Sidomos, eproret jane te ndaluar qe t'u kerkojne vartesve angazhim ne veprimtari politike.**
- **Nenpunesi civil mund te marre pjese ne fushate apo te kontrubuoje vullnetarisht, madje dhe duke iu nenshtruar kufizimeve per ndonje konsultim te paguar apo organizim fushate.**

Kodi i sjelljes

- **Vlera qe lidhen me kodin e sjelljes se nenpunesit civil:**
  - **Demokracia**
  - **Transparenca**
  - **Pjesemarrja**
  - **Cilesia**
  - **Respekti**
  - **Diversiteti dhe jo diskriminimi**
  - **Paanesia dhe integriteti**
  - **Pergjegjshmeria**

Kodi i sjelljes (disa materiale)

- **UN Convention against Corruption**
- **GRECO convention**
- **Federal Government of Austria – government program 2007-2010**
- **Code of Conduct**
  - USA-Standards of Ethical Conduct for the Employees of the Executive branch
  - Canada – Values and Ethics – Code for the Public Service
  - European Parliament – Guidelines for the duties of the civil servants and employees
  - Germany – Guidelines for the prevention of corruption in the federal administration
  - City of Vienna – A question of ethics – handbook for the prevention of corruption

Aspekti shqiptar

Per konfliktet e interesave

Ligji Nr. 9131 datë 08.09.2003, ”PER RREGULLAT E ETIKËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE”, KREU II, KONFLIKTET E INTERESAVE

Neni 4

Konflikti i interesave

1. Konflikti i interesave eshte situata ne te cilen nje nepunes i administrates publike ka nje interes personal te tille, qe ndikon ose mund te ndikoje ne paanshmerine ose objektivitetin e kryerjes se detyres zyrtare.

2. Interesat personale te nepunesit perfshijne çdo perparesi per veten, familjen, te afermit deri ne shkallen e dyte, personat ose organizatat me te cilet nepunesi ka ose ka pasur marredhenie biznesi ose lidhje politike. Konflikti i interesave perfshin, gjithashtu, çdo lloj detyrimi financiar ose civil te nepunesit.

3. Kur nepunesi ka dijeni se nje situate e tille ekziston, ai eshte i detyruar qe:

a) te verifikoje nese ka nje konflikt aktual ose te mundshem interesash;

b) te ndermarre hapat e nevojshem per te shmangur nje konflikt te tille;

c) te vere ne dijeni menjehere, me nismen e tij, eprorin direkt dhe njesine e personelit per konfliktin aktual ose te mundshem te interesave;

ç) ne rast dyshimi per gjendjen ne nje situate konflikti interesash, te keshillohet me eprorin direkt ose/dhe me njesine e personelit te institucionit;

d) t’ i bindet çdo vendimi perfundimtar per te mos marre pjese ne procesin e vendimmarrjes ose te heqe dore nga perparesite qe shkakton konflikti.

4. Konfliktet e mundshme te interesit te nje kandidati per t’ u punesuar ne administraten publike duhet te zgjidhen perpara emerimit te tij.

-2-

- **Neni 5**
- **Shmangia e konfliktit te interesave**
- **1. Eprori direkt, me mbeshtetjen e njesise se personelit, ne baze te te dhenave qe ka, merr masat e nevojshme qe te shmanget emerimi i nje nepunesi ne pozicione, ne te cilat mund te lindin ose ka konflikte interesash ose qe nepunesit te mos i ngarkohen detyra qe mund te çojne ne shfaqjen e nje konflikti te mundshem interesash.**
- **2. Shmangia e konfliktit te interesave behet ne perputhje me Kodin e Procedurave Administrative.**
- **3. Nepunesi, i cili ka interesa te tilla qe vazhdimesia e zoterimit te tyre do te perbente rrezik real per lindjen e konfliktit te interesave dhe do te sillte perjashtimin e vazhdueshem nga veprimtaria e tij zyrtare ose pamundesine per te ushtruar detyrat zyrtare, duhet te heqe dore ose ti transferoje keto interesa, ne menyre te tille qe mundesia e konfliktit te interesave te shmanget.**

LIGJ NR. 9367, DATË 7.4.2005, "PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE"

I azhurnuar me: Ligjin Nr.9475, datë 09.02.2006, Ligjin Nr. 9529, datë 11.05.2006, Ligjin Nr.9690, datë 05.03.2007

KREU I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 - Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta.

Neni 2- Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

Neni 3- Perkufizime

- **Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:**
- **1. "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.**
- **2. "Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësive" është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit.**
- **3. "Kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësive" është rasti kur nuk plotësohet të paktën njëra prej kërkesave të pikës 2 të këtij neni për shkak dhe vetëm të ndikimit të mundshëm të interesave privatë të zyrtarit, sipas pikës 1 të këtij neni.**
- **4. Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:**
- **a) "konflikt faktik i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund te kene ndikuar ne**

-2-

kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare;

- **b) "konflikt në dukje i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë;**
- **c) "konflikt i mundshëm i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara;**
- **ç) "konflikt rast për rast i interesit" është gjendja me konflikt interesi, në njërën nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë;**
- **d) "konflikt i vazhdueshëm i interesit" është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.**
- **5. "Zotërim aktiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital" është ushtrimi i plotë i të gjitha të drejtave, që burojnë nga pronësia mbi aksionet ose pjesët në kapital.**

- 6. “Zotërim pasiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital” është gjendja, në të cilën pronari ruan të drejtën e përfitimit të fryteve civile të pronësisë, por nuk mund të ushtrojë vetë asnjë veprim tjetër civil mbi këtë pronë. Të gjitha veprimet e tjera (administrim, zotërim, tjetërsim etj.) kryhen nga një person i besuar nga pronari, bazuar në një marrëveshje të lidhur ndërmjet tyre, që përcakton kriteret e përfitimit të fryteve të pasurisë, si dhe të drejta e detyrime të tjera të domosdoshme. I besuari nuk shkëmben asnjë mendim dhe asnjë informacion me pronarin dhe as nuk ndikohet nga ai për kryerjen e këtyre veprimeve me pasurinë. I besuari duhet të veprojë vetëm në të mirën e ruajtjes dhe rritjes së pasurisë, me të njëjtin motivim sikur këto veprime të kryheshin nga vetë pronari. Kufizimet në përzgjedhjen e të besuarit jepen në këtë ligj. Palët, në çdo rast, ruajnë të drejtën e zgjidhjes së kësaj marrëveshjeje. Pronari ka të drejtë të rimarrë, në çdo kohë, të drejtat e kryerjes së veprimeve të tjera civile me pronësinë, kur, sipas këtij ligji, kushtet që e diktuan këtë veprim nuk ekzistojnë më. Të drejtat dhe detyrimet e tjera, të papërmendura më sipër, rregullohen nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
- 7. “Zyrtar” është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike, sipas përcaktimit të shkronjave “a”, “b” e “c” të pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji.
- 8. “Institucion publik” është çdo subjekt, i përcaktuar në shkronjat “ç” e “d” të pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji.
- 9. “Epror i një zyrtari” është një zyrtar tjetër, një njësi organizative brenda institucionit publik, drejtuesi më i lartë i institucionit publik ose një organ i këtij institucioni, që ka kompetenca emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese, të drejtpërdrejta mbi këtë zyrtar, ose që i janë dhënë kompetenca të caktuara për zbatimin e këtij ligji.

-4-

- **10. “Institucion epror” është një institucion publik (ose organ i një institucioni publik) që, sipas ligjeve në fuqi, ka kompetenca rregulluese, emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese mbi një institucion tjetër publik (ose organ të tij), ku, në këtë të fundit, një zyrtar kryen detyrat dhe ushtron kompetencat e tij. Roli epror ushtrohet në përputhje me ligjet, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve publike. Pavarësisht nëse një institucion epror mund të ketë njërën nga kompetencat e mësipërme, ai nuk mund të vlerësohet i tillë, nëse kjo do të çonte në cenimin e parimeve kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe të autonomisë institucionale.**
- **11. “Person i lidhur me një zyrtar” është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore, sipas nenit 5 të këtij ligji, me zyrtarin.**
- **12. “Parim i proporcionalitetit” është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari ose institucioni publik me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë ose kompetencat e zyrtarit, aq më të shumta janë kufizimet e interesave të zyrtarit, aq më të ashpra janë dënimet dhe në mënyrë edhe më të hollësishme janë përcaktuar rregullat, mënyrat, mjetet dhe procedurat për parandalimin e konfliktit të interesit nga institucionet publike.**
- **13. “Person fizik tregtar” përdoret sipas kuptimit të përcaktuar nga legjislacioni tregtar.**

Ligji 9367 - 2005 "PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE " I ndryshuar me ligjin nr.9475, 9.2.2006 dhe me ligjin nr. 9529, 1.5.2006: neni 3, 5, 7, 8, 9, 21, 23, 37 etj.

Nje shkurtim perkufizimesh

- *"Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.*
- *Konflikti i interesit, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:*

i)

- *"Konflikt rast për rast interesi" është gjendja me konflikt interesi në njërën nga tri llojet e mëposhtme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë;*

ii)

- *"Konflikt faktik i interesit" është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarit;*

iii)

- *"Konflikt në dukje interesi" është gjendja në të cilën interesat e zyrtarit duken në pamje ose në formë sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të zyrtarit*

iv)

- *"Konflikt i mundshëm interesi" është gjendja në të cilën interesat e zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi te caktuara*